**VENDIM**
**Nr. 438, datë 22.6.2022**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË ANSAMBLIT HISTORIK TË PALLATIT TË BRIGADAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 47, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të menaxhimit të integruar të Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Arben Ahmetaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave

# Plani i Menaxhimit i Integruar



# Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave

## Plani i Menaxhimit i Integruar

*Përgatitur për:*

Ministrinë e Kulturës

*Janar 2022*

*Nga grupi i organizuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës:*

***Pirro Thomo – Arkitekt, restaurator***

***Armand Vokshi – Arkitekt,  urbanist***

***Loreta Çapeli - Arkitekte***

***Igli Kondi – Inxhinier konstruktiv***

***Orion Zavalani – Inxhinier elektrik***

***Ramadan Alushaj – Inxhinier mekanik***

***Genti Guxho – Inxhinier tekstili***

***Edlira Çaushi – Piktore resturatore***

***Dylber Neziri – Skulptor***

***Lirika Kupe – Biologe***

# Tabela e përmbajtjes

**Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave**

1.0 PËRMBLEDHJE

**Pallati, vlera arkitektonike dhe artistike**

**Parku, vlerat peizazhistike dhe artistike**

**Turizmi dhe infrastruktura**

**Influenca në komunitet, edukimi dhe trajnimi**

**Drejtimi dhe Menaxhimi**

2.0 HYRJE

**Kuadri ligjor**

**Qasja dhe çështjet kyçe**

**Struktura menaxhuese**

**Konsultimi**

**Praktika më e mirë**

**Konservimi dhe restaurimi**

**Menaxhimi i vizitorëve dhe kapaciteti mbajtës**

**Influenca në komunitet, edukimi dhe trajnimi**

3.0 ANSAMBLI HISTORIK I PALLATIT TË BRIGADAVE

**Vlera kulturore dhe arkitektonike**

**Parku**

**Integriteti**

**Autenticiteti**

**Kërkesat aktuale të mbrojtjes dhe menaxhimit**

4.0 Vlerësimi i vlerave të monumentit

5.0 Aspekte të lidhura me pasurinë

**Influenca në komunitetit, edukimi dhe trajnimi**

**Turizmi dhe infrastruktura**

**Analiza SWOT**

**Funksione në shërbim të vizitorëve**

6.0 Vizioni, qëllimi dhe objektivat

**Synimet dhe objektivat**

**Pallati, vlera arkitektonike dhe artistike**

**Parku, vlera peizazhistike dhe artistike**

**Drejtimi dhe menaxhimi**

**Turizmi dhe Infrastruktura**

**Influenca në Komunitet, edukimi dhe trajnimi**

7.0 ADMINISTRIMI

8.0 Plani i Veprimit

9.0 ZBATIMI dhe MONITORIMI
**Monitorimi**
10. SHTOJCAT

## Fjalor termash.

VKM / Vendim i Këshillit të Ministrave
AHPB / Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave
PMI / Plani i Menaxhimit të Integruar
IKTK / Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
DSHQ / Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare
PB / Pallati i Brigadave
HVAC / Heating, Ventilation, and Air Conditioning

# 1.0 PËRMBLEDHJE

Pallati i Brigadave dhe parku i tij, ndodhet në Jug të Tiranës, 3.8 kilometra nga Sheshi Skënderbej. Ky Ansambël Historik Arkitektonik zë një sipërfaqe të përgjithshme prej 9,424 hektarësh. Në sipërfaqen e madhe të parkut, përveç ndërtesës së Pallatit të Brigadave, ndodhet një sistem interesant kopshtesh gjeometrike, apo dhe kopshte të trajtuara në forma natyrale, liqene, fusha sportive, sera, shatërvanë, vepra arti, ndërtesa ndihmëse dhe një kishë e vogël (Kapelë).



Figura 1: Foto ajrore e shtrirjes së Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave.

Pallati i Brigadave (Vila Mbretërore ose Vila e Mëkëmbësit), është një kompleks në formën e një Ansambli Historik dhe Arkitektonik me një moshë afro tetëdhjetë vjeçare, i përbërë nga një sistem të ndërthurur vlerash arkitektonike, por jo vetëm. Ajo që e veçon këtë ndërtesë, si dhe të gjithë ndërtimet dhe elementet e tjerë të lidhur me të, është vlera arkitektonike e Vilës Mbretërore, vlerat e peizazhit të parkut, si dhe vlera e veprave të artit dhe artefakteve autentike, të shpërndara në pjesë të ndryshme të mjediseve brenda dhe jashtë vilës. Vlerat e tyre janë mjaft të veçanta edhe nga pikëpamja historike, qoftë në momentin e ndërtimit dhe prodhimit të tyre në fundin e viteve tridhjetë, ashtu edhe në ditët e sotme, kur ky sistem ka marrë një konotacion të fortë funksional, përsa i përket anës së lartë ceremoniale shtetërore dhe publike.

Megjithatë, edhe pse të ruajtura mirë në dekada, të gjitha këto pasuri janë në vetvete delikate dhe të cenueshme dhe nëse ato keqtrajtohen apo keqmenaxhohen, mund të vihet në rrezik integriteti i pasurisë në terma afatgjatë.

Thënë këtë, monitorimi dhe kontrolli i cenueshmërive, përbëjnë komponenët thelbësore në vetë qëllimin e këtij Plani Menaxhimi të Integruar.

Problematikat që mund të dalin në një keqmenaxhim të këtyre pasurive mund të jenë si të natyrës teknike, ashtu edhe administrative. Për konservimin, mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe vetëfinancimin e monumentit, duhet të zbatohen metoda të studiuara mirë dhe të konsoliduara edhe nga eksperienca botërore, duke patur parasysh se, parimi kryesor i tyre duhet të jetë: Moscenimi i identitetit të vendit, si pasojë i ndërhyrjeve të papërshtatshme apo të pakujdesshme. Ekspertiza teknike mbi këtë sistem vlerash, si dhe burimet akademike disponohen si në nivel kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Gjithashtu, si në nivel vendor edhe në atë kombëtar, disponohet ekspertizë e konsiderueshme dhe njohuri të konsoliduara lidhur me vlerat e objekteve në Vilën Mbretërore, por edhe atë të gjelbërimit të parkut.

## Vizioni dhe objektivat e PMI

Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave do të rijetëzohet duke i dhënë funksione të cilat nuk do të cenojnë vlerat historike, arkitektonike e ambientale të monumentit, por do ta kthejnë atë në një pikë atraktive turistike në Rajonin e Tiranës.

Nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm, ai do të arrijë të gjenerojë të ardhura për të siguruar vazhdueshmërinë e ruajtjes, të konservimit dhe të restaurimit të vlerave të tij.

Ai do të kthehet  në një destinacion elitar, i denjë për objektivin për të cilin është ndërtuar, por edhe që mirëpret miq të shtetit shqiptar dhe dinjitarë të huaj, që iu ofron vizitorëve një përvojë të rrallë dhe unike, që gjeneron interes publik dhe që siguron të ardhura për vazhdimësinë e tij.

Kjo do të arrihet duke realizuar këto objektiva:

1. Të restaurohet AHPB-ja dhe të përgatitet plani për konservim të monumentit.
2. Të rijetëzohet AHPB-ja duke ruajtur barazinë/drejtpeshën midis ruajtjes së vlerave të monumentit dhe zhvillimit turistik të tij.
3. Të përcaktohet qartë mënyra e manaxhimit të AHPB-së për të garantuar ruajtjen dhe zhvillimin e Ansamblit.

Aktualisht, Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave përdoret për organizime ceremoniale të eventeve të ndryshme me karakter shtetëror apo publik. Ndërkohë që me grupe të vogla dhe herë pas here, bëhen vizita në ndërtesën kryesore apo në park. Një pjesë e konsiderueshme e ambienteve të Ansamblit është e paaksesueshme. Ndaj edhe duhet një sistem i ri, i cili do të riorganizojnë infrastrukturën ekzistuese dhe do të ofrojnë strukturat e reja menaxhuese, të cilat janë shumë të nevojshme.

Ligji i ri Nr. 27/2018"Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", parashikon mënyra të reja për menaxhimin e siteve kulturore, mënyra të cilat i lënë hapësirë Ministrisë së Kulturës dhe partnerëve të mundshëm strategjikë, të zbatojnë Planin e Menaxhimit të Integruar të Ansamblit Historik dhe Kulturor në fjalë.

Ndërsa pasuria do të mbetet në pronësi të Qeverisë së Shqipërisë, Ministria e Kulturës do të mundësojë zbatimin e programit të Planit të Menaxhimit të Integruar, i cili do të përmirësojë ndjeshëm mbrojtjen dhe promovimin e Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave.

Mënyra e re e menaxhimit do të jetë në respekt absolut të Ligjit Nr.27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" dhe specifikisht në respekt të Nenit 18, 19 dhe 20 të tij.

Për formën e manaxhimit / administrimit duhet të respektohen Nenet 178 dhe 182-186 të këtij ligji. Neni 178 përcakton format e përdorimit të pasurive kulturore dhe nenet 182-186 përcaktojnë elementët e procesit të rijetëzimit (kufizimet, procedura, projekti dhe kontrata e rijetëzimit) e cila është forma e rekomanduar për AHPB. Forma e deritanishme dhe aktuale, ka qenë formë direkte.

Një formë e parashikuar nga ligji, Neni 182 i tij, për përdorimin (jo administrimin) e trashëgimisë kulturore, është dhe rijetëzimi, që shihet i përshtatshëm për t'u përdorur në rastin e menaxhimit të AHPB. Me një periudhë maksimale të partneritetit të parashikuar në ligj (Neni 186, Pika 5) prej 20 vitesh, pala e interesuar për partneritet, duhet të ketë financimin e duhur për të mundësuar rijetëzimin.

Gjithashtu duhet të ketë përvojën e duhur për manaxhimin e trashëgimisë kulturore, të parashikojë kufizimet e mundshme në nxjerrjen e të ardhurave, të cilat mund të mos sjellin fitime për të.

Në këtë situatë të re është e rëndësishme të adresohet roli i Gardës së Republikës në ruajtjen e AHPB-së.

Një konsideratë specifike duhet të ketë për mbikqyrjen e aktiviteteve nga një **Bord profesionistësh të fushës, i cili kontrollon dhe garanton ruajtjen e vlerave të monumentit,** si dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara si për ato shtetërore edhe për vizitorët. Ky Bord do të ketë në përbërje të tij specialistë të menaxhimit, juristë, restauratorë të arkitekturës dhe konstruksionit, konservues të veprave të artit, botanistë dhe historianë, si edhe në mënyrë të domosdoshme, një përfaqësues nga Ministria e Kulturës dhe një përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare (DSHQ). **Ky Bord duhet të shërbejë si këshillues për drejtimet kryesore të menaxhimit,** duke marrë përsipër që të sigurojë pacenueshmërinë e AHPB-në, por edhe njëkohësisht të jetë pjesë e vendimmarrjes për ato veprime që janë të lidhura direkt me këtë pacenueshmëri.

Me mënyrën e re të menaxhimit, do të kemi rritje të stafit teknik, atij të shërbimeve si edhe administrativ, të cilët do të drejtojnë dhe monitorojnë të gjitha aktivitetet brenda këtij ansambli.

Komuniteti kryeqytetas mund të ketë shumë përfitime, si në aspektin kulturor, rekreativ, por edhe në atë social dhe ekonomik, falë ngritjes së kapaciteteve, trajnimit dhe mundësive të punësimit, apo edhe falë zhvillimit turistik të zonës, i cili mund të sjellë zhvillim të mëtejshëm ekonomik. Një monument i rëndësishëm i arkitekturës, historisë dhe kulturës do t'i shtohet listës së agjendës turistike, kulturore dhe rekreative të Tiranës. Një destinacion me vlera të rralla do të mund të aksesohet nga të gjithë.

Linjat udhëzuese mbi të cilat është mbështetur hartimi i Planit të Menaxhimit të Integruar dhe **objektivat që synohet të arrihen, renditen të ndara në kategori** si më poshtë:

## Pallati, vlera arkitektonike dhe artistike

- Restaurim, Rilevim, katalogim dhe vlerësim i të gjithë elementëve arkitektonikë, të mobilimit dhe dizajnit të brendshëm, skulpturave, bazorelieveve e artefakteve të tjerë artistikë.
- Ruajtja e identitetit dhe autenticitetit të arkitekturës, dizajnit, artit dhe teknologjive inxhinjerike të kohës, nëpërmjet aplikimit të duhur të praktikave më të mira, në mënyrë që vlerat e tij të qenësishme dhe shkencore, të ofrojnë një burim të qëndrueshëm për:
  - Edukimin e brezave dhe atraksion për turizmin.
  - Të vijojë të jetë një vend ekskluziv për ceremonitë publike shtetërore kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Rritja e potencialit turistik, kulturor dhe edukativ të Ansamblit, nëpërmjet:
  - Një programi të vazhdueshëm konservimi të vlerave ekzistuese.
  - Adaptimit të një serie funksionesh ekzistuese dhe të reja kulturore, rekreative dhe shërbimi, të lidhura ngushtë me mundësitë që ofron Kompleksi, pa e dëmtuar në asnjë moment atë.

## Parku, vlerat peizazhistike dhe artistike

- Restaurimi, Rilevimi, katalogimi dhe vlerësimi i të gjitha elementëve të peizazhit të Parkut, të mobilimit urban të tij, skulpturave dhe elementëve të tjerë arkitektonikë.
- Hartimi dhe zbatimi i një programi të vazhdueshëm të monitorimit dhe mirëmbajtjes ekologjike të Parkut të Vilës, dhe vënia në dispozicion të publikut të gjerë.
- Evidentimi i itinerareve të lidhura me:
  - Artefaktet artistike.
  - Elementët historikë si dhe kombinimet e parqeve gjeometrike.
  - Bio-diversitetin e Parkut.

## Turizmi dhe infrastruktura

- Promovimi i formave të qëndrueshme të turizmit me bazë komunitare, që janë të ndjeshme ndaj mjedisit, të realizueshme në aspektin ekonomik dhe të drejta në aspektin social.
- Garantimi që të gjitha punimet ndërtimore dhe operacionet brenda Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave në të ardhmen të lehtësojnë shërbimet ndaj publikut e të marrin çertifikimin e duhur, për garantimin e ruajtjes së vlerave autentike të Ansamblit.

## Influenca në komunitet, edukimi dhe trajnimi

- Nxitja e të kuptuarit, vlerësimit dhe kujdesit që duhet të tregojnë komunitetet vendase për vlerat e veçanta arkitektonike, historike, artistike dhe ato të peizazhit të Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave.
- Transformimi i Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave në një mjedis që nxit edukimin dhe të nxënit për të gjitha moshat dhe ofron përvoja reale për të nxënit e thelluar, mbi një shumëllojshmëri temash edhe për profesionistë të fushave të lidhura me të.

## Drejtimi dhe Menaxhimi

- Krijimi i një sistemi efikas vetëfinancimi nëpërmjet krijimit të aktiviteteve dhe funskioneve të reja në pallat.
- Ruajtja e funksionit zyrtar dhe të pazëvendësueshëm në Shqipëri si një vend për pritje dhe ceremoni shtetërore.
- Zhvillimi i vizitueshmërisë së tij duke u shndërruar në destinacion elitar, i krahasueshëm me Pallatet Mbretërore në kryeqytete të ngjashme. Për t'u arritur ky qëllim, AHPB-ja ka nevojë të restaurohet, të pregatisë të paktën një itinerar të brendshëm të pallatit, itinerare të kopshteve dhe të ketë një sallë për ekspozita tematike. Detaje të mëtejshme do të paraqiten se si do të arrihet kjo pikë e rijetëzimit.

- Lejimi dhe mundësimi i zhvillimit të aktiviteteve kulturore dhe rikrijuese si në mjediset e brendshme edhe në ato të jashtme, kundrejt tarifave të rishikuara dhe të miratuara, të cilat mund të organizohen nga organizata të tjera qeveritare, ente publike dhe private, organizata jo-fitimprurëse, kompani ose individë. Numri i pjesëmarrësve dhe llojet e aktiviteteve, duhet të jenë të tilla që të mos prekin integritetin fizik të AHPB-së, florën e kopshteve të AHPB-së dhe sidomos imazhin e AHPB-së si një destinacion elitar. Të tilla aktivitete mund të jenë, ekspozita, simpoziume, aktivitete kulturore (shfaqje teatrale me një numër të përcaktuar pjesëmarrësish), xhirime të filmave artistikë, sfilata apo dhe koncerte.
- Mundësimi dhe lejimi i organizimit të aktiviteteve edukative- didaktike, kundrejt tarifave të rishikuara dhe të miratuara (mund të ketë dhe raste shumë të rralla që përjashtohen nga tarifimi), të tilla si studime të AHPB-së dhe kopshtit të tij, kërkime shkencore të cilat rrisin njohuritë mbi AHPB-në etj.
- Mundësimi dhe lejimi i akomodimit për një përiudhë të shkurtër disa ditore të personaliteteve, shqiptarë apo të huaj të ftuar nga Qeveria Shqiptare apo nga institucione të rëndësishme shtetërore. Duke patur parasysh që mikpritja është një shërbim që ka nevojë për shumë kushte specifike, ky nuk është një rekomandim parësor për rijetëzimin e AHPB-së.
- Krijimi i funksioneve të reja në pallat, (vizita të oganizuara në grupe, sallë ekspozite, sallë mbledhjeje, akomodim personalitesh, strukturë didaktike në funksion të eksperiencave konservuese dhe restauruese), do të jenë burim të ardhurash për menaxhimin e pallatit dhe do të ndikojnë në rritjen e të ardhurave që do të sigurojnë konservimin dhe mirëmbajtjen e tij.
- Krijimi i një sistemi menaxhimi bashkëkohor nëpërmjet një aplikacioni softëare, në të cilin të përfshihen të gjithë elementet e nevojshëm, duke filluar nga shitja e biletave, kontrolli hyrje daljeve, informacioni për turistët dhe stafin, etj.
- Krijimi i një databaze, arkivë dokumentash, që të dokumentojë dhe menaxhojë pasurinë e vlerave arkitektonike, artistike, mjedisore etj, të Pallatit dhe Parkut të tij. (Museum Integrated Information Management Systems)

# 2.0 HYRJE

Grupi i profesorëve të Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT), u kontraktua nga Ministria e Kulturës, për të hartuar një Plan Menaxhimi i Integruar (PMI) për Ansamblin Historik të Pallatit të Brigadave (AHPB). Ky grup është i përbërë nga ekspertë të spikatur të fushave të ndryshme, të cilët njohin shumë mirë vlerat historike të veçanta të Ansamblit.

Në mënyrë më të detajuar, me objektivat e PMI-së synohet sa më poshtë:

1. Paraqitja e propozimeve për vizione dhe funksione të qarta për menaxhimin efikas dhe eficient të Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave.
2. Mbështetja në praktikat më të mira për menaxhimin e vlerave kulturore dhe natyrore të Ansamblit, sie dhe mbrojtja e Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave.
3. Hartimi i propozimeve të cilat të mund të japin disa mundësi të zhvillimit ekonomik brenda Ansamblit, duke përfshirë funksione të reja dhe aktivitete rekreative dhe kulturore, që i përshtaten më së miri natyrës së Ansamblit, vlerës së tij artistike e arkitektonike, si dhe pozicionit të tij në raport me qytetin e Tiranës.

Qëllimi i këtij Plani të Menaxhimit të Integruar nuk është riinterpretimi i këtij informacioni për të shkruar një histori definitive për Kompleksin, edhe nëse kjo do të ishte realisht e mundur. Në fakt, qëllimi i tij është shqyrtimi dhe dhënia e rekomandimeve për aspekte të ndryshme si funksione të reja, forma e menaxhimit dhe mbrojtja e Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave.

## Kuadri ligjor

Të gjitha politikat dhe rekomandimet në përmbajtje të këtij plani menaxhimi janë në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, legjislacioni i mëposhtëm përcakton kontekstin ligjor përkatës:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për periudhën 2015–2020 (SKZHI-II) (2015).
- Strategjia Kombëtare e Transportit dhe Plani i Veprimit, për periudhën 2016–2020, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (2016).
- Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme për periudhën 2015–2020 (2016).
- Plani i Përgjithshëm Kombëtar – Shqipëri 2030, Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (2016).

- Politikat Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit në Shqipëri, Ministria e Mjedisit (2015).
- VKM Nr.229, Datë 23.4.2004, Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë, (Ndryshuar me VKM nr.735, datë 25.11.2005; ndryshuar me VKM nr.583, datë 23.08.2006; VKM nr.754, datë 9.11.2006 ; VKM nr.1544. datë 19.11.2008 ; VKM nr.436, datë 11.07.2012 ; VKM nr.832. datë 15.09.2013; VKM nr.442. datë 4.07.2014 ; VKM nr.32. datë 21.01.2015).
- VKM Nr.34, date 7.1.1999, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe trajtimin e personaliteteve të larta, (ndryshuar me VKM nr. 678, datë 15.12.2000; nr. 399, datë 22.8.2002; nr. 411, datë 11.7.2007; nr. 5, datë 14.1.2012; nr. 463, datë 27.5.2015; nr. 620, datë 1.11.2017; nr. 768, datë 26.12.2018).
- Ligji Nr. 9385/2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor".
- Ligji Nr. 9587/2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit" i ndryshuar me Ligjin Nr. 37/2013.
- Ligji Nr. 10431/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".
- Ligji Nr. 10448/2011 "Për lejet mjedisore".
- Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 752, datë 11/11/2004, ku Pallati i Brigadave dhe parku i tij janë shpallur "Ansambël Historik" dhe "Zonë e Stimuluar".
- Ligji 33/2021, Ligji nr.8869 datë 22.05.2003 dhe VKM nr.590 datë 05.09.2007, "Për përcaktimin e banesave të personaliteteve të larta shtetërore të vendit, të selive, rezidencave dhe objekteve të tjera shtetërore, që do të ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë".
- Ligji Nr. 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".
- Ligji Nr. 10390/2011 "Për përdorimin e plehrave për bimët".
- Ligji Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë".
- VKM Nr. 593 (9 tetor 2018) "Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura".
- VKM Nr. 57 (6 shkurt 2019) "Për kriteret dhe modalitet për zonimin territorial brenda zonave të mbrojtura mjedisore".
- VKM Nr. 302 (10 maj 2019) "Për kriteret e ushtrimit, miratimit dhe monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura mjedisore".
- Urdhër Nr. 148 (21 shkurt 2013), "Për miratimin e strukturës së standardizuar të Planit të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur".
- Plani i Përgjithshëm Vendor: Tirana -2030.
- Ligji nr. 93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar.

- "Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023 dhe të Planit të Veprimit", miratuar me VKM nr. 413, datë 19.6.2019
- Ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".

**Ansambël Historik i mbrojtur që nga viti 2004**

Pallati i Brigadave dhe parku i tij janë shpallur "Ansambël Historik" dhe "Zonë e Stimuluar" me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 752, datë 11/11/2004



VENDIM
Nr. 752, date 11.11.2004

PER SHPALLJEN "ANSAMBEL HISTORIK" DHE "ZONE E STIMULUAR" TE PALLATIT TE BRIGADAVE DHE TE PARKUT TE TIJ

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës, te pikës 1 te nenit 31 te ligjit nr.9048, date 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore" dhe te nenit 2 te ligjit nr.7665, date 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave qe kane përparësi turizmin", te ndryshuar, me propozimin e Ministrit te Rregullimit te Territorit dhe te Turizmit dhe te Ministrit te Kulturës, Rinise dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pallati i Brigadave dhe parku i tij te shpallen:
a) "Ansambël historik" dhe te vendosen nen mbrojtjen e shtetit;
b) "Zone e stimuluar", me përparësi zhvillimin e turizmit.
2. Ministria e Rregullimit te Territorit dhe e Turizmit dhe Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sporteve, ne bashkëpunim me institucionet e specializuara, te hartojnë dhe te propozojnë programin e masave për restaurimin e Pallatit te Brigadave dhe te parkut te tij dhe kthimin e tyre për destinacion turistik.
3. Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sporteve, brenda 3 muajve nga hyrja ne fuqi e këtij vendimi, te hartoje dhe te paraqesë për miratim ne Këshillin e Ministrave rregulloren e administrimit te këtij ansambli historik.
4. Ngarkohen Ministri i Rregullimit te Territorit dhe i Turizmit, Ministri i Kulturës, Rinise dhe Sporteve dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano



Statusi "zonë e stimuluar", nuk është më në fuqi me miratimin e ligjit të ri nr. 93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar.

Pallati i Brigadave përmendet në disa pika në **VKM Nr.229, Datë 23.4.2004**, "Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë, (Ndryshuar me VKM nr.735, datë 25.11.2005; ndryshuar me VKM nr.583, datë 23.08.2006; VKM nr.754, datë 9.11.2006 ; VKM nr.1544. datë 19.11.2008 ; VKM nr.436, datë 11.07.2012 ; VKM nr.832. datë 15.09.2013; VKM nr.442. datë 4.07.2014 ; VKM nr.32. datë 21.01.2015)".

Në kapitujt dhe pikat e mëposhtme të kësaj VKM-je, kuptohet qartë kur dhe si Pallati i Brigadave vihet në përdorim të ceremonive më të rëndësishme të shtetit shqiptar:

KAPITULLI II

CEREMONIALI DIPLOMATIK

**2. Paraqitja e kredencialeve Presidentit të Republikës**

2.1. Protokolli i Shtetit njofton ambasadën përkatëse për datën, orën dhe vendin e paraqitjes së kredencialeve, Presidentit të Republikës nga ana e ambasadorit të ri.

2.2. Ditën dhe orën e caktuar në vendin ku është akomoduar ambasadori (jo në selinë e tij) paraqitet makina ceremoniale, në të cilën vendoset flamuri kombëtar shqiptar dhe ai i shtetit të huaj. Nën eskortën e dy motoçikletave ceremoniale, ajo drejtohet për në Pallatin e Brigadave. Diplomatët që shoqërojnë ambasadorin zënë vend në makinën e dytë të përfaqësisë, e cila ndjek makinën ceremoniale.

**8. Pjesëmarrja në ceremonitë zyrtare**

8.2. Zakonisht trupi diplomatik ftohet të marrë pjesë në këto ceremoni kryesore zyrtare:
- Ceremonia në Pallatin e Brigadave, me rastin e Festës Kombëtare.
- Ceremonia në Pallatin e Brigadave, me rastin e Vitit të Ri.

KAPITULLI IV
CEREMONIALI ZYRTAR I AUTORITETEVE MË TË LARTA TË SHTETIT

**3. Ceremonia e fillimit të detyrës së Presidentit të Republikës**
3.1. Ceremonia e fillimit të detyrës së Presidentit të Republikës zhvillohet si një e tërë, e ndarë në dy momente kryesore, në sallën e Kuvendit dhe në Pallatin e Brigadave.

**6. Pritje në Presidencë**
6.2. Nëse vizitori është kryetar shteti në vizitë zyrtare, organizohet për nder të tij ceremonia e nderit në aeroport ose në Pallatin e Brigadave, sipas skemës së miratuar.

**8. Betimi i qeverisë**
8.1. Ceremonia e betimit të qeverisë së re zhvillohet në selinë e Presidencës së Republikës ose në Pallatin e Brigadave.

KAPITULLI V

VIZITA DHE TAKIME

**1. Pritja e delegacioneve të huaja të nivelit të lartë**

Përveçse në aeroport, ceremonia mund të zhvillohet në Pallatin e Brigadave, në selinë e Presidentit, të Kryeministrit ose vende të tjera sipas skemave të miratuara. Në pikat kufitare tokësore nuk zhvillohet ceremoni zyrtare.

KAPITULLI VII

CEREMONITË KRYESORE ZYRTARE

**2. Ceremonia e ngritjes së flamurit kombëtar**

2.13. Për nder të të gjithë pjesëmarrësve, pushteti vendor i Vlorës shtron një drekë. Kryetari i bashkisë ngre me këtë rast një dolli dhe përshëndet të gjithë të ftuarit.

Ceremonia mbyllet në orën 16:00. *Pjesëmarrësit shpërndahen për t'u mbledhur përsëri në Tiranë, në Pallatin e Brigadave, për pritjen e festave zyrtare të Pavarësisë dhe të Çlirimit të Atdheut.*

**4. Ceremonia e pritjes së Vitit të Ri - Diplomatik**

4.1. Brenda 15 ditëshit të parë të muajit janar të çdo viti, Presidenti i Republikës jep për trupin diplomatik një pritje me rastin e Vitit të Ri. Pritja organizohet në Pallatin e Brigadave. Organizimi i saj dhe respektimi i përparësisë bëhet nga Protokolli i Shtetit.

**10. Ceremoni funebre shtetërore**

10.3 Trupi i të ndjerit vendoset në hollin e Pallatit të Kongreseve ose në ndonjë rezidencë tjetër qeveritare në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" (në objektin e kultit, nëse familja kërkon ceremoni fetare), ku fillojnë edhe homazhet zyrtare dhe publike për përcjelljen e tij për aq ditë sa është zija e shpallur. Rrugëkalimi i njerëzve rregullohet nga truproja e nderit me uniformë ceremoniale. Për kryerjen e homazheve publike vendoset një orar i caktuar gjatë gjithë periudhës së zisë.

Ndërkohë që në:

VKM Nr.34, date 7.1.1999, "Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe trajtimin e personaliteteve të larta" (ndryshuar me VKM nr. 678, datë 15.12.2000; nr. 399, datë 22.8.2002; nr. 411, datë 11.7.2007; nr. 5, datë 14.1.2012; nr. 463, datë 27.5.2015; nr. 620, datë 1.11.2017; nr. 768, datë 26.12.2018), paraqitet vënia në administrim të shërbimeve qeveritare të AHPB.

Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare është Person Juridik në varësi të Kryeministrit të Shqipërisë dhe vepron në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.34 datë 07.01.1999, i ndryshuar. Ajo e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin për ndërmarrjet Nr. 7582 datë 13/07/1992. Një nga detyrat kryesore të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare është administrimi i disa prej pasurive të paluajtshme shtetërore, midis tyre Pallatin e Brigadave.

Intitucioni i Gardës funksionon në bazë të Ligjit 33/2021, të Ligjit nr.8869, datë 22.05.2003 dhe të VKM nr.590, datë 05.09.2007 "Për përcaktimin e banesave të personaliteteve të larta shtetërore të vendit, të selive, rezidencave dhe objekteve të tjera shtetërore, që do të ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Garda e Republikës ka përgjegjësi dhe kryen këto detyra kryesore:

a) Organizon dhe kryen ruajtjen dhe mbrojtjen fizike të personaliteteve;

b) Organizon dhe kryen ruajtjen, mbrojtjen e brendshme e të jashtme të objekteve.

Në Objektet e Rëndësisë së Veçantë, ku kryejnë aktivitete Personalitetet e Larta Shtetërore të Vendit dhe delegacionet e huaja, të cilat monitorohen dhe ruhen nga Garda e Republikës, midis tyre është dhe territori dhe godina e Pallatit të Brigadave.






Figura:  Përcaktimi aktual i zonës së Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave

## Qasja dhe çështjet kyçe

Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave është një vlerë e jashtëzakonshme në territorin e qytetit të Tiranës, i pozicionuar shumë pranë qendrës, midis një peizazhi mjaft interesant si vazhdim i Parkut të Madh të Tiranës. Ky ansambël është momentalisht i paaksesueshëm nga publiku i gjerë, pra nga qytetarët dhe turistët e paautorizuar. Ajo që kërkohet është një hapje totale e të gjitha resurseve dhe burimeve ekzistuese në të, duke menduar edhe futjen e funksioneve të tjera të cilat e bëjnë atë të qëndrueshëm financiarisht. Për këtë kërkohet një plan menaxhimi i cili shikon 2 anët e medaljes, konservimin dhe mirëmbajtjen e ansamblit kulturor, duke minimizuar në të njëjtën kohë edhe cenueshmërinë e tij.

Duke parë edhe shembuj të ngjashëm, konstatohet se të gjithë këto komplekse zakonisht përballen me problematika kontradiktore lidhur me aksesin dhe konservimin, siç janë edhe në rastin e Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave. Ky kombinim në fakt është sa i thjeshtë, aq edhe i ndërlikuar: Si të mbrojmë vlerat e Ansamblit, jo vetëm nga degradimi që vjen me vetë kohën, por edhe nga vetë vizitorët apo përdoruesit e Ansamblit. Këtij i duhet shtuar edhe fakti që ansambli përdoret edhe për ceremoni apo evente shtetërore të kategorisë mjaft të lartë.

Elementi kyç i të gjithë procesit, është ai i konservimit të asaj që ekziston, duke e mbajtur në gjendjen që është pjesën me vlera të patjetërsueshme të saj, duke ndjekur një qasje ndërhyrëse restauruese për monumentet dhe peizazhin e tij përreth. Kjo çështje kërkon studim të kujdesshëm dhe plane realiste, të zbatueshme dhe të qëndrueshme për të ardhmen.

Ndërkohë evidentohet domosdoshmëria që në disa pjesë të Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave, duhet të ndërhyhet me urgjencë me projekte restauruese, pasi koha dhe mosha e pjesëve të ndryshme të tij, kanë bërë që të ketë probleme të lidhura me infiltrimin e ujrave, apo me probleme të sistemeve të ndryshme inxhinierike. Këto projekte tashmë duhet të reflektojnë ndërthurjen e pjesës së konservuar, me inovacionet inxhinierike të përshtatura për funksionet e vjetra dhe të reja në sit.

Një plan menaxhimi dedikuar këtij ansambli, i cili nuk merr në konsideratë të gjithë faktorët, mund të sjellë probleme që mund të pasohen me humbjen e vlerave kulturore dhe identitetit, dobësimin ekonomik dhe shkatërrimin e monumentit e të  mjedisit të tij përreth. Këto pasoja janë parë edhe gjetkë, dhe duhen shmangur patjetër në rastin e Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave.

Qasja ndaj hartimit të Planit të Menaxhimit të Integruar të këtij kompleksi, është bazuar gjerësisht në mendimin se pasuri të këtij karakteri të trashëgimisë kulturore,  mund dhe duhet të jenë një faktor i rëndësishëm në mbështetjen e zhvillimit të turizmit, jetës publike dhe kulturore, duke u kthyer edhe në një mekanizëm financiar zhvillimi dhe punësimi.

Kjo kërkon që qasja të sigurojë mbrojtjen afatgjatë të Ansamblit dhe pasurive të

tij kulturore dhe natyrore edhe në një të ardhme dinamike, konkurruese dhe tërheqëse. Gjithashtu, kjo nënkupton se planet duhet të kenë ndikim të madh, të jenë novatore dhe të guximshme në qasjen e tyre.

Prandaj, fokusi i këtij plani qëndron mbi gjetjen e ekuilibrit ndërmjet nevojave të

dukshme të Ansamblit, lidhur me restaurimin dhe konservimin e tij, si edhe nevojave e aspiratave afatgjata të turizmit por edhe të njerëzve që do të kujdesen për të.

Duke ardhur në disa konkluzione të përgjithshme, që Plani i Menaxhimit i Integruar i Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave të funksionojë, nevojitet angazhimi i harmonizuar i të gjitha palëve: Ministrive dhe Agjencive Qeveritare, DSHQ-ja dhe Ministrisë së Kulturës, IKTK-së dhe palëve që janë pjesë e tij, të cilat duhet të marrin përgjegjësinë për të punuar bashkërisht me mirëkuptim, drejt arritjes së qëllimit të përbashkët.

## Struktura menaxhuese

Sot, në vende të ndryshme me Ansamble kulturorë të këtij karakteri, gjejmë shembuj të mirë të menaxhimit të kësaj tipologjie të trashëgimisë kulturore, si dhe mënyra se si të bëhen të aksesueshme për publikun.

Nga një këndvështrim i orientuar kryesisht nga konservimi dhe mbyllja për publikun, duhet shtuar patjetër një qasje e re, ku vlerat që lidhen me trashëgiminë e paprekshme arkitektonike, peizazhin, historinë kulturore, dizajnin dhe mobilimin e periudhës në të cilën është ndërtuar, të luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e kulturore - edukative dhe rekreative – turistike, jo vetëm të Tiranës, por edhe të Shqipërisë.

Nga ana tjetër, nëse kjo vepër hapet për publikun e gjerë dhe gjeneratat pasardhëse, ata do të njihen padyshim me këtë vepër të rëndësishme të arkitekturës, dizajnit dhe peizazhit, por edhe do të sjellin të ardhura të konsiderueshme të cilat do të shkojnë në favor të restaurimeve të ndryshme, ruajtjes së vlerave si dhe menaxhimit të tij të përditshëm.

Duke marrë parasysh sa më sipër, lind nevoja për një strukturë autonome drejtimi dhe menaxhimi, e cila harmonizon kërkesat e DSHQ-së, Ministrisë së Kulturës, si dhe në bashkëpunim me specialistë e menaxherë të pasurive kulturore, specialistë dhe përfaqësues nga fushat akademike, si edhe personalitete, të nxisë ngritjen e fondeve, menaxhimin e tyre dhe promovimin e Ansamblit.

Rijetëzimi i Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave kërkon një kuadër manaxhues që të mund të ngrejë fonde, të planifikojë dhe të zbatojë rijetëzimin. Aktualisht DSHQ-ja nuk ka kapacitetet e mundshme që të manaxhojë këtë proces rijetëzimi dhe as të manaxhojë një destinacion për vizitorët në shkallë të gjërë. DSHQ-ja merret ekskluzivisht me organizimin e ceremonive përfaqësuese shtetërore.

Eksperienca  e deritanishme me Pallatin e vërteton këtë.

Ndërkohë që Ministria e Kulturës ka përvojën për të tilla projekte restauruese – rijetëzuese, por që nuk është në tagrin e Ministrisë që të manaxhojë një nga funksionet kryesore të deritanishme të Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave, atë të pritjeve ceremoniale qeveritare.

Një strukturë autonome, që funksionon në kuadrin e rijetëzimit, do të jetë një alternativë për të manaxhuar Ansamblin Historik të Pallatit të Brigadave dhe për të harmonizuar procesin e rijetëzimit të tij. Ajo strukturë duhet të ketë parasysh që AHPB-ja është një objekt me kërkesa të veçanta sigurie dhe do të vazhdojë të jetë i tillë për vetë funksionet ceremoniale që do të vazhdojë të luajë.

Thënë kështu, qëllimi është që të ofrohet një mënyrë se si të mundësohet restaurimi dhe rijetëzimi i AHPB-së, ndërkohë që AHPB-ja ruan funksionet e tij aktuale dhe të hapet masivisht për publikun e gjerë. Është e nevojshme të sqarohet se termi rijetëzim në këtë kontekst, nuk i referohet përdorimit që ka në Ligjin Nr.27, Datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, por i referohet kuptimit primar që ka në literaturën e trashëgimisë kulturore, “plotësimi i diçkaje me jetë dhe veprimtari të reja”.

PMI-ja rekomandon që struktura menaxhuese të këshillohet nga një Bord profesionistësh të fushës, i cili do të jetë i nevojshëm për ndihmuar në çështje të lidhura me elemente të rëndësishme të pasurinë kulturore të AHPB-së, si edhe të lehtësojë rakordimet me Ministrinë e Kulturës dhe Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

Marrëveshjet e reja ndërmjet strukturës menaxhuese që do të përcaktohet si pasojë e procesit të rijetëzimit dhe strukturave përkatëse shtetërore, duhet të kenë qëllim bazë ruajtjen dhe përçimin e trashëgimisë sonë kombëtare për brezat e ardhshëm. Për ta siguruar një gjë të tillë, duhet ecur sipas legjislacionit të miratuar në Republikën e Shqipërisë.

## Konsultimi

Për hartimin e Planit të Menaxhimit të Integruar të Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave, u organizuan takime konsultuese me një sërë grupesh interesi dhe palësh të interesuara. Gjatë procesit të konsultimit me të gjitha këto palë interesi, vëmendje e veçantë iu kushtua përfshirjes së një sërë bashkëbiseduesish me formime dhe me interesa të ndryshme mbi Ansamblin Historik të Pallatit të Brigadave, dhe të gatshëm për të diskutuar në mënyrë transparente dhe konstruktive mbi përvojat, opinionet dhe aspiratat e tyre.

Përgatitja e këtij PMI-je u mundësua falë kontributeve të një numëri të madh personash me kontribute të posaçme profesionale. Rëndësi të veçantë pati diskutimi me departamentet qeveritare dhe ministritë si më poshtë:

- Stafi i Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave
- Ministria e Kulturës
- Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK)
- Drejtoria e Shërbimeve qeveritare (DSHQ)
- Universiteti Politeknik i Tiranës

Diskutime konstruktive u bënë me këto palë interesi, për tema të lidhura me:

- Informimin e tyre mbi mundësitë dhe problematikat të Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave, në terma afatmesme dhe afatgjata.
- Zhvillimin e kuptueshmërisë mbi nevojat dhe interesat e tyre.
- Identifikimin e roleve dhe përgjegjësive të duhura.
- Vlerësimin e kërkesave për ngritjen e kapaciteteve.
- Planifikimin e programeve të nevojshme të edukimit dhe trajnimit.

## Praktika më e mirë

“Praktika më e mirë” nga ana funksionale, në përdorim të përgjithshëm, tenton të sjellë në fokus, duke parë cilësitë dhe mundësitë unike të AHPB-së, të përbashkëtat me organizma të ngjashëm nëpër botë, por dhe me objekte të tipologjisë së ngjashme në funksion e në madhësi të objektit. Në rastin e Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave, këto ngjashmëri mund të gjenden në konservimin dhe restaurimin, funksionet e shtuara, menaxhimin e vizitorëve, drejtimin dhe menaxhimin mjedisor, interpretimin dhe angazhimin e komunitetit profesionist dhe të thjeshtë.

**Modelet e ngjashme**

**Site të Trashëgimisë Botërore me vlera të integruara kulturore dhe natyrore**

Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave njihet për vlerat e tij kulturore të jashtëzakonshme dhe normalisht, ekziston mundësia që çdo pjesë e tij, si arkitektonike ashtu dhe peizazhore, të vlerësohet maksimalisht. Kjo do ta vendoste këtë kompleks në të njëjtën kategori me site të njohura në rang botëror të tilla si:

- Palazzo Pitti, Firence, Itali
- Palazzo Strozzi, Firence, Itali
- Residenz München, Mynih, Gjermani

Studimi analitik i secilit prej tyre na mëson shumë mbi mënyrat se si shfrytëzohen funksionalisht dhe se si nëpërmjet këtyre funksioneve dhe rijetëzimit, kthehen në qendra të rëndësishme turistike dhe kulturore.

- **PALAZZO PITTI NË FIRENCE,** Itali – Njihet si një sit i jashtëzakonshëm me rëndësi botërore në të cilin bëjnë pjesë një seri ndërtesash dhe parqesh të gjelbëruara, por edhe si një model i suksesshëm menaxhimi, të të gjitha resurseve me funksione atraktive për qytetarët dhe



turistët nga mbarë bota.

I blerë në vitin 1550 nga Cosimo I de'Medici dhe gruaja e tij Eleonora di Toledo, për ta transformuar atë në rezidencën e re të Dukës së Madh, Palazzo Pitti u bë shpejt simboli i fuqisë së konsoliduar të Medici-ve në Toskanë. Ai ishte edhe pallati i dy dinastive të tjera, ai i Habsburg-Lorena (pasardhës të Medici-ve nga viti 1737) dhe i Savojës, të cilët banuan atje në cilësinë e mbretërve të Italisë nga viti 1865.

Aktualisht Kompleksi ofron katër sisteme të mëdha brenda vetes:

1. Vetë Palazzo Pitti është i hapur për publikun dhe ka katër muze të ndryshëm të vizitueshëm:

- Pasuria e Dukës së Madh në katin e parë
- Galeria Palatine dhe Apartamentet Perandorake e Mbretërore në katin fisnik të Pallatit
- Galeria e Artit Modern
- Muzeu i Modës dhe Kostumeve në kati i dytë.

2. Kopshti i mrekullueshëm i Bobolit shtrihet pas Palazzo Pitti. Medici-t e krijuan modelin e kopshtit – park italian, që u bë shembull për të gjitha kopshtet mbretërore evropiane. Zona e gjerë e gjelbër, përbën një muze të vërtetë në ajër të hapur, ku përveç peizazhit dhe botanikës, mund të shijohen edhe statuja nga Lashtësia apo Rilindja, të zbukuruara me shpella dhe me shatërvanë të mëdhenj.



3. Galeria Uffizi zë të gjithë katin e parë dhe të dytë të ndërtesës së madhe të ndërtuar midis viteve 1560 dhe 1580 me një projekt të Giorgio Vasari. Ai  është një nga muzetë më të famshëm në botë për koleksionet e tij të jashtëzakonshme të skulpturave dhe pikturave antike, (nga Mesjeta deri në Epokën Moderne). Koleksionet e pikturave të Shek. XIV dhe të Rilindjes, përmbajnë disa kryevepra absolute të artit të të gjitha kohërave: Giotto, Simone Martini, Piero della Francesca, Beato Angelico, Filippo Lippi, Botticelli, Mantegna, Correggio, Leonardo, Raffaello, Michelangelo, Caravaggio, si dhe kryevepra të pikturës evropiane, veçanërisht gjermane, holandeze dhe flamande. Jo më pak i rëndësishëm në panoramën e artit

   italian është koleksioni i statujave dhe busteve nga Lashtësia, të familjes Medici. Koleksioni zbukuron korridoret e Galerisë dhe përfshin skulptura të lashta romake, kopje të origjinaleve të humbura greke.
4. Korridori i shkëputur nga toka që lidh Uffizi-n me Palazzo Pitti është një udhëtim emocionues, i cili të çon në zbulimin e qytetit nga këndvështrime befasuese dhe të papritura. Projektuar nga Giorgio Vasari për Cosimo I de 'Medici, korridori shkon për rreth nji kilometër mbi qytet dhe lumë, hyn në pallate, rrethon Torre de' Mannelli, ka pamje nga Kisha e Santa Felicita dhe mbërrin në Pitti dhe Boboli. Vizita në korridor, e mundur me një biletë speciale, nis nga një hyrje *“ad hoc”* në katin përdhe të Uffizi-t, për të vazhduar mbi Ponte Vecchio dhe për të arritur në Boboli dhe në Palazzo Pitti.

Për pjesën e menaxhimit është krijuar një Institut, në varësi të Ministrisë së Kulturës në Itali, i cili e merr emrin “Instituti MiBAC” dhe gëzon një autonomi të veçantë. Në statut të këtij Instituti është cituar aktiviteti i tij në lidhje me kompleksin:

- Hulumtim dhe studim mbi koleksionet dhe pasuritë e mbajtura;
- Ruajtje, restaurim, mirëmbajtje dhe përmirësim i koleksioneve  dhe

aseteve;

- Mësimdhënie, trajnim dhe shpërndarje e përmbajtjeve;
- Katalogim, zhvillim, konservim dhe rritja e koleksioneve;
- Menaxhim i sigurisë dhe vendosjes;
- Huatë e aseteve nga koleksionet e tyre;
- Menaxhim i burimeve njerëzore, financiare dhe instrumentale;
- Komunikim dhe promovim i njohurive për koleksionet;
- Organizim i ekspozitave, konferencave, eventeve dhe nismave të tjera publike,
- Prodhim editorial etj.

• **PALAZZO STROZZI në Firence,** Itali – Edhe ky sit dallohet për një menaxhim dinamik të orientuar sidomos mbi eventet kulturore dhe tematike, duke rivlerësuar të shkuarën. I blerë nga shteti në vitin 1998, iu dha me koncesion Bashkisë së Firences për ta përdorur sërish si vend për veprimtari kulturore dhe ekspozuese.

Fondacioni Palazzo Strozzi lindi në vitin 2006 për ta menaxhuar atë dhe është një strukturë mikse publike dhe private, nga të parat e këtij niveli në Itali. Palazzo Strozzi është i hapur për publikun me bukurinë e ambienteve të tij të brendshme, të cilat janë të vizitueshme, ekspozitat e artistëve bashkëkohorë që preformojnë me krijimet e tyre mjaft të veçanta, si dhe me shërbime të ndryshme rekreative.

Palazzo Strozzi është një kryevepër e arkitekturës së Rilindjes në Firence dhe një qendër dinamike kulturore ndërkombëtare. Ai përfaqëson një pikë referimi në skenën italiane: një platformë në të cilën prodhohet dhe shijohet arti përmes një programi të pasur ekspozitash dhe aktivitetesh kulturore. Një vend simbolik për jetën e Palazzo-s është oborri historik i Rilindjes, një shesh i hapur ndaj qytetit, ku më shumë se dy milionë njerëz kalojnë çdo vit dhe ku organizohen koncerte, shfaqje dhe instalacione nga artistë bashkëkohorë.



Strozzi Fondacioni Palazzo, një fondacion publik-privat kryesuar nga një Bord i Pavarur i Drejtorëve, paraqet një përparim të rëndësishëm të mënyrës së menaxhimit të institucioneve kulturore italiane dhe të shprehjes së pavarur të mbështetësve të tij institucionalë dhe jo-institucionalë: Bashkia e Firences, Rajoni Tuskanës, Dhoma e Tregtisë së Firences; Fondazione CR Firenze, Komiteti i Partnereve të Palazzo Strozzi, Intesa Sanpaolo S.p.A.

- **RESIDENZ MÜNCHEN, Mynih, Gjermani,** ka ofruar modelet e praktikave më të mira të menaxhimit të siteve të këtij karakteri, duke e kthyer në një destinacion të madh të vizitorëve të ndryshëm. (Për shkak të origjinës së saj si rezidencë mbretërore, Administrata e Pallatit Mbretëror Bavarez kujdeset për pallatet dhe rezidencat që mbetën pasi ish-familja mbretërore nuk ishte më në pushtet.

  Megjithatë, përveç kësaj, ajo ka marrë gradualisht një sërë pronash të tjera, dhe aktualisht përfaqësohet në secilin nga shtatë rajonet e Bavarisë me 45 pallate, kështjella dhe rezidenca, si dhe monumente të tjera dhe shtëpi artistësh, 32 kopshte historike dhe 21 liqene.)

  Nga viti 1508 deri në vitin 1918, Rezidenca e Mynihut ishte rezidenca dhe selia e qeverisë së dukës, e fisnikëve dhe e mbretërve bavarezë. Me kalimin e shekujve, princat transformuan një kështjellë në cepin Veri – Lindor të fortifikimeve të qytetit ("Neuveste", 1385) në një rezidencë të mrekullueshme, si dhe zgjeruan oborret dhe kopshtet në qytet.



Dhomat dhe koleksionet e artit nga epokat e Rilindjes, barokut të hershëm dhe rokokos deri në klasiçizëm, dëshmojnë ndjenjën e artit dhe aspiratave politike të shtëpisë Ëittelsbach. Pas shkatërrimeve të rënda gjatë Luftës së Dytë Botërore, rezidenca u rindërtua në vitin 1945. Sot, me muzetë e Administratës së Pallatit Bavarez (Residenzmuseum, Thesar, Teatri Cuvilliés) dhe institucione të tjera kulturore, ajo përfaqëson një nga komplekset më të mëdha muzeale në Bavari.

Nga ana funksionale, kompleksi funksionon si disa muze me hapësira të ndara nga njëra nga tjetra, e njëkohësisht edhe me hapësira të parkut, të vizitueshme. Ndërkohë që pjesë të ndryshme mund te jepen me qira për festa të ndryshme, ceremoni publike e private, koncerte, etj.



## Konservimi dhe restaurimi

Konservimi i Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave është i pari qëllim që shtron PMI-ja si pikë nistore e domosdoshme. Ky konservim dhe restaurim, ka për qëllim të nxjerrë në pah rëndësinë e trashëgimisë kulturore, duke ruajtur, sa më shumë të jetë e mundur, historinë e plotë të Ansamblit, me të gjitha elementët përbërës të tij. Parimet e konservimit që duhet të aplikohen në këtë kompleks, synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e plotë përmes ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese. Këto ndërhyrje do të kryhen për të:

- Ndaluar degradimin e pjesëve me vlera kulturore.
- Restauruar ato pjesë të dëmtuara në mënyrë mjaft të kujdesshme, duke pasur parasysh mbajtjen e tyre në gjendjen ekzistuese.
- Përshtatje të ambienteve pa vlera të veçanta, në funksione të reja në shërbim të Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave
- Garantim të sigurisë e vizitorëve dhe veprave të artit.

Aspekt i rëndësishëm i planit të konservimit dhe restaurimit të Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave është prioritizimi i detyrave të mëposhtme:

- Hartimi i Planeve për punime në strukturë konstruktive, për të bërë evidentim dëmtimesh dhe korrigjim me përforcim të elementeve konstruktivë.
- Hartimi i Planeve dhe punimeve për evitimin e infiltrimeve të ujit, ku për shkak të mungesës së ndërhyrjeve në Pallat gjatë viteve të fundit, ka pasur dëmtime nga lagështira sidomos në katin e fundit.
- Hartimi i Planeve dhe punimeve për sistemin elektrik dhe hidraulik të ndërtesës, nga të cilat mund të shkaktohen edhe problematika për sa i përket sigurisë së ndërtesës dhe vizitorëve.
- Hartimi i Planeve për konservim dhe restaurim të vlerave arkitektonike të rifiniturës, të mobilieve, të elementëve të dekorimit të interierit e eksterierit.
- Hartimi i një kalendari mirëmbajtjeje të qëndrueshëm dhe me kosto të mirëpërcaktuara për të gjitha elementët e Ansamblit, duke përfshirë dhe ato që mund të lindin nga ndërhyrjet e konservimit, restaurimit dhe mirëmbajtjes.

## Menaxhimi i vizitorëve dhe kapaciteti mbajtës

Menaxhimi i vizitorëve dhe i përdoruesve është aspekt thelbësor për qëndrueshmërinë e Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave si një destinacion ndërkombëtar turizmi. Për çdo kompleks me vlera të trashëgimisë kulturore, duhet të arrihet që të gjendet një ekuilibër midis aksesit nga publiku dhe ruajtjes së burimeve arkitektonike, të dizajnit dhe ato natyrore, një ekuilibër që i gjetur e studiuar me kujdes, duhet të sigurojë vazhdimësinë e ruajtjes së vlerave të Ansamblit.

Propozimet për menaxhimin e vizitorëve në Kompleksin e Pallatit të Brigadave janë të lidhura me dy nga qëllimet kryesore të PMI-së:

1. **Katalogim** dhe hapje për publikun
2. **Menaxhim** të qëndrueshëm

Të dy këto propozime shtjellohen duke përfshirë sipas fushave, orientime e objektiva konkrete:

1. **Qëllimi: Katalogim dhe hapje për publikun do të ketë për objektiv:**
   a) Katalogimi i të gjithë vlerave artistike të Pallatit dhe të Parkut duke krijuar databazën që do të shërbejë për konservimin dhe restaurimin në vazhdimësi.
   b) Menaxhimi i databazës në funksion të publikut dhe specialistëve të fushës.
   c) Menaxhim i flukseve të vizitorëve nëpërmjet vizitave të programuara.
2. **Qëllimi: Menaxhimi i qëndrueshëm ka për objektiv:**
   a) Rijetëzimi dhe shfrytëzimi të Pallatit të Brigadave dhe Parkut të tij, me të gjithë pasuritë materiale, arkitektonike artistike që përfshijnë, nëpërmjet një menaxhimi të qëndrueshëm, i cili do të sigurojë që të adhurat nga aktivitetet e bëra në ambjentet e tij, të mund të gjenerojnë të ardhura dhe të mund të financojnë mirëmbajtjen, konservimin dhe ndërhyrjet restauruese të bëra në të.
   b) Krijimi i funksioneve të reja, vizita të programuara në pallat: Guida në njohje të veprave të artit dhe dekoracioneve të Pallatit dhe të Parkut.
   c) Krijimi i laboratorit të restaurimit të mobiljeve.
   d) Krijimi i laboratorit të bimeve dekorative dhe të landscape-it
   e) Krijimi i faqes ËEB dhe guidave audio – vizuale
   f) Krijimi i funksioneve rekreative në park.
   g) Krijimi i Qendrës për Vizitorët.
   h) Krijimi i hapësirave akomoduese elitare në Pallat.
   i) Krijimi i sallave të ekspozitave të përhershme dhe të përkohshme.
   j) Sallë konference ipogjee.
   k) Krijimi i parkimit.
   l) Krijimi i nje strukture restorative degustuese në park.

## Influenca në komunitet, edukimi dhe trajnimi

Të parët që përfitojnë, janë komunitetet që jetojnë pranë siteve të tilla. Ata kanë

një interes të ngushtë për sa i përket vlerave natyrore dhe kulturore, ndaj zhvillimi shoqëror dhe ekonomik duhet të mbështetet nga drejtuesit me pikësynim mirëqenien, edukimin, trajnimin dhe punësimin.

Përveç mundësisë së punësimit në ambientet dhe funksionet e ndryshme të Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave, komuniteti përreth do të përfitojë edhe nga funksione shtesë që mund të shtrihen përreth tij. Sasia e vizitorëve që do të frekuentojë komplesin do mund të gjejë një ofertë të larmishme shërbimesh, e cila shoqëron shpesh këto lloj funksionesh. Ky komunitet është i pari që përfiton, falë afërsisë me kompleksin apo nga eventet e ndryshme kulturore, edukative, akademike dhe rekreative. Kjo ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së jetës së tyre.

Ndërkohë një tjetër komunitet përfitues nga afërsia apo jo me këtë Kompleks, është ai i profesionistëve dhe studiuesve në fushat e lidhura me gjuhën arkitektonike të fillim Shekullit XX, me dizajnin e mobiljeve dhe elementëve dekorativë, me restaurimin dhe konservimin e arkitekturës dhe të peizazhit të kuruar, etj.

Plani i Menaxhimit të Integruar të Pallatit, propozon krijimin e qendrave kërkimore didaktike të lidhura me restaurimin dhe me elementët e arkitekturës së parkut dhe të gjelbërimit, duke ofruar kështu përvojë didaktike dhe aplikuese për profesionistë në formim, por edhe nga profesionistë të konsoliduar në fushat përkatëse.

Koncepti i praktikës më të mirë është përdorur gjerësisht edhe në fushën e menaxhimit mjedisor të Parkut, i cili është me shumë rëndësi për Ansamblin Historik të Pallatit të Brigadave. Ky park funskionon në harmoni të plotë me Parkun e Madh të Tiranës, dhe fizikisht nuk ekziston një ndarje midis tyre, duke kompletuar njëri – tjetrin. Për këtë kërkohet një bashkëpunim i ngushtë me Bashkinë Tiranë, e cila e menaxhon Parkun e Madh, për të arritur në një menaxhim sa më të mirë të pjesës me pemë të larta, apo për menaxhimin e elementëve të tjerë të përbashkët të parqeve. Të dy, prej dekadash janë kthyer në mushkëritë e qytetit të Tiranës.

Në mbështetje të të gjitha këtyre përpjekjeve për krijimin e praktikës më të mirë, duhet të informohemi për nisma dhe metoda që kanë rezultuar të suksesshme në vende të tjera. Kjo nënkupton që, struktura menaxhuese e propozuar e Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave duhet të angazhohet në mënyrë aktive në programin e vazhdueshëm dhe konsistent të mbledhjes së të dhënave dhe informacionit, për të gjithë faktorët që lidhen me zonën Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave.



# 3.0 ANSAMBLI HISTORIK I PALLATIT TË BRIGADAVE

# 3.0 ANSAMBLI HISTORIK I PALLATIT TË BRIGADAVE

Pallati i Brigadave është një objekt unik në llojin e tij në hapësirat shqiptare, për nga cilësia arkitektonike, rëndësia historike si dhe nga rëndësia protokollare e përfaqësimit të shtetit shqiptar. Ai paraqitet me tri emërtime të ndryshme, produkte të kohëve historike në të cilat ai kapërceu që në fillesën e vet:

1. Vila Mbretërore
2. Vila e Mëkëmbësit të Emauelit III
3. Pallati i Brigadave.

Emërtimi "Pallat i Brigadave" është emërtimi i fundit i përdorur tashmë nga të gjithë dhe nuk lidhet aspak me funksionin primar për të cilin u projektua dhe u ndërtua. Ky emër u përdor gjatë periudhës së diktaturës komuniste, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, dhe vjen për shkak të prezencës në këtë kompleks, të Shtabit të Përgjithshëm Nacional – Çlirimtar në momentet e fundit të luftës.

Por historia e tij lidhet ngushtë me kërkesën e Ahmet Zogut për të pasur një Pallat dedikuar atij dhe familjes së tij. Ndaj që në Planin e Parë të zgjerimit të Tiranës në vitet 1925 – 1927, të hartuar nga arkitekti italian Armando Brasini, kur Zogu ishte President i Shqipërisë, hidhet ideja e vendosjes së një Pallati Presidencial në fund të Bulevardit të Ri, i cili do të mbushte ballinën fundore të këtij Bulevardi, pra aty ku sot ndodhet Universiteti Politeknik i Tiranës.

Pallati Presidencial në projektin e parealizuar të Brasini-t, gëzonte trajta monumentale neoklasike të një stili të përzier të Rilindjes, bazuar në koncepte të kohës, gjatë fillesave të stilit "Novecento" në Itali. Ai shoqërohej me një shesh madhështor monumental në formë rrethore, i trajtuar nën influencën e koncepteve të kopshteve mbretërore tipike franceze. E gjitha dukej si një skenografi mjaft kontrastuese urbane në raport me qytetin e vogël të Tiranës së asaj kohe.

Gjatë Planit të Dytë Rregullues të Tiranës, në vitet 1928 – 1930, pas shpalljes së Monarkisë, me kompleksin fundor dedikuar Zogut, u mor Florestano Di Fausto, arkitekti italian i cili sapo kishte realizuar Ansamblin e Ministrive dhe të Bashkisë së Tiranës, në Sheshin Skënderbej.

Florestano di Fausto, në atë kohë projektues i rezidencës së Durrësit të Mbretit Zog I, ngarkohet të nisë studimin për Vilën Mbretërore të Tiranës, që do të përfshinte një pallat mbretëror dhe vilë për Mbretin.

Sipas projektit të tij Kompleksi mbretëror përbehej nga 3 ndërtesa:

1. Pallati Mbretëror
2. Vila e Princeshave

3. Vila Mbretërore

Kompleksi Mbretëror në volumetri dhe në gjuhë arkitektonike ndryshonte nga ai i paraqitur më parë nga Brasini, nga i cili u mbajt vetëm ideja e pozicionit të këtij kompleksi. Gjuha arkitektonike e përdorur ishte e ngjashme me atë të ministrive në Sheshin Skënderbej, pra një gjuhë neoklasike, eklektike. Varianti i fundit i paraqitur prej tij është i vitit 1936.

Për shkak të financave të mëdha që kërkonte ky kompleks, Ahmet Zogu vendosi të ndërtojë fillimisht Vilën Mbretërore, pra atë që ne trashëgojmë si Pallati i Brigadave. Zogu e sposton kompleksin mbretëror në fillim të vitit 1937, në majën e Kodrës së Mulletit, 1.2 km në vijë ajrore më në lindje nga pozicioni ku Florestano Di Fausto e pati pozicionuar.

Këtë herë, Zogu ia beson projektin e tij Giulio Berté -s, një tjetër arkitekt italian prezent në Shqipëri, i cili në atë moment ishte eksponenti teknik më i lartë në Shqipëri në fushën e ndërtimit.

Berté merret me Vilën Mbretërore duke mbajtur fillimisht gjurmën e Di Fausto-s, dhe më pas bën edhe disa variante me ndryshime të tjera. Deri në projektin final i cili fillon të zbatohet, në arkiva gjenden edhe shumë variante të tjerë, projekte të arkitektëve shqiptarë dhe austriakë, por Zogu i beson vilën e tij Berté-së, i cili merret me arkitekturën e jashtme dhe të brendshme të vilës. Për pjesën e Parkut të Madh kërkohet një projekt nga propozimet e agronomëve të shoqërisë Sgaravatti nga Padova, dhe atë të Pietro Porcinai-t, bashkpunëtor për themelimin e kopshtit, të shoqërisë Martino Bianchi. Projekti u ideua dhe u realizua nga ekipi italian i sipërpërmendur, si dhe nga inxhinierë dhe arkitektë shqiptarë, si Vasil Noçka dhe Kristo Sotiri, ky i fundit arkitekt i oborrit mbretëror shqiptar.

Në fillim u quajt Vilë Mbretërore dhe më pas Seli e Mëkëmbësit së Mbretit Emanuel III.

Në 1939-n pallati u transformua në Selinë e Mëkëmbësisë së Mbretit të Italisë. Në vitin 1939, ndryshimi i vilës në Seli të Mëkëmbësisë, solli një ndryshim në projekt. Rreptësia e vëllimit kompakt u pasurua me larminë e materialeve të vyera, skulptura, mobilie, tapiceri, piktura, objekte të bronzta, të cilat më së shumti ishin realizuar nga artistët dhe artizanët italianë. Mobiliet u ideuan nga vetë Gherardo Bosio. Bazorelievet dhe skulpturat janë vepra të artistëve italianë midis të cilëve Antonio Maraini, por edhe shqiptarë si Odise Paskali.

Ish- Pallati Mbretëror ose ish-Pallati i Brigadave është një muze i vetvetes, por mund të konsiderohet edhe si një galeri e kryeveprave dhe arkitekturës botërore.

Pallati i projektuar për Mbretin Zog I, por që nuk jetoi asnjë ditë në të, pasi punimet ende nuk kishin mbaruar kur ai u largua nga Shqipëria, përfundoi gjatë pushtimit italian të Shqipërisë. Punimet vijuan nën kujdesin e Mëkëmbësit të Mbretit, Fancesco Jakomoni.

Ndërtimi i pallatit u përfundua në vitin 1941 nga italianët, të cilët vendosën aty shtabin qendror të ushtrisë së tyre. Ndonëse i ndërtuar për Mbretin e Shqipërisë, Ahmet Zogu I, pallati ka shërbyer si rezidencë mbretërore vetëm një herë, për një mbret italian, Viktor Emanuelin e III-të. Për gjithë periudhën tjetër, deri në

largimin e italianëve nga Shqipëria, ai shërbeu si rezidencë shqiptare e Mëkëmbësit të Mbretit, fillimisht Jakomonit dhe më vonë gjeneral Parianit. Në lidhje me vizitën e mbretit Viktor Emanueli i III-të dhe gjendjen e parkut ka dokumentacion fotografik që daton në vitet 1940-1941, të ruajtur në Arkivin e Institutit "Luce" (Drita), kopje e të cilave gjenden edhe në Arkivin e Shtetit në Tiranë dhe në Arkivin Bosio,.

Pallati mbretëror u quajt "Pallati i Brigadave" nga regjimi komunist, i cili e përdori për pritje dhe ceremoni shtetërore. Nga viti 1992, emri zyrtar i këtij institucioni është "Pallati Presidencial", i përdorur si rezidencë presidenciale.

Si i tillë, AHPB-ja ka qenë për vite me radhë në fokus të një sërë studimesh arkeologjike, historike dhe ekologjike, të cilat kanë ndërtuar sëbashku një literaturë të pasur, të besueshme dhe të konfirmuar nga studiues të tjerë, për Kompleksin dhe prapatokën e tij.

## Vlera kulturore dhe arkitektonike

Vetëm rreth 2.2 km nga qendra e qytetit të Tiranës, Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave ofron një mjedis të veçantë, të ngritur midis arkitekturës dhe mobilimit autentik të fundit të viteve tridhjetë, skulpturave dhe veprave të artit, si dhe natyrës së një kopshti mesdhetar unik në Shqipëri. Së bashku, të gjithë këta komponentë përbërës, krijojnë një kompleks të jashtëzakonshëm kulturor, i cili është zhvilluar natyrshëm përgjatë shekullit të shkuar.

Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave mund ta ndajmë në dy sisteme kryesore të cilat mund ti tregojmë në detaje:

1. Ndërtesa e Pallatit të Brigadave
2. Parku i Pallatit të Brigadave



**Ndërtesa e Pallatit të Brigadave**

Pallati i Brigadave nuk u banua në kohë të gjatë nga askush, përveç Francesco Jacomoni di San Savino, i cili jetoi në të rreth një vit e gjysmë. Ai shërbeu edhe në atë kohë, edhe gjatë periudhës së diktaturës komuniste, apo edhe pas rënies së saj, si një vend ekselent për ceremonitë më të rëndësishme të shtetit shqiptar, evente me karakter të veçantë publik apo privat, duke gëzuar një ekskluzivitet për hyrjen e personave në të.

Pallati i Brigadave ka shërbyer si vend për akomodimin e personaliteteve të ndryshme në periudha të ndryshme, deri në momentin që filloi të manifestonte probleme të infiltrimit të ujrave nga pjesa e tavanit.

Pallati, kalon një kalvar ngjarjesh historike e projektesh të mbivendosura, por në fund nga ana arkitektonike ai i përmbahet një stili modernist, me shumë pak dekor në fasadë, i cili gjithashtu ishte karakteristikë e atyre viteve. Bosio ndodhej para një dileme, midis të qenit konform ortodoksisë moderniste të kohës, apo të afrohej në stilet dhe elementet dekorativë butaforikë të shembujve klasikë të monarkive të ndryshme. Duke qenë një arkitekt fiorentin, shohim një qasje tipike, mbështeur në tipologjinë e vilave të fisnikëve fiorentinë të Rilindjes, ku

në përgjithësi raporti dhe proporcioni janë themelore, pjesa e jashtme është e thjeshtuar nga ana e elementëve të dekorit dhe interieri mjaft i pasur me elementë të rafinuar. Ky stil duket bashkëkohor, por në realitet kemi lindjen e një rryme të rafinuar dhe elegante, mbështetur mbi linja të riinterpretimeve të formave gjeometrike, të stileve të përdorura në pallate monarkësh e fisnikësh. Volumi i jashtëm, në dukje i varfër në elementë dekorativë, falë linjave të drejta, proporcioneve të studiuara mirë, transmeton një emocion të veçantë dhe kuriozitet të madh në atë që do të shfaqë, në brendinë e vet pas dritareve të mëdha.

Falë terrenit të pjerrtë, Pallati artikulohet në tre kate nga njëra anë dhe nga 4 nga ana tjetër, duke ofruar një lojë dinamike platformash dhe shkallaresh anash saj.

Aksesi kryesor, hyrja për në pallat është e decentruar, e ngritur në kuotë, siç ishte në projektin e Berté dhe përbëhet nga dy dyer të mëdha, të mbushura me dekore. Njëra nga dyert kryen funksionin e mbrojtjes: dera e jashtme zakonisht mbahej e hapur duke lënë të mbyllur derën e brendshme, ndërkohë që një derë tjetër e brendshme, e kristaltë dhe kombinuar me kangjellatë hekuri me dekor, mundëson hyrjen e dritës dhe pamjen e kopshteve përballë Pallatit.

Dera e kristaltë ka dy simbolet e asaj kohe, që është shqiponja jonë dy-krerëshe dhe simboli i familjes Savoja (kurora mbretërore sipër shqiponjës).

Simbolet, bazorelievet, ndihen që në hyrje dhe e shoqërojnë në të gjitha ambjentet e rëndësishme.

AHPB-ja, ish – Vila e Mëkëmbësit, e përuruar si e tillë në përfundim të punimeve, pritej të ishte edhe për atë kohë të diktaturës fashiste, ashtu siç kishte menduar edhe porositësi i saj i parë Mbreti Zog, objekti më i rëndësishëm përfaqësues i shtetit shqiptar. Ajo ka një sipërfaqe prej 6405 m2 dhe secili kat ka funksione të mirëpërcaktuara, të cilat u kompletuan me një aftësi të jashtëzakonshme dhe mbresëlënëse. Ajo mund të konkurrojë mjaft mirë me gjendjen e saj arkitektonike dhe vlerat e veçanta, me strukturat e ngjashme nëpër vendet me tradita arkitektonike. Prezenca në hollin qendror hyrës, i cili përdorej për parapritje në raste eventesh në ditët tona, ka qenë projektuar si një skenografi e rafinuar ambientesh, të filtrueshme nga një sërë portash, të cilat dallohen për karakterin e tyre mjaft ftues, pasi ngjajnë shumë me dyert e teatrove. Salla imponente shtrihet me një sipërfaqe 142.99 m2 me proporcione monumentale dhe dekore të artikuluara mjaft mirë.

Pjesa mobileve janë të projektuara enkas për pallatin deri në detajet më minimale, nga Gherardo Bosio dhe janë realizuar në Mobileri Quarti në Milano, e vetmja në shkallë ndërkomëtare e aftë të realizonte prototipe të tilla dhe me nivel kaq të lartë.

Ato janë të gjitha unike, në stilin e tyre dhe të përsonalizuara për Pallatin e Brigadave. Mermerët e llojeve dhe ngjyrave të ndryshme janë përdorur për të shtuar dyshemetë apo fashaturat e dyerve. Ato janë kombinuar dhe realizuar me shumë mjeshtëri dhe të harmonizuara me pjesën e mobilimit.

Ndriçimi është i veçantë dhe i avancuar për kohën, duke na u paraqitur me karakteristika autentike si në nivele lampadarësh, ndriçim të ulët apo të fshehur nëpër tavane e mobilie.

Salla përfaqësuese më e madhe e Vilës është salla e madhe, në dukje e ngjashme me sistemet e kishave, me një hapësirë boshe dy-volumore, si dhe me dy salla anësore të lidhura simetrikisht. Kjo sallë sot quhet Salla e Skënderbeut dhe lartësohet gati 11 metra, si dhe ka një sipërfaqe 167.48 m2. Në këtë sallë mbreti Vittorio Emmanuele duhet të bënte pritjet e tij, dhe në rast të mungesës të Mbretit, ishte Mëkëmbësi i tij i cili organizonte eventet shtetërore (në këtë rast Jakomoni).

Salla ka 6 piktura të cilat nuk kanë lidhje me historinë e Shqipërisë. 6 pikturat janë ilustrime të hyjnive Romake ose sikurse njihen në histori, hyjnitë Greke (dallojnë nga hyjnitë romake vetëm nga emërtimi). Në pozicionin ku sot është skulptura e Gjergj Kastriotit, dikur kanë qenë fronet e Mbretit dhe Mbretëreshës. Në këtë sallë në pjesën lart, ndodhet ballkoni nga ku dirigjohej ceremoniali, ose me raste vendoseshin muzikantët, dhe tek i cili mund të dilej nga holli i katit +1.

Pjesa ceremoniale e ngrënies është një sallë e tavolinës së rrumbullakët, sallë ceremoniali me një kapacitet pak më të vogël se sallat e tjera dhe me sipërfaqe 109.81 m2. Kjo sallë është e dekoruar me tavanin e ndriçuar me stilin e Gerardio Bosio-s dhe disa pasqyra tipike të periudhës së neoklasiçizmit.

Salla ngrënies ka një tavolinë qendrore me kapacitet për 50 persona dhe sipërfaqe totale 131.52 m2. Tavani në këtë sallë është tipik i viteve ‘40-të, me forma gjeometrike (katrore), motive të cilët i gjejmë edhe në mobilimin që është përdorur për këtë dhomë. Kjo sallë lidhet me zyrën e mëkëmbësit nëpërmjet një paradhome.

Zyra e Mëkëmbësit (e përdorur nga Jakomoni) ka një faqe muri bibliotekë dhe pjesa tjetër është e gjitha e veshur me dru. Zyra ka dalje në pjesën e pasme të pallatit, pjesë e cila lidhej dhe me vendin ku bëhej pjesa më e madhe e aktiviteteve dhe ceremonialeve.

**Veprat e artit (pikturat)**

Pallati i Brigadave së bashku me mjediset ndihmëse, dekorohet nga një tipologji e gjerë veprash arti, ku një pjesë e mirë e tyre, përveç funksionit dekorativ, kanë primare aspektin funksional. Ato janë të pozicionuara thuajse në të gjitha ambientet e Pallatit, (të brendëshme dhe të jashtëme). Vlen të theksohet se një pjesë e tyre nuk janë të lidhura drejtpërsëdrejti me vendndodhjen aktuale. Ndërsa sa u përket pikturave të ekspozuara në interieret e PB, dokumentet arkivore dëshmojnë se një pjesë e tyre kanë kaluar për një periudhë kohore në administrimin e Galerisë Kombëtare të Arteve dhe më vonë janë bërë përsëri pjesë e DSHQ. Por disa të tjera, kanë mbetur ende në fondet e GKA.

Pikturat

Sa i takon veprave të artit pamor në pikturë, ato i gjejmë të jenë aplikuar në suporte të ndryshme, që sipas të cilave i klasifikojmë në:

1. Piktura në Mur (teknika tempera *a secco*)

2. Piktura në beze (vaj/tempera)

Veprat në pikturë, që dekorojnë muret e brëndëshme të Pallatit të Brigadave, ju

përkasin periudhave të ndryshme kohore një pjesë e tyre dhe autorëve piktorë të mirënjohur dhe me një veprimtari të konsiderueshme dhe të sukseshme në artet pamore. Vërejmë që përveç një vepre të vetme murale, pjesa tjetër janë piktura të realizuara në beze. Piktura murale (në mjediset e njohura si apartamenti i katit 2) është realizuar me tempera dhe i përket vitit 1940 me autor CAVALIN M. Ndërsa pikturat në beze që dekorojnë mjediset e brendëshmë të Pallatit, janë realizuar nga autorë të ndryshëm si: Simon Rota, Vangjush Tushi 1956, Nexhmedin Zajmi 1959, Fatmir Haxhiu 1976, si dhe autorë të huaj M. Bisaliti, Szemeres. J 1938. Përveç tyre, ka edhe vepra të realizuara nga autorë të pa identifikuar dhe si të tilla mbeten anonime.

Bazuar në arkivin e IKTK, një sërë veprash me tematikë fetarë (gjithësej gjashtë) me prejardhje nga Palati i Brigadave, kanë kaluar në fondin e GKA. Me shumë gjasa pallati i brigadave do jetë zhveshur në një periudhë të caktuar kohore nga veprat me karakter mitologjik dhe fetar.

**Teknikat, tematikat dhe datimet e veprave**

**Veprat në telajo**

Veprat në telajo, janë të realizuara kryesisht ne teknikën e vajit mbi pëlhurë. Ato paraqesin tematika të ndryshme si dhe janë të realizuara nga autorë të ndryshëm. Tematikat që mbizotërojnë janë: Tema dhe personazhe Mitologjike, peisazhe nga Venezia, Kompozime me temë historike, Harta, Natyra të qeta me fruta e lule, peisazhe të tjera, etj.

**Piktura Murale**

Piktura e vetme murale duket të jetë e realizuar në teknikën e "a secco"-s. I shtrirë në tre sipërfaqe të ndara nga njëra-tjetra, ajo paraqet, një peisazh rural me praninë e personazheve në të. Paneli qendror, ka dimensione më të mëdha ndërsa ata anësorët janë me dimensione më të reduktuara. Të treja rrethohen nga një korrnizë e thjeshte gri.

**Periudhat kohore (datimet e veprave në pikturë )**

Një pjesë e veprave, mendojmë se i përkasin kohës kur është ndërtuar vetë pallati. E themi këtë fakt kur i referohemi gjashtë tabllove në telaio të vendosura në zonën e sipërme të sallës qendrore. Veprat, me frymëzim nga arti Italian i shekullit të 18-të, ato duket se marrin pikërisht impuls nga kupolat e kishave veneciane realizuar nga G.B. Tiepolo. Ndoshta të njëjtës kohë i përkasin dhe vepra të tjera, po që nuk lidhen ngushtë me sallat ku janë vendosur.

Vepra murale mban vitin 1940 ndërsa pikturat në beze që dekorojnë mjediset e brendëshmë të Pallatit, janë realizuar nga autorë të ndryshëm si: Simon Rota, Vangjush Tushi 1956, N. Zajmi 1959, si dhe autorë të huaj M. Bisaliti, Szemeres. J 1938.

Ndërkohë pikturat ashtu sikurëse edhe shumë objekte të tjera kanë zënë vend në mjediset e brendëshme të ndërtesës përgjatë viteve të përdorimit të saj. Shquajmë vepra që i përkasin periudhave të mëvonëshme si (në hollin e katit 2) një vepër që paraqet Skënderbeun në betejë, e vitit 1976 e realizuar prej piktorit Fatmir Haxhiu, apo peisazhi me pemë nga Bashkim Ahmeti i vitit 1984.

## Parku

Parku i lidhur me Pallatin e Brigadave, ish-Vilën Mbretërore, ndodhet në lokalitetin e Saukut, në skajin jugor të qytetit të Tiranës, dhe paraqitet si një park formal me pjesë të peizazhit gjeometrik që shpërndahen në zonat e pyllëzuara. Parku zë një hapësirë rreth 37 hektarë, nga të cilat 25 hektarë i përkasin zonës së pyllëzuar, pronë e qeverisë shqiptare. Parku paraqet një interes të dukshëm historik, kulturor dhe peizazhor, jo vetëm për arkitekturën e kopshteve shqiptare, por edhe atë evropiane, sepse reflekton karakteristikat arkitektonike, bimore dhe artistike të kopshteve të asaj periudhe, i cili prezantohet si një shembull emblematik dhe shumë domethënës i kopshteve formalë, që lidhen me pjesë të dizajnit natyror.

Parku paraqet një planimetri komplekse falë punës së shoqërisë *Sgaravatti* në projektin e vitit 1937 dhe kontributit të *Pietro Porcinai-t*. Më vonë, parku u ripërpunua dhe u kompletua nga *Gherardo Bosio* dhe *Ferdinando Poggi*.

Kompleksi është i strukturuar nga disa sisteme arkitektonike të ndryshme, që kanë si bosht qëndror Vilën, e cila bie mbi platenë gjysëmrrethore dhe lidhet në lindje me dy dhomat e kufizuara me shkurre në formë drejtkëndore, dhomën e Shatërvanit të Mbretëreshës dhe dhomën e Muzikantëve.

Pjesët e një planimetrie formale lidhen me hapësirat e gjera të pyllit dhe sistemin e rrugëve dhe rreshtave, ku muret bimorë të përbërë nga gardhe me formë të rregullt lidhin pjesët e ndryshme të kopshtit.

Një rresht i dyfishtë selvish (*Cupresus sempervirens*), përgjatë një L-je të çojnë nga hyrja kryesore në vilë, duke krijuar një hapësirë gjysëmrrethore bimore, që kufizohet me shkurret përpara vilës.

Në lindje të Vilës, vihet re një kodrinë në formë tarrace, prej së cilës perceptohen mirë dy platetë e sistemit formal: *Platea e Vashës*, e cila është e kufizuar nga një mur i lartë bimor prej ashje (*Ilex aquifoilum*) dhe dafine (*Laurus nobilis*), të cilat shpërndahen në bazë segmentesh të rregullta që përcaktohen nga gardhet prej bushi (*Buxus sp*.) dhe dafine (*Laurus nobilis*) që përhapen rreth statujës së bronzit kushtuar një gruaje të re. Në qendër të këtyre segmenteve vërehen hapësira lëndinash të alternuara me lule sezonale.

Në jug të platesë së madhe, paraqiten dy hapësira të tjera të mirëstrukturuara dhe të kufizuara nga gardhe të rregullt me bimë të vendosura në rresht: njëra e destinuar për fushë lojërash (në vendin ku projektet origjinale parashikonin realizimin e një pishine), që paraqet një gjysëmrreth me një vaskë dhe tjetra e destinuar dikur për fushë tenisi, kurse sot përdoret si aerodrom.

Më në jug, parku merr një domethënie më të plotë natyrore, me një hapësirë të gjerë karakterizuar nga tre liqene të vegjël të rrethuar me ekzemplarë bimorë, disa prej të cilëve me vlera të veçanta përsa i përket llojit, përmasave, formës, të izoluara ose në grupime të vogla. Zona e destinuar për sera dhe fidanishte, zë një pjesë të konsiderueshme në jug të rrugës me leandra (*Nerium oleander*): kufizuar nga një gardh bimor i krasitur rregullisht me një paraqitje të valëzuar. Serrat përdoret për kultivimin e llojeve të ndryshme të luleve sezonale që mbillen në park.

Dy dhoma të tjera e kompletojnë planimetrinë e parkut të gjerë: *hapësira e Kapelës (kishës)*, vendosur në majë të një kodrine në pjesën lindore të vilës dhe e zbukuruar me forma të rregullta vegjetale dhe lule, një ekzemplar i jashtëzakonshëm gështenje në të majtë të Kapelës dhe *hapësira rrethore vegjetale* e cila lidhet me Kapelën nëpërmjet një rreshti të dyfishtë ahësh, kufizuar nga gardhe të krastitur me forma të rregullta. Bëhet fjalë për një hapësirë rrethore të përkufizuar me ahe të vendosur në rresht, që karakterizohen në qendër nga një qitro dekorative monumentale (*Citrus paradisi*).



Hapësirat pyjore në pjesën më të madhe të territorit të Parkut përmbajnë bimësi spontane me përmasa ndonjëherë të konsiderueshme, me lule të ndryshme dhe dredhka. Por, zona e pyllëzuar në lindje, përmban disa ekzemplarë bimësh me interes përsa i përket përmasave dhe formës së tyre, në veçanti qitro (Citurs paradisi) dhe bliri (*Tilia platyphyllos*) kurse zona juglindore, karakterizohet nga një lis shumë i bukur (*Quercus petraea*).

Karakteristikat arkitektonike dhe komponentët kryesore mund të përmblidhen si më poshtë:

- Pallati dhe tarracat në afërsi të tij (projekt i arkitektëve Giulio Berté, Gherardo Bosio, Ferdinando Poggi 1935-1942) që lidhen me parkun e madh me sistem formal dhe karakterizohen nga disa dhoma, shpesh të kufizuara nga gardhe të krastitur në formë të rregullt, ose nga bimë të larta të vendosura në radhë.
- Pjesët formale janë të rrethuara nga zonat e pyllëzuara e me shtigje lidhëse.
- Në park gjenden: porta e hyrjes kryesore, esedra monumentale që lidhet me rrugën e hyrjes, platetë përpara vilës me shatërvanin dhe rrjetin ujor, elementët dekorativë dhe orenditë, dhomat bimore ngjitur me vilën (dhoma e Muzikantëve dhe dhoma e Shatërvanit të Mberetëreshës), me statuja dhe elementë dekorativë dhe orendi, Kapela, rotonda bimore, tarraca, platea e

Vashës, platea e madhe, ish-fusha e tenisit (tani aerodrom), fusha e lojërave me hapësirën gjysëmrrethore dhe vaskë- shatërvanin, liqenet e rrethuar nga kopshti romantik, serat dhe fidanishtet, ish-shtëpia me kollona, e quajtur "Shtëpia e fermerit", centrali elektrik që lidhet me vaskën-shatërvan, pozicionet e rojeve, mbetjet e bunkerëve, ndërtesat e shërbimit dhe aktiviteteve ushtarake, ndërtesat e impiantëve teknikë, rrethime me harqe muri dhe hekuri, projektuar nga Giulio Berté.

Komponentët bimorë që karakterizojnë Kompleksin, i gjejmë në: rrugën hyrëse me selvi monumentale (*Cupresus sempervirens),* ekzemplarë pishe (*Pinus pinea*) në grup ose në rreshta në afërsi të Vilës, gardhe, mure e gjysmërrathësh bimorë të krastitura me forma të rregullta, të përbërë nga dafina (*Laurus nobilis*), ashje (*Ilex aquifolium*), ilqe (*Quercus ilex*); gardhet ndarëse të plateve të përbërë nga bushi (*Buxus sempervirens*) dhe ligustra (*Ligustrum ovalifolium*). Rreshti i dyfishtë me blirë (*Tilia platyphillos*) përgjatë rrugës që lidh ish-Shtëpinë e fermerit me tarracën qëndrore me vaskë; plantacioni me mimoza (*Acacia dealbata*), që formon rotondën e tarracës; rreshti i dyfishtë i blirëve (*Tilia platyphyllos*) e selvive (*Cupresus sempervirens*) në perëndim të fushës së lojrave me vaskë dhe hapësirë gjysëmrrethore; rruga e leandrave (*Nerium oleander*) që lidh platenë e madhe me esedrën hyrëse; dy citro që lidhen me esedrën hyrëse; një rresht pishash në afërsi të portës hyrëse.

Në park dallohen disa ekzemplarë bimësh me vlera të veçanta si për llojin, përmasat dhe formën e tyre, si: palma (*Phoenix canariensis*) në të djathtë të Vilës, dafina (*Laurus nobilis*) mbi tarracën veriore të Vilës, ilqe (*Quercus ilex*) në të majtë të vilës, rrape (*Platanus acerifolia*) dhe pisha e butë (*Pinus pinea*) në afërsi të centralit elektrik, një gështenjë e egër (*Aesculus hypocastanum*) në të majtë të Kapelës që lidhet me një mështeknë (*Betula pendula*), një rresht i dyfishtë me ilqe (*Quercus ilex*) më në qendër gjendet një qitro (*Citrus paradisi*) të cilat formojnë një rotondë bimore përveç Kapelës. Gjithashtu, në afërsi të hyrjes ka rrape (*Platanus acerifolia*); ndërmjet platesë të Djaloshit dhe platesë së Vajzës së re dhe belvederes gjenden dy eukalipte (*Eucaliptus sp.*), një vidh (*Ulmus campestris*) në këmbët e shkallës që të çon në aerodromin aktual.

Rreth liqeneve të vegjël bien në sy disa mimoza (*Acacia dealbata*) të vendosura në rresht, bambu (*Phyllostachys aurea*), grupe brusonetje (*Broussonetia papyrifera*) dhe grupe eukaliptesh (*Eucaliptus sp.*), përveç disa ekzemplarëve si (*Taxodium distichum*) dhe shelgu (*Salix babylonica*). Me interes të veçantë paraqitet hapësira në juglindje të parkut, e destinuar për pyll spontan. Atje bëhet fjalë për një lisnajë me nënpyll (blacë) kryesisht me ashe (*Ilex aquifolium*), me vlera të spikatura naturalisto-pyjore. Parku i Pallatit të Brigadave përfaqëson një nga kopshtet - park më të rëndësishëm në Shqipëri, me një trajtim të një cilësie unike në llojin e vet, në të gjitha territoret shqipfolëse.

## 1. HYRJA KRYESORE, RRUGËT HYRËSE DHE ESEDRA MONUMENTALE

Nga ndërtesa e rojeve, që lidhet me një rresht të rëndësishëm ekzemplarësh pishe (*Pinus pinea*) dhe disa orendi (stola, statuja, vazo lulesh) dhe elementë bimore (shkurre të krasitura rregullisht, lule sezonale, driza përdredhëse dhe dekorative ), fillon një rrugë në formë L-je me selvi (*Cupresus sempervirens*) , e cila lidh

hyrjen kryesore, esedrën dhe vilën. Selvitë janë të vendosura 3 e nga 3 në mënyrë të rregullt dhe impakti i kësaj rruge është impresionues. Ajo formon gjithashtu edhe boshtin e sfondit gjenerues të dizajnit të parkut. Në fakt hyrja kryesore lidhet me platenë e madhe, nëpërmjet esedrës dhe rrugës së gjatë me leandra (*Nerium oleander*). Nga esedra, një aks pingul i sfondit, të çon më tej në AHPB.

## 2. PLATEA PËRBALLË VILËS DHE HAPËSIRAT PËRRETH SAJ NË PERËNDIM, VERI DHE LINDJE TË NDËRTESËS

Hapësira përballë vilës karakterizohet nga një formë gjysëmrrethore, e përcaktuar nga një kuintë impresionuese vegjetale, e përbërë nga gardhe të lartë të krasitur rregullisht e nga selvi (*Cupresus sempervirens*) të mbjella në rresht, në harmoni me bimë të tjera dekorative si: jasemin (*Jasminum sp.*), trëndafila (*Rosa sp.*), bush (*Buxus sp.*), etj. Pjesa qëndrore është e zënë nga një plate e madhe, në formë gjysëmrrethore, e kufizuar me një gardh rozmarine (*Rosmarinus officinalis*) të krasitur me forma të rregullta drejt lindjes, jugut dhe perëndimit si dhe me dafinë (*Laurus nobilis*), drejt veriut, ku lokalizohet një shatërvan me interes të veçantë arkitektoniko-dekorativ. Në të dyja anët e shatërvanit, vihen re hapësira të gjelbra që thyhen nga lule sezonale, disa ekzemplarë bimësh drunore si: dy manjola (*Magnolia grandiflora*); një qitro (*Citrus paradisi*); dy palma (*Phoenix canariensis*) dhe disa bimë dekorative bushi (*Buxus sp.*) të krasitura me forma ose të lëna në zhvillim të lirë (Yucca, leandra, forsythia). Vazo dhe elementë të tjerë dekorativë e kompletojnë platenë.

## 3. DHOMAT VEGJETALE NË LINDJE TË VILËS: "DHOMA E MUZIKANTËVE" DHE "SHATËRVANI I MBRETËRESHËS"

Bëhet fjalë për dy struktura interesante vegjetale, të rrethuara me gardhe gjithmonë të gjelbëruara e të krasitura rregullisht. Dy hapësirat, e para në formë drejtkëndore dhe e dyta e kufizuar në lindje nga një mur mbajtës në formë gjysëmrrethi, përcaktohen nga disa pisha të vendosura në rresht e të alternuara me selvi (*Cupresus sempervirens*). Nga Dhoma e Muzikantëve, një shkallë zbret drejt hapësirave lindore të pyllit, duke bërë që kjo zonë e pyllëzuar të lidhet ngushtësisht më pjesët më të mirëmbajtura të Ansamblit. Kurse dhoma e dytë karakterizohet në qendër nga një shatërvan interesant me statujë dhe vlera të veçanta artistike.

## 4. KODRINA-TARRACA (BELVEDERE)

Bëhet fjalë për një kodrinë artificiale, në të cilën ngjitesh nëpërmjet një dopio shkalle spirale prej guri, kufizuar nga gardhe të krasitur rregullisht. Është një element i kopshtit me interes të veçantë arkitektonik dhe të peizazhit, që ruan ende impaktin historik, siç dëshmohet edhe nga skicat e shumta që i referohen kësaj pjese. Maja e kodrës karakterizohet nga një rresht mimozash (*Acacia dealbata*) që formojnë një rreth, i cili në qendër ka një statujë, tashmë të degraduar, rrethuar nga shtretër historikisht të mbjellë me shkurre dekorative kurse sot lëndinë, e dekoruar me disa lule sezonale me interes të ulët.

## 5. "PANTEA E VASHËS”

Është dhomë e jashtëzakonshme vegjetale, ndërtuar mbi një argjinaturë artificiale, kufizuar nga një esedër/mur hijerëndë prej ashe (*Ilex aquifolium*) e dafine (*Laurus nobilis*), që është më i ulët drejt perëndimit, i hapur drejt zonave

të pyllëzuara më poshtë dhe e dizenjuar nga një gardh i krasitur rregullisht, me impakt të sigurt paronamik. Sot ruhen ashet, ndërsa mungojnë disa bimë ornamentale që duhet të rimbillen, për të përcaktuar më qartë një kuintë që sot ka boshllëqe. Hapëpësira është e ndarë në fragmente të rregullta të shpërndara rreth statujës së bronztë të një gruaje të re, boshti i kompozimit.

### 6. PLATEA E MADHE

Është një plate e gjerë, e vendosur  pingul me platenë e Vashës, përgjatë prespektivës e cila nga tarraca të çon në zonën e esedrës – hapësirës gjysëmrrethore dhe nga rruga e gjatë me leandra, të çon në esedër dhe pastaj vazhdon përgjatë rrugës hyrëse.

Edhe kjo plate është e ndërtuar mbi një argjinaturë artificiale dhe është e kufizuar nga mure mbajtës. Në jug kufizohet nga një sfondi i bukur selvish. Fragmentet e rregullta janë dizenjuar me gardhe bushi (*Buxus sempervirens*) dhe dafine (*Laurus nobilis*) përgjatë një hapësire rreth 1 km.

### 7. RRUGA A LEANDRAVE

Rruga e leandrave (*Nerium oleander*) lidh platenë e madhe me esedrën, duke nënvizuar një nga boshtet më gjenerues të sistemit. Bimët, ndoshta shumë të dendura, shfaqen tepër të holla, dhe sot duken si trarë të zhveshur, të lulëzuara vetëm në majë. Vetëm një krasitje drastike reformuese, mund t'i japë zgjidhje këtij problemi. Skicat historike që i referohen kësaj pjese të parkut, tregojnë për një impiant me jasemine (*Rhyncospermum jasminoides*) në të dyja anët e leandrave (*Nerium oleander*), por aktualisht nuk duket asnjë gjurmë e tyre. Edhe bimët kacavjerrëse, të cilat mund të kontribuonin me lulet e tyre aromatike dhe dekoracionin e rrugës, aty mungojnë.

### 8. KAPELA  (KISHËZA) DHE ZONA PËRRETH

Kjo zonë, në të cilën shkohet nëpërmjet një shkalle të bukur të shtruar me gurë dhe e kufizuar me gardhe të krasitura rregullisht, ndodhet në lindje të vilës, në majë të një kodre të butë nga ku mund të shijohet sot panorama e vilës dhe parkut. Kishëza me vlera të padiskutueshme arkitektonike është restauruar së fundmi, vendoset në një hapësirë me formë ovale, edhe ajo e shtruar me gur opus incertum dhe e rrethuar me gardh dafinash (*Laurus nobilis*) të krasitura. Është një hapësirë intime, ku vëmendja përqëndrohet mbi objektin e kultit, disa ekzemplarë pemësh me vlerë të konsiderueshme botanike si: një lis (*Quercus petraea*) dhe një pemë panje (*Acer sp.*) përballë kishës, një pemë monumentale gështenje (*Castanea sativa*) dhe një mështeknë madhështore (*Betula pendula*) në anën e majtë të ndërtesës dhe mbi vegjetacionin e selvive (*Cupresus sempervirens*) në rresht, blirët (*Tilia sp.*) dhe leandrat (*Nerium oleander*), të alternuara me vendqëndrime, stola dhe lule sezonale.

### 9. ROTONDA  VEGJETALE

Nga kisha, drejt jugut, nëpërmjet një rruge me lisa (*Quercus petraea*) tashmë me një dizenjo të çuditshme, pjesërisht e pushtuar nga rritja e pyllit që e rrethon dhe e përkufizuar nga një gardh dafinash (*Laurus nobilis*) dikur të krasitura, dilet në një rotondë vegjetale që përcaktohet lehtësisht nga një rresht lisash të mbjellë në formë rrethore. Nga konstatimet verbale të punonjësve më të vjetër mendohet që

kjo zonë është përcaktuar si vend meditimi për përodruesit e pallatit. Në qendër të rotondës, ndodhet një ekzemplar shumë i bukur i cedrusit (*Cedrus deodara*). Kjo hapësirë me hije, është shumë mbresëlënëse, edhe pse afërsia me rrugën dhe impakti akustik e cënojnë disi shfrytëzimin dhe përdorimin e saj.

**10. HAPËSIRA QË LIDHET ME TARRACËN/CENTRALI ME VASKËN E RRUMBULLAKËT**

Bëhet fjalë për një hapësirë relativisht të reduktuar, në këmbët e kodrës së tarracës, në afërsi të një centrali të braktisur. Një vaskë-shatërvan rrethore e veshur me tesera bojëqielli, pa ujë dhe e degraduar karakterizon këtë zonë. Si pasojë e shkëputjes së dyshemesë dhe disa depozitime mbeturinash mbi objekt, rritet gjendja e degradimit të Ansamblit, por bie në sy projektimi i sistemit vegjetal historik, me gardhe dafinash (*Laurus nobilis*) të krasitura rregullisht dhe selvi (*Cupresus sempervirens*) të rreshtuara, që përkufizojnë një rrap të mrekullueshëm në kufijtë e hapësirës pyjore. Është një bimë monumentale e rrallë, si përsa i përket afërsisë me fasadën e selvive, ashtu edhe për rritjen e pakontrolluar në pyllin përreth. Duke pasur parasysh vlerën e tij, padyshim është i rëndësishëm edhe vlerësimi dhe perceptimi i vënies së tij në dukje.

**11. FUSHA ME HAPËSIRËN GJYSËMRRETHORE-ESEDRËN DHE VASKA-SHATËRVAN**

Kjo hapësirë është vendosur në jug të platesë së madhe, pingul me të dhe e kufizuar nga një fasadë selvish, kjo hapësirë sipas planimetrive të projektit origjinal, ishte e destinuar për pishinë. Aktualisht aty shfaqet një vaskë-shatërvan në formë kuadratike dhe një esedër-gjysëmrrethore, në gjendje të rëndë degradimi. Disa fragmente të rrethuara me kordon bimor, janë mbjellë me bimë bulbore dhe lule sezonale. Drejt perëndimit shfaqet një panoramë pak konfuze dhe e parregullt, me selvi (*Cupresus sempervirens*) dhe blire (*Tilia x europea.*), kurse drejt lindjes panorama është akoma edhe më e çrregullt, me një rresht të paplotë qitrosh (*Citrus paradisi*) e selvish (*Cupresus sempervirens*), me hapësira boshe dhe zhvillim të bimësisë spontane, e cila duhet rishikuar.

Kjo hapësirë tani përdoret si fushë futbolli. Në jug të esedrës gjysëmrrethore ndeshet një hapësirë e gjerë e pushtuar nga bimësia spontane, kryesisht akacie (*Robinia pseudoacacia*), e cila nëse nuk mbahet nën kontroll, mund të përhapet me shpejtësi.

**12. ISH FUSHA E TENISIT, TASHMË AERODROM**

Kjo hapësirë dikur e destinuar për fushë tenisi, tashmë përdoret si aerodrom. Ndodhet në majë të një stomi artificial, modeluar drejt lindjes me një skarpatë të bukur vegjetale.

Përkufuzohet nga një gardh bushi (*Buxus sp.*) pjesërisht e krasitur, por e degraduar në perëndim e jug, në veri mungon (dallohen vetëm disa dafina të krasitura me formë rrethore) dhe në lindje me disa shkurre dekorative. Në drejtim të lindjes është shumë e rëndësishme të qëndrojë e hapur fushëpamja drejt liqeneve të vegjël paronamikë. Edhe drejt perëndimit mungon një fasadë arkitektonike, e cila sot është e pushtuar nga bimësia spontane dhe e pakontrolluar. Drejt veriut mund të shijohet panorama interesante e vilës.

## 13. HAPËSIRA E MBJELLË NË JUG TË VILËS, QË LIDHET ME ZONAT FORMALE

Kjo hapësirë është e vendosur ndërmjet rrugës që të çon në vilë dhe platesë së Vashës në perëndim e cila ndahet nga platea e Vashës nëpërmjet një gardhi me dafina (*Laurus nobilis*). Aty shtrihen disa bimë me vlera të konsiderueshme botanike përsa i përket dimensioneve dhe formave të tyre, kryesisht disa pisha (*Pinus sp*.)të vendosura në rresht, një bli i bukur (*Tilia x europea*), një grup agrumesh, të lidhura fatkeqësisht me bimësinë spontane aty pranë (akacie, kacavjerrëse, etj.). Duke parë pozicionin qëndror në raport me komponentët e tjerë me vlera të mëdha arkitektonike dhe paronamike të parkut, është e rëndësishme të vlerësohet edhe potencialiteti i kësaj zone, duke rikuperuar ekzemplarët me interes të vecantë dhe duke eliminuar bimësinë spontane të pakontrolluar.

## 14. SERRAT-FIDANISHTET DHE HAPËSIRA PËRRETH

Në këtë zonë aktualisht mbillen e rriten bimët dhe lulet sezonale, përfshin si ndërtesën e serës historike (të degraduar) ashtu si dhe fidanishten e re të ndërtuar së fundmi, për një kultivim më të mbrojtur, por që nuk është integruar ashtu siç duhet me kontekstin. Zona është e kufizuar në veri nga rruga me leandra (*Nerium oleander*) dhe në jug bie mbi hapësirën paronamike të liqeneve të vegjël. Një gardh i krasitur me valëzime dhe disa selvi në rresht, e përcaktojnë këtë zonë drejt jugut.

## 15. ZONA E LIQENEVE TË VEGJËL

Kjo zonë paraqet një impakt të lartë natyror dhe paronamik dhe ka mundësi të mira ripërdorimi si hapësirë vendqëndrimi, pushimi. Tre pasqyrat e ujit (fatkeqësisht me mungesë oksigjeni dhe të pushtuar nga bimësia spontane, sidomos në pjesën veriore, e mbushur me sedimente me forma gjarpëruese, lidhen me bimët me vlera dhe interes të konsiderueshëm, të mbjella në grup ose të izoluara, si selvi (*Cupresus sempervirens*), shelgje (*Salix babylonica*), eukalipte (*Eucaliptus sp*.) dhe pisha (*Pinus pinea*). Nga lindja, ato ndahen nga zona e pyllëzuar nga një rresht mimozash (*Acacia dealbata*), por afër ka edhe bambu (*Phyllostachys aurea*), akacie (*Robinia pseudoacacia*) dhe lloje të tjera bimësh spontane, të cilat nëse nuk mbahen nën kontroll, rrezikojnë të rriten me shpejtësi në mënyrë të pakontrolluar. Lëndinat me bar janë të zhvilluara spontanisht. Zona duhet të vlerësohet me futjen e pemëve të reja në grupe apo të izoluara, por me vlera të mëdha botanike, për të rritur si praninë e llojeve ekzotike ashtu edhe dizajnin e zonës që tani paraqitet i thjeshtë dhe relativisht pa shkëlqim.

## 16. SHTËPIA E BUJKUT DHE HAPËSIRA PËRRETH, SHKALLA ME RRUGËN E BLIRËVE

Kjo zonë është e pozicionuar në perëndim të dy plateve, ka një shtrirje rreth 6 ha dhe ka prirje drejt degradimit në drejtim të kufirit perëndimor të parkut. Hapësira është e pyllëzuar, me një përzjerje kryesisht bimësh gjetherënëse. Bimët janë kryesisht të larta. Zona ka prezencë të bimëve, të cilat rriten në mënyrë të pakontrolluar dhe rrezikojnë të pushtojnë të gjithë formacionin.

Zona lidhet me një shtëpi me kollona, e quajtur "*Shtëpia e bujkut*", tashmë e

shndërruar në gërmadhë bashkë më siloset ngjitur. Në fakt kjo pjesë, dikur përdorej për aktivitetet me karakter bujqësor dhe blegtoral. Në afërsi të shtëpisë së fermerit, dallohet një rresht selvish (*Cupresus sempervirens*) dhe një rrap madhështor (*Platanus sp.*), sikurse edhe blirët interesantë (*Tilia x europea*) përgjatë rrugëve gjarpëruese që përshkojnë pyllin në drejtimin veri-jug. Për t'u theksuar është edhe rruga e gjatë e blirëve që historikisht kanë lidhur hapësirat bujqësore me kopshtin formal. Rruga përfundon në afërsi të centralit që lidhet me vaskën-shatërvan, me një ekzemplar pishe shumë të bukur. Zona ka vlerë të konsiderueshme natyrore, por edhe një numër të konsiderueshëm elementësh me interes arkitektonike e panoramik, që tregojnë se kjo pjesë ishte e përfshirë në dizajnin e gjerë kompozicional dhe ndërtimor të parkut.

**17. ZONA PËRRETH NDËRTESËS HYRËSE DHE OBJEKTE TË TJERA**

Bëhet fjalë për një zonë jo shumë të madhe, të vendosur në perëndim të ndërtesës së vendrojës. Karakterizohet nga një terren i sheshtë që përshkohet nga një rrugë e riasfaltuar kohët e fundit, me një pamje jo shumë tërheqëse. Përgjatë rrugës, dallohen gardhe me dru bushi të krasitura në formë sferike. Drejt veriut, hapësira karakterizohet nga disa ekzemplarë pemësh monumentale, veçanërisht një vidh (*Ulmus campestris*) me përmasa të konsiderueshme por fatkeqësisht me probleme fitosanitare të shkaktuara nga mungesa e mirëmbajtjes (bimë zvarritëse dhe degë të thata), një dru qitro (*Citrus paradisi*) madhështore, edhe ai me probleme fitopatologjike shkaktuar nga mungesa e mirëmbajtjes. Këto ekzemplarë me interes monumental, lidhen me një zonë të mbjellë me fiq (*Ficus carica*) me moshë rreth 20 vjeçarë dhe me përmasa të mëdha, e cila duhet pastruar nga bimësia spontane, të cilat nëse nuk kontrollohen mund të pushtojnë gjithë zonën.

**18. HAPËSIRA PYJORE NË PJESËN LINDORE**

Në pjesën lindore hapësira pyjore vendoset midis rotondës e përbërë nga drurë ahu dhe murit rrethues që e kufizon parkun me rrugën për në Tiranë. Kjo zonë zë një hapësirë prej rreth 4,5 ha dhe shtrihet përgjatë shpatit të pjerrët në drejtimin lindor, e modeluar me skarpata dhe argjinaturë me vlera të veçanta paronamike.

Rrugicat zhvillohen paralelisht me rrugën kryesore, janë të shtruara me asfalt dhe theksohen nga prezenca e qitrove (*Citrus paradisi*), pishave (*Pinus pinea*) dhe blirëve (*Tilia x europea*), me dimensione të konsiderueshme, të mbjella në grupe të vogla ose në rreshta, dhe me vlera të spikatura paronamike.

Rruga kryesore që përshkruan këtë zonë, lidhet me rrugën që fillon nga dhoma vegjetale e Muzikantëve. Kjo pjesë e pyllëzuar mund të jetë një rrugë shumë e bukur këmbësorësh, me vlerë të madhe natyrore për vilën, sepse të lejon të eksplorosh dhe të vlerësosh edhe pjesët e tjera të parkut, si rotondën vegjetale dhe kishëzën.

**19. HAPËSIRA E PYLLËZUAR NË VERI**

Kjo zonë është e vendosur në veri të vilës dhe kufizohet me parkun publik. Zgjerohet përgjatë tatëpjetës që zbret drejt veriut. Zë një hapësirë prej rreth 1,5 ha. Paraqet një lidhje me vilën jo vetëm hapësinore, por edhe vizuale, duke pasur parasysh që përbën sfondin e panoramave që shijohen nga tarraca e vetë vilës. Pikërisht në këtë zonë, projekti fillestar parashikonte realizimin e një teatri që

duhet të formonte zgjatimin e shkallares monumentale së bashku me fasadën përkatëse arkitektonike, por që nuk u realizua.

## 20. HAPËSIRA E PYLLËZUAR NË PERËNDIM

Hapësira e pyllëzuar në perëndim zë një hapësirë prej rreth 1 ha dhe shtrihet përgjatë tatëpjetës që shkon drejt veriperëndimit. Meqënëse është në kufijtë e parkut, ajo përbën një barrierë vizive, akustike dhe funksionale me kontekstin e saj. Hapësira e pyllëzuar në perëndim ka një ngjashmëri me hapësirën e pyllëzuar në veri (nr.19), të cilat janë të lidhura me njëra-tjetrën. Në këtë zonë janë identifikuar dis aspecie shumë interesante si: arra e Indisë (*Ailanthus altissima*), mani Kinez (*Brussonetia papyrifera*), plepi i zi (*Populus nigra*), plepi i bardhë (*Populus alba*), pisha e butë (*Pinus pinea*), pisha e detit (*Pinus pinaster*), ahu (*Quercus ilex*), dushku (*Quercus spp.*), dru qarri (*Quercus cerris*), ah i butë (*Quercus frainetto*), dushk i butë (*Quercus pubescens*), ahu trojan (*Quercus trojana*), akacia e bardhë (*Robinia pseudoacacia*) dhe bliri (*Tilia x europaea*).

Në brendësi të kësaj zone, nuk janë hasur ekzemplarë të tjerë me vlera të veçanta botaniko-arkitektonike, por bien në sy problemet fitopatologjike, për shkak të mungesës së mirëmbajtjes (tharje të degëve, dredhka nëpër trungje, etj). Edhe në këtë zonë rrjeti i rrugicave nuk garanton shtrytëzimin maksimal të zonës, prandaj duhet rivlerësuar dhe rikuperuar.

## 21. HAPËSIRA E PYLLËZUAR NË JUGPERËNDIM

Kjo zonë zë një hapësirë prej rreth 2 ha dhe përhapet në jug të pjesëve formale të kopshtit e cila lidhet me hapësirën gjysëmrrethore, esedrën dhe vaskën shatërvan, që sot përdoret si fushë futbolli dhe ish-fushën e tenisit, tashmë aerodrom.

Kjo zonë paraqitet e kufizuar në juglindje nga një rresht i gjatë mimozash (*Acacia dealbata*) me pamje mbi liqenet e vegjël. Zona paraqet një bimësi të përzierë me bimë gjetherënëse dhe konifere, ku bien në sy speciet e mëposhtme: mani kinez (*Brussonetia papyrifera*), qitro himalaje (*Cedrus deodara*), bredhi i kuq (*Picea abies*), pisha e butë (*Pinus pinea*), akacia e bardhë (*Robinia pseudoacacia*), bliri (*Tilia x europaea*).

Në brendësi të zonës, shfaqen disa ekzemplarë me interes të veçantë botanik dhe arkitekturor, si blirë (*Tilia x europaea*), cedri (*Cedrus deodara*), dhe pisha të buta (*Pinus pinea*) me dimensione të konsiderueshme. Në këtë zonë hasen probleme fitopatologjike, sidomos për shkak të mungesës së mirëmbajtjes (tharje, dredhka nëpër trungjet e pemëve, vegjetacion infektues, etj).

Rrjeti i rrugicave të asfaltuara, i kufizuar nga gardhe të krasitura rregullisht, është mjaftueshmërisht efiçent për të garantuar një shfrytëzim të mirë të hapësirës, e cila padyshim ka karakteristikat e duhura natyrore dhe pyjore, por në krahasim me zonat e tjera të pyllëzuara që përmendëm më lart (zona 19 dhe 20) ka një lidhje më të qartë me zonat më mira të projektuara të parkut. Pra është e rëndësishme, siç theksuam edhe për zonën e pyllëzuar në pjesën lindore (zona 18), të merret në konsideratë edhe roli arkitektonik dhe panoramik i kësaj zonë, e cila duhet të përfshihet në procesin e vlerësimit si në zonën me esedrën gjysëmrrethore dhe me vaskën shatërvan, ashtu edhe në zonën e serrave/fidanishtes dhe në zonën e liqeneve të vegjël, për një riprojektim të ri

arkitektonik dhe panoramik për përcaktimin e funksionit të ardhshëm të Ansamblit.

## 22. LISNAJA

Kjo zonë zë një sipërfaqe prej rreth 7 ha dhe shtrihet në pjesën juglindore të parkut, mbi një sipërfaqe të rrafshët, me një reliev pjesërisht të dalë (të kërcyer) në drejtim të jugut.

Ajo përfshihet nga një lisnajë domethënëse me lisa të varieteteve të ndryshëm dhe nga një nënpyll kryesisht të përbërë me bimë halore. Më hollësisht përmendim: Lisin (*Quercus robur*), dushkun (*Quercus sp.*), dushk Turqie (*Quercus cerris*), farnetto (*Quercus frainetto*), dushku i butë (*Quercus pubescens*), lisi (*Quercus sessi*), fragno (*Quercus trojana*). Ndërsa në nënpyll bien në sy dredhkat, gjineshtrat (*Spartum junceum*), dafinat (*Laurus nobilis*) dhe shkurre të tjera të llojeve të ndryshme sidomos në pjesën jugore, kurse në pjesën veriore ka më shumë bimë spontane dhe bimë parazite (sidomos shkurre) të cilat duhet eliminuar dhe mbajtur nën kontroll për të shmangur përhapjen e shpejtë.

Bimësia është në gjendje të mirë konservimi dhe nuk ka probleme të thella fitosanitare. Lisnaja përfaqëson një formacion tipik vegjetal të territorit të Shqipërisë, ndaj merr përparësi vlerësimi i kujdesshëm i saj që lidhet me karakteristikat e peizazhit lokal.

Zona e pyllëzuar paraqet një interes të veçantë natyror dhe ambiental dhe ka mundësi shumë të mira shfrytëzimi (nëpërmjet përcaktimit të itinerareve natyrorë brenda parkut, zhvillimin e orëve për edukim ambiental nëpër shkolla që ndërgjegjëson dhe vë në dukje vlerën e zonës).

## 23. ZONA E DEGRADUAR ME PJESË LËNDINASH DHE MASA VEGJETALE

Kjo zonë rezulton e paprojektuar, e pushtuar nga një masë e dendur bimore në pjesën veriore dhe nga një pjesë “bosh”, me pjesë lëndinash të mbuluara me bar në jug. Ajo shtrihet në zonën e lidhur me hyrjen kryesore që karakterizohet nga disa ekzemplarë monumental si: vidh (*Ulmus campestris*) dhe rrap (*Platanus sp.*), (shiko zonën 17), me zonën e serrave/fidanishtes dhe aerodromit në drejtimin perëndimor (zona 12-14), ndërsa në jug kufizohet me zonën e liqeneve të vegjël dhe lisnajën (respektivisht zonat 15 dhe 22) dhe në veri me rrugën hyrëse që nga porta e madhe që të çon në hapësirën gjysëmrrethore dhe në vilë. Ajo përshkruhet nga një rrugë e drejtë e cila së fundmi është asfaltuar e cila lidh zonën e hyrjes me aerodromin.

Në këtë zonë skicat e projektit fillestar parashikonin realizimin e një piste për vrapim kuajsh, e cila mesa duket nuk pati mundësi të realizohej. Një shtrirje të gjerë zenë bimë si: qitro Himalaje (*Cedrus deodara*), plepi i zi (Populus nigra), plepi i bardhë (*Populus alba*), pisha e butë (*Pinus pinea*), akacia (*Robinia pseudoacacia*), shelgu i bardhë (*Salix alba*) i cili shtrihet sidomos në drejtimin jugor, zonë ku ka shumë bimë parazite dhe spontane si bambuja (*Phyllostachys aurea*). E gjithë zona paraqet një stanjacion hidrik, për të cilin duhen përcaktuar shkaqet dhe gjetur mënyrat e realizimit të drenazhimit. Në skajin lindor, një pjesë e mirë është e zënë nga depozitime mbetjesh, të cilat duhet të hiqen sa më shpejt.

Në brendësi të masës vegjetale vihen re ekzemplarë bimësh me përmasa të konsiderueshme, por gjendja aktuale moçalore dhe prezenca e vazhdueshme e bimëve parazite, nuk lejojnë hyrjen e lirë në brendësi të saj për një rilevim më të detajuar.

Drejt perëndimit, në kufirin midis serave dhe aerodromit, paraqiten disa bimë të larta me vlera të shumta botanike dhe arkitektonike, mes të cilave spikat një grup eukaliptesh (*Eucalitus sp.*), pisha detare (*Pinus pinaster*) dhe të buta (*Pinus pinea*), dhe një vidh (*Ulmus campestris*) plot hijeshi.

Kjo zonë, duke pasur parasysh shtrirjen dhe lidhjen me pjesët e tjera me vlerë natyrore dhe mjedisore si dhe me zonat ku shumica janë të projektura, ka potencial të rëndësishëm për ripërdorim dhe duhet të jetë subjekt i një ridizenjimi të konsiderueshëm, me përcaktimin e skenave arkitektonike që duhen realizuar me bimë drunore dhe shkurrore dekorative në kufirin jugor dhe verior.

Zona mund të ketë një funksion rekreativ, me vendpushime zona çlodhjeje, për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe ekspozuese me impakt të lehtë, dhe duhet të lidhet në mënyrë funksionale dhe me dizenjo panoramike, me zonën e liqeneve të vegjël dhe aerodromin që falë pozicionit të tyre, përbëjnë sfondin arkitektonik të kësaj zone.

**24. HAPËSIRA PËRRETH KUFIRIT JUGLINDOR**

Hapësira përreth kufirit juglindor është një zonë e pyllëzuar kufizuese, e mbushur me plepa (*Populus alba* dhe *Populus nigra*) të vegjël që lidhen me bimësinë spontane dhe lëndinat e vogla me bar.

Në brendësi hasen disa ndërtime të vogla për impiantet teknike tashmë të degraduar, dhe një bunker i cili mund të shtrytëzohet për një vlerësim muzeal. Duhet të verifikohet rikuperimi i mundshëm i këtyre impianteve (në veçanti impianti i furnizimit me ujë dhe zbrazja e liqeneve të vegjël) dhe të bëhet rishikimi i plotë i sistemit hidraulik.

Zona duhet t'i nënshtrohet një ndërhyrjeje vlerësimi (eliminimi i vegjetacionit infektues, mbjellje të reja, rikrijimi i zonave me bar, etj.) me qëllim lidhjen e kësaj pjese me lisnajën me vlerë natyrore dhe ambientale.

**25. ZONA QË LIDHET ME IMPIANTËT TEKNIKË DHE INFRASTRUKTIRËN E SHËRBIMEVE**

Kjo zonë, aktualisht e shfrytëzuar për aktivitete ushtarake, është e paaksesueshme dhe e pa rilevuar. Vetëm pas një vizite në vend dhe ndalimit të aktiviteteve që aty aktualisht kryhen, do të mund të vlerësohen mundësitë që ajo ka për ripërdorim, dhe lidhja funksionale, vetëm pas një inspektimi dhe ndalimi të aktiviteteve që po zhvillohen aktualisht. Gjithashtu, do të jetë e mundur të kuptohen përdorimet e mundshme të kësaj pjese të parkut të cilat lidhen me anën funksionale dhe panoramike me pjesët e tjera që e rrethojnë.

**Të dhënat historike  dhe analizimi i dokumentave arkivorë**

PMI-ja rekomandon që në përgatitjen e projekteve restauruese dhe konservuese në kompleks, specialistët të marrin në shqyrtim materialet arkivorë.

Në Arkivën e Ndërtimit të Tiranës, janë ruajtur projektet dhe lista e pemëve të dy territoreve, të përgatitura nga Sgaravatti dhe arkitekti i tij, ndërsa nga propozimi i Porcinai-t, kontribues i kompanisë Bianchi në vitet e para të aktivitetit të saj, gjenden të dyja listat e pemëve, por vetëm një planimetri për Sistemimin e Parkut në Kodër Mullet.

Në dokumentacionin arkivor shfaqet propozimi i kompanisë Sgaravatti, paraqitur në shkurt 1937-ës, rishikuar e më pas aprovuar nga vet Mbreti në Janar të vitit 1938, i cili u bë objekt i një tenderi të ri për dhënien e porosisë (dorëzimin e punimeve). Kompania Sgaravatti nuk mori pjesë në ofertat për furnizimin me pemë, e cila në tetor të 1938-ës, iu besua kompanisë Martino Bianchi të Pistoia-s.

Në realizimin e projektit mori pjesë edhe arkitekt Giulio Berté, të cilit iu besua projekti për ndërtimin e murit rrethues me kulla vrojtimi, i cili e ndante parkun nga pjesa tjetër e parkut publik përreth.

Nga hartat e Arkivit të Ndërtimit në Tiranë, nuk mund të përcaktohet se cili projekt u realizua, përveçse nga rilevimet dhe planimetritë e mëvonshme të hartuara nga arkitekti Gherardo Bosio. Ky i fundit, aktiv në kantier që prej vitit 1939, harton një propozim për Sistemimin e pemëve të Vilës së Mëkëmbësisë së Tiranës, të cilin pas vdekjes së arkitektit në vitin 1941, e mori përsipër arkitekti Ferdinando Poggi, bashkpunëtor i vet Bosio-s. Planimetria e përgjithshme e projektit evidenton qartësisht propozimet e hartuara nga Sgaravatti me disa variacione, të cilat janë shënuara si objekte për ndërhyrje, dhe lidhen me rrugën hyrëse me esedrën në sfond, rrugën dhe tarracën përballë vilës, sistemimin e hapësirës përballë saj, belvederen, platenë dhe kopshtin intim. Realizimi i punimeve vazhdoi deri në vitin 1943, vit në të cilin një rrëshqitje dheu në pjesën verilindore të vilës, dëmtoi disa pjesë të kopshtit, por sidomos disa pjesë të rrjetit të ujitjes. Kjo e fundit, e realizuar që në fillim të projektit në vitin 1940 nga Inxh. G.Zanetti, shkaktoi mungesën e vatitjes së parkut por edhe mungesën për ujë të pishëm.

Projekti lejon zbulimin e një lidhjeje reciproke me propozimin e Bosio-s, raportohen në fakt si elemente prezent në park një pishinë, fusha e tenisit, pista e vrapimit të kuajve me stallat, një kopsht model italian dhe një shtëpi me kolona për të cilën megjithatë, nuk ka detaje në lidhje me realizimin. Në veçanti pista e vrapimit të kuajve me stallat, tenisi dhe pishina, në planimetritë e Bosio- Poggi-t, si edhe në dokumentat e miratuar nga Inxh. Remi Bace, nënvijëzohen gjithmonë si punime "të planifikuara".

Nëse krahasimi midis propozimit bërë shoqërisë Sgaravatti dhe listës së furnizimit të pemëve, përcakton me detaje rregullimin botanik të propozuar, analizat e projektit të përgjithshëm Bosio-Poggi dhe të dhënat e detajuara për çdo hapësirë më vete, lejojnë përshkrimin e planimetrisë dhe transformimet botanikë të ndodhura në park mes viteve 1940 dhe 1943. Është pjesë e projektit ndërtimi i kishës (Kapelës) brenda parkut në afërsi të labirintit. Ky i fundit, i paraqitur në planimetritë e para të Bosio-s, është thjeshtuar më pas, me sa duket nga Poggi, duke e kthyer në një vendpushim mes rrugëve të parkut që të çojnë në kishëz.

Duhet të evidentohen gjithashtu edhe prezenca e dokumentacionit fotografik,

ruajtur në Arkivin e Institutit “Luce” kopje e të cilave gjenden edhe në Arkivin e Shtetit në Tiranë dhe në Arkivin Bosio-s, që datojnë në vitet 1940-1941 dhe prezenca e një kronike televizive, gjithashtu e ruajtur në Arkivin e Institutit “Luce” (Drita), e cila dokumenton vizitën e Viktor Emanuelit III në Tiranë në Maj të vitit 1941, të cilat tregojnë gjendjen e parkut, i cili paraqitet plot pemë, të paktën në pjesën përballë Vilës, por nuk na lejojnë të shohim prezencën e pishinës, fushës së tenisit dhe korsitë e garave të kuajve.

## Integriteti

Ambientet e këtij aseti të rëndësishëm kombëtar paraqesin shumë elementë komplozicionalë që diktojnë vlerën e tij integrale arkitektonike, kulturore dhe peizazhore. Por vlen të përmendet fakti i gjendjes mjaft të mirë fizike të tij si dhe të përcjelljes në mënyrë integrale të këtyre vlerave deri në ditët tona. Në gjendje shumë të mirë paraqiten ambientet përfaqësuese, të cilat përdoren për eventet më të rëndësishme kombëtare e ndërkomëtare të shtrira sidomos në katin përdhe, apo ambientet e vizitueshme në katin e parë ku ndodhen një seri me ambiente të vizitueshme të cituara më sipër.

Parku është një tjetër sistem vlerash unike për vendin, frut i një pune të admirueshme jo vetëm nga konceptuesit e shumtë italianë, por edhe nga rigoroziteti i autoriteteve shqiptare që u impenjuan në pasurimin e tij në dekada si dhe në mirëmbajtjen konstante të tij. Gjatë periudhës së dikaturës komuniste, parku u lidh në mënyrë integrale me Parkun e Madh të Tiranës në pjesën perëndimore, si dhe në pjesën Jug-Lindore u shtua sistemi i madh i Varrezave të Dëshmorëve.

Seritë e ndryshme brenda 2 sistemeve të mëdha që paraqesin vlera integrale dhe janë të ruajtura mirë janë:

- Ndërtesa e Pallatit të Brigadave në tre katet e tij
- Sistemet e ndryshme të mobilieve në katet e ndryshme të projektuara nga Bosio dhe kolegët e tij
- Mermerët dhe elementët e dekorit brenda e jashtë AHPB
- Bazorielievët e shumtë në mermer e në allçi
- Ndriçuesit e shumtë të të gjitha niveleve
- Sistemet e ndryshme teknologjike të cilat kanë qenë avangardë për kohën
- Skulpturat e shumta në park
- Parku me të gjithë elementët e tij përbërës nga ana botanike dhe peizazhore
- Strukturat e ndryshme në funksion të dy sistemeve të mëdha, Pallatit dhe Parkut.

Edhe pse në vitet e fundit, në disa pjesë të vilës paraqiten probleme të degradimit nga infiltrimet e ujit të shiut në sistemin e kullimit, si dhe të amortizimit të pjesëve të ndryshme nga mosha e ndërtesës, kompleksi në përgjithësi është në gjendje të mirë.

Gjithsesi, ky kompleks është ende i cenueshëm në rast se nuk ka një koordinim të mirë të punimeve konservuese dhe restauruese, mirëmbajtjes së dedikuar të bimësisë, si dhe rehabilitimit të veprave të artit brenda si në Pallat, ashtu dhe në Park.

Gjithashtu, ka edhe disa shqetësime për shkak të zhvillimeve bashkëkohore, duke përfshirë ndërtimin dhe zgjerimin e rrugës së Elbasanit, ku u cenua edhe muri rrethues i Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave. Edhe pse u premtua se do të rindërtohej në atë kohë, nuk është realizuar ende. Megjithatë, Ansambli Historik të Pallatit të Brigadave mbetet një shembull i shkëlqyer i ruajtjes së një kompleksi arkitekturor të veçantë e autentik.

## Autenticiteti

Si një Ansambël Historik, të gjitha sistemet bërenda dhe jashtë Pallatit të Brigadave, paraqiten si një sit i jashtëzakonshëm i trashëgimisë kulturore në qytetin e Tiranës, fryt i arkitekturës së mrekullueshme të viteve 1930-40. Kjo gjë është përcaktuar edhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, **nr. 752, datë 11/11/2004**, ku Pallati i Brigadave dhe Parku i tij janë shpallur "**Ansambël Historik**".

Autenticiteti i Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave lidhet me vlerat arkitektonike të mobilimit të brendshëm, dizajnit autentik, arkitekturës moderne të viteve 1930-40, si dhe projektit të parkut të pasur me koncepte e detaje. Vlerat autentike konsistojnë në faktin që ai është:

- I vetmi kompleks mbretëror në Shqipëri i ruajtur mjaft mirë e në mënyrë integrale

Ruajtja e shkëlqyer të tij e cila kaloi dy sisteme diktatoriale, erdhi edhe për faktin se aty nuk banoi më askush pas vitit 1943, por shërbeu për pritje të nivelit të lartë si dhe akomodim delegacionesh qeveritare.

Cilësia e punimeve të mirëmbajtjes së parkut të madh, gjatë viteve të diktaturës komuniste, por edhe në ditët tona, ka qenë mjaft e mirë. Njëkohësist ndërhyrjet e mëvonshme për parkun e Madh të Tiranës ja kanë rritur vlerën të gjithë Ansamblit.

Ndërhyrjet restauruese të cilat duhet të kryhen në të ardhmen duhet të jenë në përputhje me standardet bashkëkohore, të përcaktuara në Kartën e Venecias të vitit 1964 dhe  në kartat e konventave të mëvonshme.

## Kërkesat aktuale të mbrojtjes dhe menaxhimit

Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave u përfshi në Listën e Trashëgimisë Kombëtare të Monumenteve të Mbrojtura me Vendimin e Këshillit të Ministrave, **Nr. 752, datë 11/11/2004**, ku Pallati i Brigadave dhe parku i tij janë shpallur "**Ansambël Historik**". Aktualisht, mbrojtja dhe konservimi i monumenteve parashikohet në ligjin 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore".

Vlerat natyrore të Parkut të Pallatit të Brigadave sëbashku me Parkun e Madh të Tiranës dhe Liqenin Artificial janë zona të mbrojtura edhe nga Plani i Përgjithshëm Vendor i qytetit të Tiranës Tirana-2030.

Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave paraqet edhe disa aspekte të cenueshmërisë për shkak të degradimit dhe kostos të lartë të mirëmbajtjes. Ndërkohë që edhe hapja për publikun, që mund të sjellë të ardhura të mjaftueshme, kërkon një kontroll në raport me dëmet që mund të sjellë si pasojë e mos koordinimit dhe pakujdesisë së menaxhimit të flukseve.

Ka shumë gjasa që këto cenueshmëri mund të vënë në rrezik integritetin e objektit në një të ardhme afatgjatë. Për të shmangur kërcënimet ndaj integritetit dhe autenticitetit, monitorimi dhe kontrollimi i cenueshmërive janë paraqitur si çështje themelore në Planin e Menaxhimit të Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave.

Qyteti i Tiranës është rritur shumë, dhe kjo pjesë e mbrojtur shërben si një oaz i gjelbër në pëlhurën urbane të qytetit. Është pikërisht kjo ndërthurje e monumenteve historike dhe mjedisit natyror që e bën Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave një vend unik, një peizazh ideal me arkitektura dhe vepra arti të çmuara, e barasvlershme me pallatet mbretërore apo të sundimtarëve të vendeve të ndryshme evropiane.

Në këtë pjesë të gjelbër të sistemit të madh të Parqeve, ndërhyrjet e njeriut kanë qenë në harmoni me natyrën dhe kanë krijuar një zonë mjaft të kërkuar nga qytetarët e Tiranës. Sot, Pallati i Brigadave paraqet një ndërthurje unike të peizazheve arkitektonike, artistike dhe natyrore, të cilat ilustrojnë më së miri marrëdhënien e njeriut me natyrën përgjatë shekullit të fundit. Veçantia e Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave përcaktohet jo vetëm nga ballafaqimi i mjediseve, qoftë natyrore apo të arkitektonike, ose i vendndodhjeve të tij topografike, por ajo që tërheq interesin dhe kërkimin është edhe historia e saj në lidhje me pushtetet dhe ideologjitë.

**Rëndësia e ruajtjes dhe restaurimit të pasurisë arkitektonike**

Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave në territorin tonë vjen nga një kombinimi shumë i rrallë i arkitekturës moderniste, mobilimit të rafinuar, artit të pasur dhe parkut të pasur me detaje dhe shumëllojshmëri speciesh bimore. Së bashku me Parkun e Madh të Tiranës dhe Liqenin Artificial të Tiranës, përbën një peizazh kulturor dhe natyror të jashtëzakonshëm, duke luajtur një rol të rëndësishëm në qytetin e Tiranës.

Vlera e Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave lidhet me ruajtjen e shkëlqyer të një Kompleksi, ku ndërveprimi i njeriut me mjedisin mund të vërehet në monument, për vlerat e tij arkitektoike, por edhe në park, për vlerat e tij pejzazhistike.

Aktualisht, mbrojtja dhe konservimi i monumenteve parashikohet në Ligjin për Trashëgiminë Kulturore.

Rijetëzimi i Pallatit të Brigadave dhe Parkut përreth tij duhet të paraprihet nga konservimi dhe restaurimi i çdo vlere historike dhe arkitektonike që ato përmbajnë. Duke konservuar do të mund të shmanget degradimi i mëtejshëm dhe

duke resatauruar do të mund të ndërhyhet, në respekt të të gjithë ligjeve dhe konventave ndërkombëtare, për të rikthyer në gjendje origjinale vlerat artistike e arkitektonike të tyre. Për këtë plani i menaxhimit propozon:

**Restaurimi i Pallatit**

I ndodhur sot në një gjendje degradimi arkitektonik dhe të materialeve, pallati paraqet një nevojë të ndërhyrjes urgjente, në shumë pjesë të tij. Ky restaurim duhet të ndahet në faza, duke planifikuar që të bëhen në kohë të veçanta:

a) Restaurim emergjent
b) Restaurimi dhe konsolidimi i problemeve të çedimit apo çarjeve strukturale
c) Eleminimi i problemeve të infiltrimit të ujit
d) Restaurimi i rifiniturave
e) Restaurimi i elementeve dekorative dhe veprave të artit në interier
f) Restaurimi i dyerve dhe dritareve origjinale
g) Restaurimi i ndriçuesve
h) Restaurimi i mobilieve
i) Restaurimi i detajeve arkitektonike të eksterierit
j) Konservimi dhe restaurimi i vlerave të Parkut të Pallatit të brigadave duke ruajtur origjinalitetin e tij
k) Restaurim i parkut dhe të gjitha aseteve të tij natyrale, artistike, ndërtimore dhe pejzazhistike
l) Aksesibiliteti dhe vendosja në funksion të vizitorëve duke e kthyer në një pikë atraktive të qytetit
m) Menaxhimi konservativ nepërmjet drejtimit e organizimit të flukseve të lëvizjes në park
n) Katalogimi i të gjithë vlerave artistike të Pallatit duke krijuar databazën që do të shërbejë për konservimin dhe restaurimin në vazhdimësi. Database duhet të përmbledhë gjithë fondin e objekteve të lëvizshëm dhe të palëvizshëm, origjinale të kohës së ndërtimit.

**Restaurim i mobiljeve, elementëve të arredimit.**

Pallati i Brigadave është një nga objektet që ruan akoma mobiliet e pajisjet e interierit, të projektuara nga Ark. Gherardo Bosio, të cilat tashmë thuajse 80 – vjeçare, kanë nevojë të restaurohen. Ky sfond i pasur objektesh arti duhet të bëhet i pari laborator i restaurimit të mobiljeve historike në Shqipëri, i cili mund të përdoret si një qendër kerkimore e didaktike për restauratorët e fushës.

Plani i Menaxhimit propozon katalogimin e tyre dhe krijimin e një databaze të mobilieve dhe objekteve të arredimit të brendshëm të pallatit. Databaza duhet të përmbledhë gjithë fondin e objekteve të lëvizshëm dhe të palëvizshëm, origjinale të kohës së ndërtimit.

**Faqja WEB**

Të krijohet faqja ëeb e pallatit me të gjithë informacionin historik, vizual arkitektonik, artistik e të mobiljeve e ndriçuesve që ndodhen në të. Ky sit mund të ofrojë guida virtuale e të ndikojë pozitivisht në propagandimin e kësaj pasurie të trashëgimisë sonë.

**Restaurim i artifakteve dhe veprave të artit në interier e eksterier.**

Gjendja e konservimit (pikturat)

Pikturat e realizuara në telaio, paraqesin problematika të natyrave të ndryshme të degradimit. Infiltrimet e lagështisë nga muri, kanë sjellë problematika të dukshme në sipërfaqet e disa prej veprave. Kjo vihet re dukshëm në gjashtë tablotë e pjesës së sipërme të sallës qendrore. Një pjesë e mirë paraqesin nxirje të sipërfaqes së pikturuar si rrjedhojë e vernikut të alteruar. Ka dhe prej tyre që kanë pësuar dëmtime mekanike (çarje të suportit).

Gjendja e konservimit të pikturës murale

Piktura murale e realizuar me tempera në teknikën e aseccos, ndodhet në korridorin e apartamentit të njohur me emrin Berlusconi. Ajo përgjithësisht ruan një gjendje mjaft të mirë konservimi. Vetëm në panelin pozicionuar në anën e djathtë paraqiten infiltrime të lagështisë, të lokalizuara kryesisht në anën e djathtë dhe në zonën e sipërme dhe qendrore të panelit.

Funksione ekzistuese:

Një pjesë e veprave në pikturë, që dekorojnë muret e brëndëshme të pallatit të brigadave, u përkasin periudhave të ndryshme kohore si dhe autorëve piktorë të mirënjohur dhe me një veprimtari të konsiderueshme dhe të sukseshme në artet pamore. Vërejmë që përveç një vepre murale, pjesa tjetër janë piktura të realizuara në beze. Një pjesë e veprave janë krijuar për të qënë pjesë integrale e ndërtesës, ndërsa të tjera janë bërë në përiudha të mëvonshme, pjesë e strukturave të brëndshme me qëllim dekorimi të mjediseve.

Restaurimi dhe Funksionet shtesë që propozohen:

Veprat e artit mund të kuptohen dhe vlerësohen më shumë nëse do të bëhen pjesë e tureve tematike. Koleksioni i DSHQ, në pallatin e Brigadave posedon një koleksion me nëntëmbëdhet (19) vepra në total, ku 1 konsiderohet pasuri e paluajtshme (pikturë murale dhe e lidhur me strukturën murore) dhe tetëmbëdhjet të tjera janë vepra arti në pikturë mbi telajo. Ato nuk janë të shumta në numër, krahasuar me sipërfaqen e ndërtesës si dhe mjediset e brëndëshme. Bazuar nga materialet arkivore, disa nga veprat e luajtshme me tematike fetare, dikur pjesë e AHPB, sot i posedon fondi i Galerisë Kombëtare të Arteve. Mendojmë se me shumë gjasa janë hequr prej andej, pas vitit 1967. Edhe ato pak vepra, (gjashtë) të realizuara me tematikë mitologjike, një periudhë të caktuar u larguan nga AHPB, për në galerinë e arteve dhe më pas në vitin 1996 u rikthyen aty. Me përmirësimin e kushteve të brendëshme të Pallatit, rekomandojmë pasurimin e këtij fondi të vogël, nëpërmjet rikthimit të veprave nga GKA, koleksionet që kanë qënë pjesë e Pallatit të Brigadave qysh në fillim.

Restaurimi është një proces së cilit veprat e artit duhet tu nënshtrohen fillimisht. Një pjesë e tyre paraqesin nevojë imediate për ndërhyrje. Ky proces, hapat e të cilit duhet të dokumentohen, do të jetë pjesë plotësuese e dokumentimit të përgjithshëm për veprës. Pas restaurimit, rekomandojmë një proces të vazhdueshëm monitorimi të veprave të ekspozuara, duke marrë për bazë një

konservim parandalues sa më të përshtatshëm.

Propozime për intenerare artistike për vizitorët:

Inteneraret që mund të ofrohen në këtë kompleks, mund të jenë të shumta e të shumëllojshme. Ata mund të propozohen si intenerare artistike më vete por edhe të ndërthurura me elementë të tjerë të kompleksit, si ato arkitektonike, mjedisore, historike etj, duke u fokusuar në tematika që lidhen me:

1. Frymëzime mitologjike (vepra arti në pikturë dhe skulpturë)

2. Arti i kohës moderne të ‘900 (krijimet në pikturë dhe skulpturë në vitet ’40 në AHPB)

3. Krijimtaria dhe veprat e Maraini, Morbiducci dhe Zambini në kontekstin e artit në Italinë e viteve ’40.

4. Rrugëtime arkitektonike - artistike fetare në AHPB

Sugjerojmë gjithashtu krijimin e një faqe ëeb e AHPB ku do të përfshihet gjithë informacionin historik, arkitektonik, artistik e të artifakteve, që mund të divulgohet nëpërmjet tureve virtuale që mund të ofrohen. Këto ture të interierit mund të ndërthuren edhe me vizita virtuale të kompshteve dhe parkut që pashmangshmërisht do të ndikojë pozitivisht në promovimin e kësaj pasurie pjesë e rëndësishme e trashëgimisë sonë.

**Vlerësimi dhe gjendja ekzistuese e veprave të artit në skulpturë**

Në realizimin e skulpturave dedikuar AHPB kanë marrë pjesë disa autorë të periudhës para Luftës së Dytë Botërore dhe të periudhës së komunizimit.

Në periudhën e paraluftës , autorët e perzgjedhur të njohur në atë kohë, ishin italianët, Antonio Maraini, Publio Morbiducci dhe Emanuele Zambini si dhe skulptori i mirënjohur shqiptar, Odhise Paskali. Ndërsa në periudhën e komunizmit janë dy autorë shqiptare: Dhimo Gogollari dhe Hektor Dule.

ANTONIO MARAINI në vitin 1940 kryesisht ka punuar me shtatoret e ndryshme jashtë ndërtesës, përkatësisht në veri-lindje të Pallatit Mbretëror. Katër shtatore të realizuara në gur-shtuf me tematikë; “muzikantët,” dhe një shtatore tek “Shatërvani i Mbretëreshës”, e realizuar në bronz “vajza me shtamë”. Gjithashtu një tjetër shtatore figurë femre nudo, (frymezuar nga mitologjia), është vendosur tek pjesa e kopshtit “Pantea e Vashes”. Përmasat e shtatoreve janë konceptuar në harmoni të plotë me exterierin (afërsisht 2.2 metër). MARAINI ka bërë edhe dy skulptura në përmasa të vogla material bronz, në katin e tretë të Pallatit si dhe një skulpturë në gur në hyrje të kishezës, me tematikë fetare.

PUBLIO MORBIDUCCI ka punuar dy relievet në muret e shkallëve të katit të dytë me tematikë nga jeta dhe punët e përditshme, duke u shfaqur me një figurativë më moderne dhe të stilizuar. Gjithashtu MORBIDUCCI ka realizuar edhe 15 relieve në tavanin e dhomës së Mbretëreshës në material gips, me skena gjahu dhe figura kafshësh.

EMANUELE ZAMBINI ka punuar relievet e parapeteve prej mermeri në pjesët e shkallëve me simbolikat e kohë, kryesisht të asaj fashiste. Janë gdhendur në

mermer një sërë logosh të stilizuara, që prekin pothuajse të gjitha sferat e jetës në atë kohë, ku përveç funksionit si korimano e shkallëve, ato lujnë edhe një rol dekorativ të spikatur plot vlera skulpturore.

ODHISE PASKALI duke qenë ndër skulptorët më të famshëm të asaj kohe në Shqipëri, atij i është besuar realizimi i kompozimit në hyrje të Pallatit Mbretëror. Autori ka paraqitur një nënë të re nudo, me dy femijë duke shfaqur qartësisht frymezimin nga arti i rilindjes italiane. PASKALI ka realizuar edhe katër bustet në bronz, në pjesën e odeonit, ku ka paraqitur figurat e kombit: Bajram Curri, Vaso Pasha, Jeronim De Rada dhe Kostandin Kristoforidhi. Në sallën kryesore të pritjeve ndodhet edhe busti i Skënderbeut, në bronz me autor Paskalin.

DHIMO GOGOLLARI dhe HEKTOR DULE janë bashkëautorë në realizimin e relieveve në bronz në hyrje të ndërtesës, në të dyja faqet anësore. Realizimi është bërë në kohën e komunizmit (viti 1971). Relievi në të majtë të hyrjes është i ndareë në tre fragmente të barabarta dhe çdo fragment ka tematikën e luftës në kohë të ndryshme: (lufta e Skenderbeut, rilindja dhe lufta nacionalçlirimtare). Ndërsa në të djathtë, simetrikisht është i fragmentuar në tre pjese dhe në të tria kuadratet pasqyrohet puna në bujqësi, industri dhe edukimi i brezave.

Skulptura ne bronz (autorë të ndryshëm)

Gjendja e skulpturave të bronzit është shumë e mirë nga ana strukturore me përjashtim të 3-4 dëmtimeve lehtësisht të riparueshme. Sa i perket anës estetike, vërehen se nuk lexohet qartësisht forma. Ky problem lidhet me mirëmbajtjen, pastrimin, patinimin dhe dyllosjen në menyrë permanente të tyre.

Skulptura ne mermer (gur)

Kryesisht shtatore të Antonio Marainit që gjenden në ambientet e jashtme të ndërtesës, janë në gjendje relativisht të mirë. Problemet që vërehen kanë të bëjnë me sfumimin e sipërfaqes së formës, e ardhur kjo nga kushtet atmosferike dhe dobësia e materialit me të cilin janë realizuar. Gjithashtu nga mosmirëmbajtja për një kohë të gjatë, një sipërfaqe e konsiderueshme e shtatoreve është mbuluar nga myshqet. Ndërsa reliefet e realizuara nga Zambini në pjesën e shkallëve, janë në gjendje shumë të mirë.

Skulptura ne material dytësor ( beton ose gipse)

Këto skulptura (relieve) që i përkasin Publio Morbiduccit, dhe gjenden në anësore të shkallëve të brendshme të katit të dytë të ndërtesës si dhe në tavanin e dhomës se Mbretëreshës, janë në gjendje jo të mirë, çka do të thotë që me ndërhyrjet jo profesionale qä janë bërë në vite (lyerje me bojë ose gëlqere), vepra ka humbur freskinë e origjinës. Pra nuk është prekja e ndjeshme e autorit.

Ndërhyrjet e propozuara:

Më qëllim që këto vepra arti në skulpturë, të jenë sa më atraktive dhe të tërheqin sa më shumë vizitorë, duhet që në bazë të një projekti të detajuar për çdo vepër, brenda dhe jashtë ndërtesës, të ndërhyet për riparimin, restaurimin, mirëmbajtjen në mënyrë të vazhdueshme, duke u bazuar në të gjitha kriteret dhe rregullat e restaurimit, me qëllim që të mos cënohet forma e finalizuar nga autori.

**Metodologji e kontrollit, verifikimit dhe përshtatjes strukturore**

PMI -ja propozon zgjidhje të problemeve konstruktive të ndërtesës:

- Infiltrime uji
- Probleme strukturale
- Çedime strukturale dhe ndërtimore
- Restaurimin e materialeve të thjeshta dhe materialeve të çmueshme, (me detyrimin që të ruhen origjinalet)
- Restaurimin e sistemeve të dritareve dhe dyerve duke tentuar të ruajë teknologjinë, materialet dhe mekanizmat e kohës së ndërtimit.

Për të aplikuar një menaxhim sa më të mirë e të përshtatshëm të ndërhyrjeve konsoliduese në Pallat, propozohet të ndiqet një metodologji e përcaktuar qartë. Ajo përcakton etapat e punës, që rekomandohet të ndiqen, për të realizuar kontrollin, verifikimin dhe përshtatjen strukturore të ndërtesave të Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave.

Kjo metodologji duhet të parashikojë kalimin në fazat e mëposhtme:

1. Trajtimin e normativave dhe standarteve:

Për kontrollin, verifikimin dhe përshtatjen strukturore të ndërtesave të Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave duhet të respektohen:

- Të gjithë ligjet, kodet, normativat dhe standardet e projektimit, zbatimit, supervizionit, kolaudimit, etj., të cilat janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe që rregullojnë të gjithë punimet e ndërtimit në vendin tonë.
- Të gjithë ligjet, kodet, normativat dhe standardet që lidhen me ruajtjen, restaurimin, etj. të objekteve historike dhe të monumenteve të kulturës, të cilët janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- Normativat evropiane të projektimit të veprave civile dhe industriale (Eurokodet).
- Çdo ligj, normativë, VKM, standard, etj., që është në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe që gjykohet i domosdoshëm për t'u përdorur nga projektuesi, zbatuesi, supervizori, kolauduesi, etj.

2. Trajtimin e dokumentaciont bazë referues

Për të realizuar kontrollin, verifikimin dhe përshtatjen strukturore të ndërtesave të Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave duhet të shfrytëzohet në maksimum dokumentacioni bazë referues, i cili përfshin:

- Projektet fillestare të ndërtesave të Ansamblit, ku përfshihet projekti arkitektonik, strukturor, mekanik, elektrik, hidrosanitar, etj.
- Projektet e çdo lloj ndërhyrjeje, përforcimi, modifikimi funksional e strukturor që mund t'i jenë bërë ndërtesave të Ansamblit, ku përfshihet projekti arkitektonik, strukturor, mekanik, elektrik, hidrosanitar, etj.
- Çdo lloj dokumentacioni teknik, historik, fotografik, filmik, që mund të gjykohet i nevojshëm për t'u përdorur nga projektuesi, zbatuesi, etj.

3. Trajtimin e nderhyrjeve strukturore të realizuara gjatë viteve

Kur shqyrtohen probleme të këtij lloji, përpara se të përcaktohen ndërhyrjet e konsolidimit, së pari duhet të identifikohen të gjitha ndërhyrjet e bëra deri në atë moment, duke u konsultuar me arkivat historike dhe traditën popullore, duke u përpjekur të kuptohet filozofia e tyre, duke qenë se ndërhyrje të reja jo në përputhje me ato të implementuara tashmë mund të mos sjellin efektet e dëshiruara dhe, në disa raste, madje të anullojnë efektivitetin e atyre që janë kryer më parë.

4. Rilevimi i gjendjes aktuale të ndërtesave

Përfshin rilevimin gjeometrik (përmasat e ambienteve në plan dhe në lartësi, kuotat, përcaktimi i pozicionit të dyerve, dritareve, përmasat e tyre, pozicionimi i shkallëve, etj.) të secilës prej ndërtesave të Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave.

5. Vëzhgimi vizual i gjendjes aktuale të strukturës së ndërtesave

Përfshin vëzhgimin e imtësishëm vizual të gjendjes së strukturës së ndërtesave të Ansamblit, për të evidentuar çarje, plasaritje, mënjanime, dëmtime, degradime, shembje të pjesshme, çedime, etj.

6. Provat e materialeve

Për të njohur sa më mirë gjendjen aktuale të strukturës duhet të kryhen prova apo teste te ndryshëm (me shkatërrim apo pa shkatërrim) të materialeve (beton, çelik, llaç, tullë), me qëllim përcaktimin e parametrave fiziko mekanikë të tyre.

7. Skaneri i strukturave betonarme

Në ato raste kur mungon projekti përkatës i strukturës, për të përcaktuar sasinë dhe diametrin e shufrave të çelikut brenda trupit të elementëve betonarme, duhet të kryhet skanerizimi i tyre, me ndihmën e pajisjeve përkatëse elektronike.

8. Studimi gjeologo inxhinierik

Për të përcaktuar parametrat fiziko - mekanikë të truallit duhet të kryhet studimi gjeologo- inxhinierik i tij. Ky studim, përveç të tjerave, do të përcaktojë praninë apo jo të rrafsheve të mundshëm të rrëshqitjes së shpateve të pjerrët të truallit.

9. Studimi inxhiniero - sizmologjik

Për të përcaktuar parametrat sizmikë të truallit duhet të kryhet studimi inxhiniero - sizmologjik i tij. Ky studim do të përcaktojë parametrat sizmikë të truallit shumë të domosdoshëm për kryerjen e llogaritjeve përkatëse analitike dhe njehsimin e saktë të forcave sizmike, të cilat veprojnë në strukturë gjatë lekundjeve të tërmetit.

10. Modelimi kompiuterik dhe llogaritjet analitike

Gjatë kësaj faze kryhet modelimi kompjuterik i secilës prej strukturave të ndërtesave të Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave. Kjo është një fazë shumë delikate dhe e rëndësishme. Për modelimin sa më të saktë dhe të plotë të strukturave shfrytëzohen të gjitha të dhënat e përftuara nga etapat e punës të përshkruara më lart.

11. Përcaktimi i nevojës apo jo të ndërhyrjeve përforcuese në strukturën e

ndërtesave të Ansamblit

Modelimi kompjuterik, llogaritjet analitike, rezultatet e përftuara dhe interpretimi i tyre do të tregojnë nëse struktura ka nevojë apo jo të përforcohet apo të përshtatet nga pikëpamja strukturore.

12. Identifikimi i ndërhyrjeve përforcuese më të përshtatshme

Nëse struktura ka nevojë të përforcohet apo të përshtatet nga pikëpamja strukturore, duke patur parasysh se Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave është një kompleks historik, inxhinieri i strukturës në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të grupit të punës, identifikon ndërhyrjet përforcuese në strukturë, me qëllim që të mos cënohet origjinaliteti dhe të ruhen maksimalisht vlerat historike të ndërtesave të Ansamblit.

13. Hartimi i projektit të perforcimeve strukturore

Pasi përcaktohen ndërhyrjet përforcuese në strukturë, pozicioni i tyre, materialet që do të përdoren, teknologjia dhe metodologjia e nevojshme që duhet respektuar, kalohet në hartimin e projektit përkatës.

14. Hartimi i preventivit të punimeve të përforcimeve strukturore

Projekti i strukturës gjithmonë shoqërohet me preventivin përkatës, i cili përfshin zërat e punës, volumet përkatëse, çmimet.

15. Hartimi i planit të punimeve të zbatimit

Metodologjia e kryerjes së tyre, percaktimi i afatit të kryerjes së punimeve, specifikimet teknike. Punimet ndërtimore për përforcimin dhe përshtatjen e strukturës (aty ku është e nevojshme), duke patur parasysh karakterin historik të Ansamblit, janë shumë delikate dhe komplekse. Për këtë arsye lind e domosdoshme të përcaktohet paraprakisht, pa filluar punimet, plani i kryerjes së punimeve, rradha e punës që duhet ndjekur, metodologjia që duhet implementuar, si edhe specifikimet e detajuara teknike për materialet e përdorura dhe proceset e punës që kryhen. Gjithashtu duhet të përpilohet grafiku i punimeve për të identifikuar ata procese pune që mund të kryhen njëkohësisht, sasinë e fuqisë punëtore, kohën e kryerjes së cdo procesi pune, kohëzgjatjen e tij, si edhe afatin e kryerjes së punimeve.

16. Zbatimi i punimeve

Punimet ndërtimore për përforcimin dhe përshtatjen e strukturës (aty ku është e nevojshme), duke patur parasysh karakterin historik të Ansamblit, janë shumë delikate dhe komplekse. Duhet të tregohet kujdes maksimal për të mos dëmtuar strukturën e ndërtesave. Duhet të respektohen me rigorozitet të gjitha kushtet teknike të zbatimit të punimeve ndërtimore, që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si edhe ligjet, normat, standardet e ruajtjes dhe restaurimit të ndërtesave historike dhe atyre që janë monument kulture.

**Metodologji e menaxhimit të pasurisë artistike të pallatit.**

Për të realizuar një plan menaxhimi sa më të përshtatshëm të pasurisë artistike të Pallatit e Parkut të tij, ky Plani Menaxhimi i Integruar propozon një metodologji e cila të marrë në konsideratë disa faza :

1. Aspekti studimor- dokumentues

Në këtë fazë parashikohet të klasifikohen të gjitha veprat e artit duke filluar nga mjediset e jashtme (skulptura, shatërvane, relieve, etj) dhe deri në ato të brendëshmet në inetrier. Këtu mund të përfshihen, piktura murale, piktura në telajo, dru apo suporte të tjera, skulptura, relieve, korrniza, apo objekte të tjera me vlerë. Klasifikimi sipas tipologjisë dhe skeda teknike me të dhënat dhe karakteristikat e sejcilit, është një dokument që duhet ti bashkëlidhet çdo objekti. Më pas sejcili prej tyre duhet të jetë subjekt i një databaze institucionale që gjithashtu duhet të jetë pjesë integrale e databazës qendrore të IKRTK-së.

2. Projektimi dhe ndërhyrjet restauruese

Njohja e mirë e veprave, teknikat artistike të realizimit, materialet e tyre përbërëse, dhe problematika të degradimit të materialit, do të jenë baza kryesore për hartimin e një projekti të restaurimit për secilën prej tyre. Projektet e restaurimit, ashtu sikurse çdo vepër e trashëgimisë kulturore materiale, diskutohen dhe aprovohen nga organet vendimmarrëse, për t'u implementuar më pas nga kompanitë e licencuara për ndërhyrje në veprat e artit.

3. Aspekti i administrimit të pasurisë artistike

Konservimi preventiv dhe mirëmbajtja është një nga aktivitetet thelbësore për ruajtjen e pasurive kulturore të luajtshme apo të paluajtshme. Një konservim i lirë parandalues, ngadalëson degradimin në kohë, shton distancën kohore ndërmjet ndërhyrjeve, ruan autenticitetin e veprës dhe kursen të ardhurat e institucionit administrues. Kjo vlen si për veprat pasuri kulturore të pozicionuara në eksterier, ashtu dhe ato të interierit.

4. Promovimi i pasurisë dhe intinerare artistike

Duke konsideruar kompleksin arkitektonik dhe peizazhistik të Pallatit të Brigadave, ideja e "shfrytëzimit" të Ansamblit si një qendër e vizitueshme, do ishte me interes të madh publik. Aktualisht, vetëm një pjesë e oborreve dhe kopshteve janë të vizitueshme.

Për të rritur vizitueshmërinë në Kompleksin e propozuar, promovimi i pasurisë artistike të Pallatit të Brigadave, është një aspekt i rëndëisishëm. Itineraret artistike të Ansamblit, mund të jenë pjesë e integruar e trashëgimisë së përgjithshmë artistike në Shqipëri gjatë viteve '30-40-të. Por nga ana tjetër vetë itineraret artistike të interierit dhe të eksterierit, mund të jenë të shkëputura nga konteksti i kohës duke ofruar ture të shkurtra tematike që lidhen me: emra piktorësh apo skulptorësh që njihen; vepra anonime apo të atribuara; shumëllojshmërinë e materialeve të përdorura në realizimet artistike; tematika mitologjike apo ato me karakter funerar të aplikuara në vepra; etj.

Për sigurimin e një vizitueshmërie sa më të përshtatshme për të gjitha grupet e interesuara, mbetet gjithmonë domosdoshmëria e një interpretimi të përshtatshëm i veprave dhe tureve duke siguruar:

1. Aksesibilitetin fizik
2. Guidat specifike për shkollat e të gjitha niveleve
3. Guida për grupe

4. Guida për persona me aftësi të veçanta fizike dhe shqisore

5. Guida për familjarë

6. Guida për profesionistë të fushës.

**Metodologji e ndërhyrjes dhe trajtimit të sistemit Elektrik**

Gjendja e sistemeve elektrike dhe elektronike është në përgjithësi e qëndrueshme. Karakteristikë e veçantë e objektit është fakti që kemi të bëjmë me instalime të rreth 80-90 viteve me parë dhe që mbartin vlera të mëdha historike edhe në fushën e inxhinierisë duke e bërë këtë objekt edhe një atraksion për të apasionuarit e teknikës, inxhinierët, studentët dhe kërkuesit shkencorë. Në këtë kuptim propozimi është që sistemet të ruhen siç janë, duke bërë ndërhyrje vetëm për sistemet e reja që parashikohet të instalohen si: automatizimi, sistemet audio, të sigurisë, etj. Ndërhyrje kërkohen edhe në disa instalime ekzistuese por duke i konsideruar si ndërhyrje restauruese të paisjeve që kanë nevojë për mirëmbajtje, riparime apo zëvendësime të disa pjesëve të tyre duke respektuar zgjidhjet origjinale.

Ndërhyrje të mirefillta kërkohet të bëhen për rikonstruksionin e sistemit të furnizimit (furnizimi me energji, gjeneratorët, ndriçimi i jashtëm) dhe elemente të tjerë sipas funksionaliteteve shtesë që do të parashikohen për të ardhmen

Në lidhje me metodologjinë e ndërhyrjes në sistemet elektrike të Pallatit Plani i Menaxhimit propozon:

1. Kontrollin dhe restaurimin e sistemeve të ndriçimit, fuqisë dhe sistemeve të tjera elektrike dhe elektronike, kur gjendja e tyre aktuale e lejon teknikisht restaurimin, duke ruajtur kriteret e sigurisë. Paisjen e tyre në çdo rast me sistemet e detektimit dhe lajmërimit të zjarrit (ËiFi).

2. Ndërtimin e një sistemi të sigurtë dhe të vijueshëm të furnizimit me energji elektrike, internet, telefoni dhe sinjal televiziv për të gjithë objektet.

3. Në objektet muzeale, në sallë ekspozimi apo në ambientet ku do të kërkohet ndërhyrje dhe ka kërkesa të veçanta për ndriçim, fuqi dhe sisteme kontrolli e monitorimi, do të propozohen zgjidhje smart, të cilat lejojnë një komunikim dhe monitorim në distancë të operatorëve me sistemet elektrike dhe elektronike.

**Metodologjia e ndërhyrjes në sisteme inxhinjerike mekanike dhe hidraulike**

1. Impianti i Ngrohjes Egzistues :

Ka qenë impiant ngrohje me radiator dhe me kaldajë me fluid termik avull dhe si i tillë ai funksionte pa pompë në sajë të energjisë së avullit dhe kthimt të kondesatit me vetërrjedheje.

Në ambjentet e brendeshme janë përdorur radiatore gize ( sipas kohës se tyre) të arreduar në mbulesa dekorative në përputhje më këto ambjente të brendshme. Pra është shmangur pamja e tyre direkte. Cetrali termik përbëhet nga grup kaldajash avulli. Nga pikëpamja fizike, ky impiant është korroduar në shkallënë më të

lartë. Nga pikëpamja e tipologjisë së sitemit, është jashtë normave të lejushme në lidhje me temperaturën e fluidit trasmetues (100 oC) ku duhet të jete më i ulët se 80 gradë celcuis. Nga nevojat e komfortit është një sistem që vetëm ngrohjen kishte ëe parashikushme për të plotësuar. Nga pikëpamja e arredimit të **brendshëm** me pajisjet ngrohëse, është një sistem i përkryer. Pikërrisht këtë detaj duhet ta shfrytëzojmë në sistemin e ri.

**Ajri freskët dhe ventilimi**

Mungon në përgjithësi koncepti i ventilimit mekanik d.m.th. nuk ka ventilim të ambientev , sallave etj, WC, kuzhinave, lavanderisë etj. Teknikat e kohës kanë qenë të kufizuara në këtë drejtim dhe për pasojë nuk përbënin normë projektimi dhe kompesoheshin nga lartësitë e mëdha të ambienteve të kombinuara me ajrosje natyrale nëpërmjet dritareve, sopraluçeve dhe të kolonave natyrale.

Kështu plani i menaxhimit propozon:

1. Centrali termik duhet të nxiret jashtë përdorimi dhe të lirojë ambjentin teknik.

2. Sistemi i tubacioneve duhet të hiqet dhe t’i lejë vendin sistemit të ri të tubacioneve.

3. Pajisjet radiatore (prej gize) duhet të hiqen për ti lënë vendin pajisjeve të reja ngrohje/ftohje.

4. Të plotësohet sistemi me ajër të fresket dhe ventilim.

Ndërhyrjet e propozuara duhet të ndërtojnë një sistem HVAC i cili të plotësojë këto kerkesa :

- Komfortin në dimër me temperaturën e kopfortit top- nevojë për ngrohje mjedisi

- Komfortin në stinën e Verës me temperaturën e kopfortit top – nevoja për ftohje mjedisi

- Komfortini ambiental për kualitetin e ajrit të brendshëm – nevoja për ajër të freskët dhe ventilues.

Duke pasur parasysh që përdorimi i kësaj godine të tipit ndërtesë për pritje apo hotel në përdorim jo të shpeshtë, është e nevojshme të shmanget mundësia e infektimit bakterial që vjen nga lagia prej kondesatit të këmbyesve të nxehtësisë dhe tubacionve.

Sistemi më i përshtatshëm që plotëson kërkesat e mësiperme dhe ruan parqitjen vizuale të brendeshme me mbulesat dekorative është:

Sistemi hidronik 2 - tubësh me fan coil që funksionojnë në “të thatë” me temperaturë furnizimi ne Vere >=10- 13 $C^o$ dhe ne dimer 40 $C^o$ , të cilët përballojnë ngarkesën sensible të brendeshme dhe shmangin kondesimin ne fan coil. Plotësimi i ngarkesës latente dhe kualitetit të ajrit të brendshëm si edhe ventilues, do të realizohet me pajisje me zgjerim të drejtpërdrejtë për ngrohje dhe ftohje të tij, dhe me rikuperim energjie ajër-ajër.

Për të bërë të mundur tipologjinë e mësipërme dhe duke pasur parasysh

vështirësitë që paraqet godina egzistuese, propozohet kjo zgjidhje:

**Ngrohja- ftohja**

Per katin përdhe, të parë, të dytë dhe -1 propozohet : Sistemi hidronik 2- tubësh me fan coil që funksionojnë në "të thatë " me temperaturë furnizimi në verë >10- 13 C$^o$ dhe në dimër 40 C$^o$, nëpërmjet pompave të nxehtësisë të vendoura në katin -1, në dhomën teknike me presion staik 100- 150 Pa për të flakur jashtë ajrin si burim energjetik.

**Ngrohja- ftohja e kombimuar me ajer te freskët dhe ventilim**

Per katin përdhe dhe -1 propozohet: Sistemi hidronik 2- tubësh me fan coil që funksionojnë në "të thatë " me temperaturë furnizimi në Verë >10- 13 C$^o$ dhe në Dimër 40 C$^o$, dhe një pajisje root top me rikuperatore ajri (> 65%) .

Ky sistem do të ketë 2 tubacione uji në tavanet e katit -1 që furnizon fan coilet e vendusur brenda në mbulesat egzistuese dekorative, dhe dy kanale ajri të lidhura me pajisjen roof top dhe të vendosura në tavanin e katit -1, për të furnizuar pranë fan coleve me ajër të freskët, e cila të jepet në mjedise me "Jet nozzles" dhe në fan colin në pozicion të kundërt. do të merret ajër për ventilim.

Për katin e parë dhe të dytë propozohet:

**1. Sistemi hidronik 2-tubësh**

Sistemi hidronik 2-tubësh me fan coil që funksionojnë në "të thatë" me temperaturë furnizimi në verë >10- 13 C$^o$ dhe në dimër 40 C$^o$ dhe një pajisje monobllok, rikuperative ajri me integrim të ciklit frigoriferik të vendosur në tarracën e brendeshme të katit të dytë, në anësoret e tij .

Ky sistem do të ketë 2 tubacione uji në tavanet e katit -1, që me tubat vertkial në kate që furnizojnë fan coil-et e vendusur brenda në mbulesat egzistuese dekorative, dhe dy kanale ajri të lidhura me pajisje monobllok, rikperative ajri me integrim të ciklit frigoriferik dhe të vendosura në tavanin e katit 2, për të furnizuar me dalje anësore në mure sipër me ajër të freskët dhe ventilim.

Për dhomat që ndodhen larg kësaj mundësie, mund të përdorin rikuperatorë individualë të vendosur në ballkone ose në zonën e dritarve e cila përcaktohet nga një analizë reale në godinë.

I gjithë sistemi HVAC duhet të jetë i shoqëruar me Building automation (BA) që përfshin me kontrollin e parametrave në çdo dhomë, të centralit termik, të pompave etj. Në programimin orar dhe javor të funksionimit, në vizualizimin e impianteve, me parametrat perkatës.

**2. Impianti i furnizimit me ujë të ftohtë/ngrohtë**

Ky system shfrytëzon presioni hidrostatik i rrjetit të furnizimit nga depoja e ujit që ndodhet në lartësi të kodrave (ku ndodhet edhe sot), dhe që shërben ende për furnizmin e zonës duke fuksionuar si enë komunikuese. Sidomos impianti i ujit të ngrohtë ka pësuar më shumë difekte dhe për pasojë edhe më shumë modifikime. Aktualisht në shumë ambiente furnizimi me ujë të ngrohtë nuk bëhet nga sistemi qendror por nga boilerat elektrik. Arsyeja kryesore e vendosjes së boilerave elektrik nuk qëndron vetëm në difektet e sistemit por edhe tek fakti i

funksionimit jo të përshtatshëm të sistemit tërësisht i centralizuar dhe për më tepër pa linjë qarkulllimi revers.

Degradimi dhe amortizimi 100% i këtij impianti është konkluzion evident i dukshëm dhe ndonëse ai "funksionon" (sepse në godinë ka ujë), ky impiant është jashtë përdorimit jo vetëm për sesi funksionon, por edhe se është shkaktari i fuqishëm i dëmtimeve të finiturës e të padukshme të strukturave e sidomos të strukturës beton/arme të godinës.

Për sa më lart Plani i Menaxhimit propozon:

Për furinizimimin me ujë të ftohtë sanitar, është i domosdoshëm krijimi i një akumoli ditor dhe qenia e një grupi pompimi inverter për të ralizuar presionin e duhur për funksionimin e grupeve të rubinetave, të lavamanëve, dusheve, bideve, banajve, etj në vlerën min 2 bar.

Për këtë pikëpamje duhet të rinovohet sistemi i grupeve të tipit klasik.

Duhet ndërtuar sistemi i ri i tubacineve të furnizimit me ujë të ftohtë sanitar me materiale, ose Inox, ose polishteror, ose PP për ujë sanitar që kalon në gjurmët e sistemit të vjetër ekzistues.

Për përgaritjen e ujit të ngrohtë sanitar duhet të parashikohet akumoli i ujit të ngrohtë me serpentinë ngrohëse për pompë nxehtësie + serpentinë për energji diellore termike + rezistencë elektrike për garanitim e një temperature rezevimi 60 $C^o$ që parandalon Lexhonelen. Dërgimi i ujit të ngrohtë sanitar duhet të jetë me një valvul përzirëse termostatike që të rregullojë temperaturën e furnizimit >=48$C^o$

Duhet ndërtuar sistemi i ri i tubacineve të furnizimit me ujë të ngrohtë sanitar me mateiale, ose Inox, ose polishteror, ose PP për ujë sanitar që kalon në gjurmët e sistemit të vjetër egzistues. Sistemi mund të jetë me tub riqakullimi me pompë riqakulluese dhe me valvula balancuese temperature riqakulluese. Ose mund të jetë me kabllim tip rychem, që ngroh direkt tubin furnizues të ujit të ngrohtë sanitar.

**3. Impianti i shkarkimit të nyjeve hidrosanitare,**

Të gjitha instalimet brenda tyre janë ndërtuar nën dysheme, mbi soletën e dyshemesë duke aplikuar dysheme "tip govate". Hidroizolimi është realizuar me fletë plumbi të salduar, ndërsa kolonat vertikale të aplikuara me materiale gize janë të fshehura në puse vertikale të murosura. Ndërsa shkarkimet e ambienteve të shërbimit si kuzhina, lavanteria dhe nyjet h/sanitare të ndodhura në katin gjysmë nëntokë janë sistemuar në dyshemenë e katit në kanale dhe puseta kontrolli të parashikuara në soletën e dyshemesë.

Si konkluzion për sistemin e shkarkimeve të ujërave mund të themi se pavarësisht lokalizimit dhe fragmentarizimit të defekteve dhe pavarësisht funksionimit të pjesshëm të tij, këto sisteme janë drejt amortizimit dhe degradimit total të tyre. Pra problemi nuk mund të trajtohet në mënyrë të pjesshme dhe selektive, gjëndja tregon që sistemet e shkarkimit kanë hyrë në fazën e amortizimit dhe degradimit 100% të tyre.

Sipas analizës së mësipërme ky sistem duhet të ruhet siç është projektuar, vetëm të riparohet qoftë dhe me zëvendësim të pjesëve që nuk janë në standardin e duhur .

**4. Impianti i mbrojtjes kundra zjarrit**

Në godinën e pallatit që në fillim në projektin mekanik nuk ka qenë parashikuar impianti i mbrojtjes kundra zjarrit dhe sot ky impiant mungon.

Impianti hidrik i zjarrit duhet të ribëhet i ri në përputhje me normat e sotme të MNZ-e

Ky sistem prashikohet të jetë i tipit me hidrante e cila kërkon:

- Rezervim uji për mbrojtje zjarri në ambjentin teknik
- Grup pompimi me emergji rezrve nge ajo elektrike ne ambjentin teknik
- Linje tubacioni të presuara me ujë
- Hidrante në kate, sipas normës së zonës së funksionimit dhe nr. të kolonave vertikale.

**Metodologji e ndërhyrjeve në park**

Parku i Pallatit të Brigadave është i mirëmbajtur periodikisht. Falë kësaj mirëmbajtjeje ai arrin sot në një gjendje mesatarisht të mirë. Plani i menaxhimit do të parashikojë risistemimin e tij, për ti kthyer në gjendjen e formën e parashikuar në projektin fillestar e duke e përmirësuar atë me funksione dhe elemente atraktive shtesë. Kjo duhet të arrihet pas një studimi të kujdesshëm, duke ju referuar materialeve arkivore, si dhe fotografive të kohës së ndërtimit e duke përcaktuar brenda parkut dy nivele:

1. **Zonat që i nënshtrohen një mirëmbajtjeje të vazhdueshme dhe konstante**, **por jo të mjaftueshme për konservimin dhe vlerësimin e zonës** (këtu përfshihen: zona e hyrjes, rrugët hyrëse, esedra monumentale, zona përreth vilës, tarraca, platea e Vashës dhe platea e madhe, serrat, aerodromi, rruga me leandra, fusha me esedrën gjysëmrrethore dhe vaskën shatërvan, kishëza, rotonda, liqenet).

2. **Zonat që i nënshtrohen një mirëmbajtjeje kontrolli, jo të vazhdueshme dhe të pamjaftueshme** (mungesë krasitjeje, tharje, dredhëza mbi trungje, probleme ajrimi, vegjetacion infektues), ku përfshihen zonat e tjera të mbetura të parkut.

**Ndërhyrjet në park**

Ndërhyrjet që propozohen kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e pjesës dekorative të parkut si dhe me pjesën e pyllit e cila momentalisht është lënë në zhvillim spontan. Duke qenë se Parku i Pallatit të Brigadave do të kthehet një zonë të aksesueshme nga vizitorët propozojmë:

**1.** Të vendosen shigjeta orientuese dhe dalluese për të gjitha zonat e Parkut, sidomos duke evidentuar itinerare specifike.

2. Propozojmë vendosjen e etiketave të bimësisë në gjuhën latine dhe shqipe dhe në këtë mënyrë parku mund të shërbejë edhe si kopësht botanik nga pikëpamja shkencore dhe didaktike.

Ajo çka është më e rëndësishmja, është pritshmëria që Plani i Menaxhimit të konsiderohet si një mjet pune dhe dokument udhëzues për Komitetin e Menaxhimit të zonës së mbrojtur dhe që plani t'i vihet në dispozicion publikut dhe të jetë i aksesueshëm për të gjitha autoritetet, aktorët kryesorë të interesuar dhe përdoruesit në zonë.

**Nëpërmjet menaxhimit të Parkut presim të sigurojmë:**

1. Bashkekzistencën e mbrojtjes së cilësisë së lartë të natyrës dhe zhvillimit të formave të ndryshme të turizmit dhe aktiviteteve rekreative;
2. Ndërtimin e shtigjeve, informimin e mirë dhe guidat për shëtitje në natyrë të cilat do të mbështetin dhe promovojnë ekoturizmin dhe sigurimin e burimeve për të ardhurat lokale.

**Promovimi i kërkimit shkencor në zonën e Parkut duhet të sigurojë:**

1. Kryeerjen e studimeve dhe vlerësime të ndryshme të ekosistemeve tokësore, baseneve ujore me përfshirjen në projekte në nivele lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë;

2. Zbatimin e praktikave edukuese dhe profesionale që lidhen me turizmin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura, duke përfshirë ekskursionet për shkollat lokale brenda zonës së mbrojtur.

Plani i menaxhimit propozon që Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave të kthehet në një hapësirë të vizitueshme për publikun. Nëpërmjet kësaj do të arrihet vënia në shfrytëzim e tij për vizita njohëse, për aktivitete ceremoniale apo dhe për pritje shtetërore ose private. Në të gjitha këto funksione, Parku i pallatit do të luajë një rol të rëndësishëm.

**Plani i Menaxhimit propozon**:

**1. Të krijohet harta e parkut me pikat e interesit**

Në skemën kompozicionale të parkut, spjegohen konceptet dhe parimet e huazuara nga arkitektura e parqeve të tipit francez apo të tipit anglez dhe Italian. Një itinerar i përcaktuar shoqëron vizitorin në hapësirat e tij, duke i dhënë mundësi ta perceptojë atë nga pika të ndryshme shikimi.

**2. Të krijohet harta e veprave të artit, skulpturave**

Nje itinerar i përcaktuar në hartë do të mund të drejtojë vizitorin si në një guidë turistike, përmes hapësirave ku do të gjejë veprat e artit, skulpturat dhe shatërvanët. Në secilën prej tyre do të shpjegohet alegoria artistike që mbart, duke i kthyer si fragmente të një narracioni në natyrë.

**3. Të krijohen ambjente të përshtatshme për pushim të vizitorëve**

Në hapësirat e parkut gjendet mundësia për të ndërtuar përmes strukturave të lehta të mobilimit urban, vënde për shplodhje. Vendosja e tyre duhet të studiohet për të gjetur

hapësirën më të përshtatshme për një aktivitet të dyfishtë, qëndrim shplodhje dhe pasurim me informacion. Thënë kështu këto pika shplodhje duhet të vendosen në pikat prej të cilave të mund të perceptohet një pamje e veçantë informuese e parkut, apo veprave të artit, apo edhe të vetë ndërtesës.

4. **Të krijohet Guida AudioVizuale në shërbim të vizitorëve**

Materiale fotografike të arkivave dhe fotografi të kohës së sotme, sigurisht pas restaurimit, do të bëhen pjesë e një guide arkitektonike që duhet të shoqërojë vizitorin gjatë vizitës në pallat dhe gjatë vizitës në park.

5. **Të krijohet laboratori i bimëve dekorative.**

Në hapësirat e parkut, të cilat duhet të jenë të lulëzuara në çdo kohë, mund të krijohet mundësia e eksperimentimit të tipeve të ndryshme të luleve në përshtatje me stinët e vitit, diellëzimin apo hijen, lagështirën apo tokën e thatë. Këto kushte krijojnë mundësinë perfekte të krijimit të një laboratori të bimëve dekorative, në të cilin botanistë e arkitektë të parkut të eksperimentojnë, projektojnë, planifikojnë e aplikojnë bimë nga më të ndryshmet, duke e kthyer si një kopësht botanik dhe një vend eksperience për studentët, botanistët apo arkitektët e pejzazhit.

6. Plani i menaxhimit rekomandon edhe **Konceptin e sistemit automatik te guidës audio vizive.**
7. **Realizimi i një masterplani të parkut** ku do mund të studiohen elementë të veçantë bashkëkohore rekreativë dhe shërbimi në hapësirë të hapur të cilat do të tërheqin vizitorët dhe do të shërbejnë si burime të qëndrueshme ekonomikë për AHPB. Ato duhet të jenë në përputhje të plotë me sistemin e përgjithshëm të Parkut.



# 4.0 VLERËSIMI VLERAVE TË MONUMENTIT

# 4.0 VLERËSIMI I VLERAVE TË MONUMENTIT

Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave është një sit i jashtëzakonshëm i trashëgimisë kulturore në qytetin e Tiranës, frut i arkitekturës së mrekullueshme të viteve 1930-40.

Ligji nr. 93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, mundëson kthimin në një destinacion turistik të Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave, në pëputhje me "Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023 dhe të Planit të Veprimit", miratuar me VKM nr. 413, datë 19.6.2019.

Çdo ndërhyrje e planifikuar duhet t'i nënshtrohet paraprakisht procesit të VNM-së, duke qenë se janë objekt i ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".

# 5.0 ASPEKTE TË LIDHURA ME PASURINË



# 5.0 ASPEKTE TË LIDHURA ME PASURINË

## Influenca në komunitetit, edukimi dhe trajnimi

AHPB-ja është nën juridiksionin administrativ të Bashkisë Tiranë.

Pranë këtij kompleksi ndodhet një zonë banimi mesatarisht e dendur.

Aktualisht banorët e zonës nuk janë të innteresuar për Pallatin dhe parkun e tij, duke qenë se pak vetë e dinë se ai është i aksesueshëm lirshëm në fundjava, dhe përmes kërkesave dhe rezervimeve edhe në ditë te tjera.

Duke qenë krejt pranë kompeksit, kjo zonë ka mundësi të ketë një impakt pozitiv nga zhvillimi turistik i tij. Përveç punësimit si një mundësi direkte, banorët e zonës do të mund të përfitojnë edhe nga rritja ekoomike që do të shoqërojë zonën rretheqark pallatit, si një zonë apo pol i fuqishëm turistik qe do të kthehet, në bazë të një menaxhimi të mirë financiar.

Ndërkohë në Tiranë, gjenden Universitete që në programet e tyre të studimit përgatisin studentë e specialistë në fusha të lidhura me vlerat arkitektonike të pallatit dhe Parkut të tij. Përmendim këtu fakultete të arkitekturës, inxhinjerisë së pyjeve, pikturës e skulpturës, inxhinjerisë tekstile, dhe deri një program master në landscape apo në arkitekturë të parkut.

Të gjithë këto specialistë do të mund të kenë ekperienca të veçanta profesionale në ambjentet e Pallatit dhe të Parkut, dhe të zhvillojnë praktika mësimore apo didaktike në to.

## Turizmi dhe infrastruktura

Ansambli Historik i Pallatit të Brigadave menaxhohet nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, e cila duke qenë një institucion me vetëfinancim, nëpërmjet objekteve që administron, arrin të grumbullojë të ardhura në buxhetin e institucionit ku lëshimi i objekteve me qira për subjektet publike dhe private si dhe organizimi ai eventeve të ndryshme sipas kërkesës janë burimet kryesore të këtyre të ardhurave.

Sipas VKM-së nr. 25 datë 29.03.2019, për të gjithë personat mund të ofrohen ture të Pallatit të Brigadave për ambientet e jashtme ose të brendshme sipas një kuote pagese për ata të cilët duan të zhvillojnë këtë vizitë. Paraprakisht personat të cilët duan të kryejnë këtë shërbim duhet të paraqesin kërkesën pranë DSHQ-së, ku me pas do të kërkohet të kryehet pagesa në bankë përpara zhvillimit të turit.

Gjatë fundjavës, parku i Pallatit të Brigadave është i lirë për t'u vizituar nga të gjithë ata të cilët dëshirojnë, pa pagesë. Gjatë periudhës së Verës, Pranverës dhe ditëve të ngrohta të Vjeshtës, në parkun e Pallatit të Brigadave gjendet edhe një

banak i cili është i hapur për të ofruar pije të ndryshme në mënyrë që vizitorët të shijojnë natyrën ndërkohë që edhe pushojnë. Sigurisht ky bar ofron pije kundrejt pagesës përkatëse të cilat kontribuojnë në buxhetin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare duke qenë një institucion me vetëfinancim. Ambientet e brendshme të Pallatit të Brigadave nuk janë të hapura për t'u vizituar gjatë fundjavës për arsye të sigurisë për këto ambiente si dhe orendive me vlerë që gjenden në to.

Gjithashtu lejohen vizitorë në rastin e përgatitjes së një seti fotografik për dasmë. Të intersuarit bëjnë një kërkesë në zyrën e Protokollit të DSHQ-së dhe kundrejt pagesës mund të lejohen të hyjnë në territoret e pallatit. Numri i lejueshëm i personave brenda kësaj pagese është 10 persona. Këto shërbime nuk përfshijnë ambientet e brendshme të Pallatit të cilat nuk lejohet të fotografohen dhe të bëhen subjek fotografike për shkak të rëndësisë së objektit dhe sendeve me vlerë që ndodhen në të, të cilës i përkasin rëndësisë së veçantë dhe janë të ruajtuara sipas protokolleve përkatëse.

Duke parë këtë mënyrë të ofrimit të vizitave për publikun, kuptohet se Pallati i Brigadave kane një vizitueshmëri të ulët e të pamjaftueshme për të siguruar një të ardhur të mirë që të mund të financojë mirëmbajtjen, konservimin dhe restaurimin e tij.

Nga këto politika të deritanishme të menaxhuesve të Pallatit të Brigadave, kuptohet së publiku i gjërë është thuajse i përjashtur nga mundësia për të vizituar pallatin në brendësi, dhe vetëm në 3 vitet e fundit, ka akses të kufizuar në parkun e tij. Përmendim që edhe në park një pjesë e zonave të tij, janë kufizuar me rrethime të përkohshme në mënyrë që të ndalohet hyrja në disa zona.

Ndërkohë në lidhje meinfrastrukturën vihet re mungesa e parkimit për vizitorë, mungesa e tabelave indikuese të lëvizjes, mungesa e amjenteve të shërbimit për vizitorët, mungesa e kujdesit ndaj shmangjes së barrierave arkitektonike për persona me aftësi të kufizuara.

## Analiza SWOT

| ***Pikat e forta*** | ***Pikat e dobëta*** |
|---|---|
| • Një pasuri kulturore unike e përbërë nga ndërtesa arkitektonike dhe park natyror.<br>• Shembulli i vetëm në Shqipëri, i ngjashëm me pallatët mbretërorë në botë, i ruajtur në gjëndje të mirë.<br>• Vendodhja në një pozicion strategjik në kryeqytet.<br>• Aksesi në Pallatin e Brigadave është relativisht i lehtë.<br>• Afërsia me parkun e Liqenit artificial i jep mundësinë të ndihmojë ruajtjen e ekosistemit të parkut të vet.<br>• Pasuria artistike e veprave të interierit, (mobilje, tapiceri, ndriçues, artifakte)<br>• Pasuria artistike e parkut dhe e elementeve dekorative që ndodhen në të.<br>• Vjetërsia e parkut i jep pamjen e një | • Varësi dyfishe midis Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe Ministrisë së Kulturës.<br>• Nevoja urgjente për restaurim e konservim<br>• Fonde të limituara për restaurim e konservim<br>• Mungesa e përvojës, kapaciteteve për rijetëzim.<br>• Mungesa e funksioneve rekreative në park dhe pallat.<br>• Mungesa e brandimit të pasurisë kulturore e arkitektonike të Pallatit dhe Parkut.<br>• Mungesa e një faqe ëeb të pallatit e Ansamblit.<br>• Vendnodhja e godinave të Gardës së Shqipërisë, brenda territorit të parkut, |

| | |
|---|---|
| pylli të konsoliduar tashmë, duke i rritur vlerat pamore dhe duke siguruar një mikroklimë optimale ambjentale.<br>• Parku është i paprekur dhe në gjendje natyrore.<br>• Ekzstenca e ambjenteve akomoduese në katin 1 dhe katin 2, që mund të rishfrytëzohen për të ruajtur karakterin e funksionit fillestar që ka patur pallati, atë të pritjes.<br>• Ekzistenca e ambjenteve me sipërfaqe të mëdha në interier, që mund të destinohen për aktivitete artistike.<br>• Relievi i parkut i ndryshëm e me kuota të ndryshme, krijon mundësinë të ndërtohen godina të tipit ipogjee për të akomoduar në to funksione shtesë. | zvogëlon sipërfaqen e shfrytëzueshhme të tij.<br>• Mungesa e një parkimi për vizitorët në brendësi të parkut.<br>• Mungesa e një parkimi publik jashtë rrethimit të Ansamblit.<br>• Mungesa e ndriçimit të parkut dhe ambjenteve kryesore të tij.<br>• Mungesa e mirëmbajtjes së bimësisë së parkut, mund të sjellë si pasojë eleminimin e disa pemëve të vjetra, gjë e cila do të sjelle prishjen panoramike për gjatë disa viteve të para.<br>• Pandemia ka ulur numrin e aktiviteteve rikrijuese dhe artistike. |
| ***Mundësitë*** | ***Rreziqet*** |
| • Kërkesa për zgjerim të aktivitetit turistik në kryeqytet mund të rrisë numrin e vizitorëve në Pallat.<br>• Nevoja e Tiranës për hapësira shtesë rekreative dhe artisike.<br>• Krijimi i funksioneve të reja të propozuara nga plani i menaxhimit do të rrisë frekuentimin e Pallatit dhe Parkut të tij<br>• Interesi i ndërmarrjeve turistike e kulturore për të investuar në turizëm.<br>• Mungesa e informacionit për pallatin dhe mos lejimi i vizitorëve në brendësi, ka ruajtur "misterin e Ansamblit", gje që do të sjelle interesim të madh në fillimet e aplikimit të planit të menaxhimit, duke sjellë rrije të të ardhurave<br>• Pasuria e kopshtit botanik do të ndihmojë afrimin e specialistëve botanistë dhe që të planifikojnë më tej ndërhyrjet e specializuara në park | • Degradimi i monumetit mund të shkaktojë dëme të pariparueshme të vlerave të monumentit.<br>• Menaxhimi i AHPB-së nga DSHQ-ja, (një institucion jo në varësi të Ministrisë së Kulturës), mund të ndikojë në zbatimin dhe respektimin e parimeve të ruajtjes së monumentit të kulturës. DSHQ-ja nuk ka specialistë të trashëgimisë kulturore si pjesë të stafit.<br>• Interes i limituar për aktivitete rikrijuese dhe kulturore.<br>• Fondet e limituara si shtetërore dhe private, mund të rrezikojnë financimin e projekteve restauruese dhe rijetëzuese për AHPB-në.<br>• Mungesa e ekspertizës për restaurim cilësor të momumentit, mobiljeve dhe të tjera aseteve që ka AHPB-ja. |

Në vijim të këtij SWOT-i, për qëllimin e që ky ansambël të hapet për vizitorë shqiptarë dhe të huaj, të restaurohet e të marrë funksione të reja, në harmoni me misionin e ruajtjes së tij, dhe të shndërrohet në një destinacion të paevitueshëm të Tiranës , propozohet:

**Rijetëzimi i AHPB-së në një destinacion elitar** ndërkohë që Pallati ruan funksionet e tij aktuale. Është e nevojshme të sqarohet se termi rijetëzim në këtë kontekt, nuk i referohet përdorimit që ka në Ligjin Nr.27, Datë.17.05.2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë", por kuptimit primar që ka në literaturën e trashëgimisë kulturore, "plotësimi i një diçkaje me jetë dhe veprimtari të reja":

- AHPB-ja vazhdon të ruajë funksionin e tij zyrtar dhe të pazëvendësueshëm

në Shqipëri si një vend për pritje dhe ceremoni shtetërore.

- AHPB-ja zhvillon vizitueshmërinë e tij duke u shndërruar në destinacion elitar, i krahasueshëm me Pallatet Mbretërore në kryeqytete të ngjashme. Për t'u arritur ky qëllim, AHPB ka nevojë të restaurohet, të pregatisë të paktën një tur të brendshëm të pallatit, një tur të kopshteve dhe të ketë një sallë për ekspozita tematike. Detaje të mëtejshme do të paraqiten se si do të arrihet kjo pikë e rijetëzimit.
- AHPB-ja lejon dhe mundëson zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe rikrijuese si në mjediset e brendshme dhe të jashtme, kundrejt tarifave të rishikuara dhe të miratuara, të cilat mund të organizohen nga organizata të tjera qeveritare, ente publike dhe private, organizata jo-fitimprurëse, kompani ose individë. Numri i pjesëmarrësve dhe llojet e aktiviteteve, duhet të jenë të tilla që të mos prekin integritetin fizik të AHPB-së, florën e kopshteve të AHPB-së dhe sidomos imazhin e AHPB-së si një destinacion elitar. Të tilla aktivitete mund të jenë, ekspozita, simpoziume, aktivitete kulturore (shfaqje teatrale me një numër të përcaktuar pjesëmarrësish), xhirime të filmave artistikë, sfilata apo dhe koncerte.
- AHPB-ja mundëson dhe lejon organizimin e aktiviteteve edukative-didaktike, kundrejt tarifave të rishikuara dhe të miratuara (mund të ketë dhe raste shumë të rralla që përjashtohen nga tarifimi), të tilla si studime të AHPB-së dhe kopshtit të tij, kërkime shkencore të cilat rrisin njohuritë mbi AHPB-në etj.
- AHPB mundëson dhe lejon mikëpritjen për një përiudhë të shkurtër disa ditore të personaliteteve, shqiptarë apo të huaj të ftuar nga Qeveria Shqiptare apo nga institucione të rëndësishme shtetërore. Duke patur parasysh që mikpritja është një shërbim që ka nevojë për shumë kushte specifike, ky nuk është një rekomandim parësor për rijetëzimin e AHPB-së.
- AHPB-ja zhvillon hapësirën natyrore që ka, Parkun e AHPB-së dhe në varësi të interesit të partnerëve të ndryshëm, mund të ofrojë shërbime për vizitorët aty (kafene apo brasserie me impakt minimal në mjedis).

Forma të tjera të përdorimit të AHPB-së, të paparashikuara në këtë dokument, mund të lejohen si pjesë e rijetëzimit të AHPB-së, vetëm nëse, pas shqyrtimit të tyre, sigurohet që nuk preket integriteti fizik dhe reputacional i AHPB-së.

## Funksione në shërbim të vizitorëve

Plani i Menaxhimit propozon funkionet, të cilat ilustrohen në pjesën e shtojcave edhe me vendodhjen e tyre.

- Krijimin e **një faqe Web** dhe biletarie elektronike për të menaxhuar oraret dhe flukset e publikut nëpërmjet vizitave të programuara.
- Të **hapet parku dhe pallati** ndaj publikut të gjërë për të ofruar vizita të përditshme si në ambjentet e interierit të Pallatit, edhe në parkun e tij. Për të shmangur mbipopullimin që do të ishte dëmtues për këto vlera të trashëgimisë kulturore, vizitat duhet të programohen në

përshtatje me nje strategji të menaxhimit të vizitorëve.

- Përcaktimi i një vendi për **parkim** dhe i një qendre për pritje të vizitorëve, e cila ti ofrojë informacionin orientues si dhe shërbime të ndryshme.
- Organizimi i një hyrje sekondare për Gardën duke lënë hyrjen kryesore vetëm për vizitorët.
- Largimin e **zyrave të gardës**, nga ndërtesa 17 dhe 18 (ndërtesa e administratës dhe ajo e qendrës shëndetësore) në anën jugore të hyrjes. këto objekte duhet t'i shërbejnë administrimit të pallatit të brigadave, duke ofruar zyrat për punonjësit e administratës dhe ambjente pritëse për vizitorët.
- Ndërtimin e një **rrethimi që të kufizojë** qartasi territorin në përkatësi të Pallatit dhe Ansamblit të tij.
- Projektimi e zbatimi i nje **rrjeti ndriçimi** edhe për parkun, i vlefshëm për të shfrytëzuar atë edhe në orët e natës.
- Projektimi dhe vendosja e një **sistemi të sigurisë me kamera** monitorimi dhe të sigurisë për pallatin dhe për parkun e ambjentet dhe strukturat brenda tij.
- Vendosja e një sistemi të hidranteve për shuarje zjarri në të gjithë ambjentet e parkut, për të shmangur djegjen e tij në periudha të nxehta.
- Krijimi i **hartës së pallatit** me ndarjet sipas mjediseve të vizitueshme, me shpjeguesin e funksioneve në kohën e ndërtimit. Duke njohur, hulumtuar e kuptuar më mirë kompozimin planimetrik si dhe ambjentet dhe funksionet origjinale të Pallatit, duhet të propozohet harta e pallatit e cila në mënyrë eksplicite të drejtojë vizitorin në ambjentet e tij, duke i prezantuar atij frymën arkitektonike e mbretërore të kohës kur u ndërtua.
- Krijimin e **hartës së parkut** me pikat e interesit. Në skemën kompozicionale të parkut, shpjegohen konceptet e parimet e huazuara nga arkitektura e parqeve të tipit francez apo të tipit anglez e Italian. Një **itinerar** i përcaktuar shoqëron vizitorin në hapësirat e tij, duke i dhënë mundësi ta perceptojë atë nga pika të ndryshme shikimi.
- Krijimi i **hartës së veprave të artit**, skulpturave. Nje **itinerar** i përcaktuar në hartë do të mund të drejtojë vizitorin si në një guidë turistike, përmes hapësirave ku do të gjejë veprat e artit, skulpturat dhe shatërvanët. Në secilën prej tyre do të shpjegohet alegoria artistike që mbart, duke i kthyer si fragmente të një narracioni në natyrë.
- Krijohen ambjente të përshtatshme për **pushim të vizitorëve**. Në hapësirat e parkut gjendet mundësia për të ndërtuar përmes strukturave të lehta të mobilimit urban, vende për çlodhje. Vendosja e tyre duhet të studiohet për të gjetur hapësirën më të përshtatshme për një aktivitet të dyfishtë, qëndrim shplodhje dhe pasurim me

informacion. Thënë kështu këto pika shplodhje duhet të vendosen në pikat prej të cilave të mund të perceptohet një pamje e vecantë informuese e parkut, apo veprave të artit, apo edhe të vetë ndërtesës.

- Krijohet **Guida AudioVizuale** në shërbim të vizitorëve. Materiale fotografike të arkivave dhe fotografi të kohës së sotme, sigurisht pas restaurimit, do të bëhen pjesë e një guide arkitektonike që duhet të shoqërojë vizitorin gjatë vizitës në pallat dhe gjatë vizitës në park.

Plani i Menaxhimit, rekomandon të largohen zyrat e gardës nga territori i Palllatit dhe këto ambjente të vendosen në shërbim të strukturës menaxhuese të pallatit.

**Menaxhimi i qëndrueshëm**

Rijetëzimi dhe shfrytëzimi i Pallatit të Brigadave dhe parkut të tij, me të gjithë pasuritë materiale, arkitektonike artistike që përfshijnë, duhet të bëhet nëpërmjet një menaxhimi të qëndrueshëm, i cili do të sigurojë që të adhurat nga aktivitetet e bëra në ambjentet e tij, të mund të gjenerojnë dhe të mund të financojnë mirëmbajtjen, konservimin dhe ndërhyrjet restauruese të bëra në të.

Për këtë qëllim strategjikisht Plani i Menaxhimit propozon, një seri aktivitetesh që mund të organizohen dhe krijimin e ambienteve funksionalë për ti realizuar ato:

1. Vizita të Pallatit, kishës, strukturave ndihmëse dhe parkut, me vlerat që ai ka.
2. Evente të rëndësishme shtetërore dhe private në nivel kombëtar e ndërkombëtar.
3. Salla ekspozite të përhershme dhe përkohshme.
4. Sallë konference ipogjee në pallat dhe në park (hapësira rekreative apo ceremoniale).
5. Struktura akomoduese për personalitete dhe shoqërues të tyre.
6. Struktura të qëndrueshme rekreative në park.
7. Struktura shkencore didaktike në funksion të sistemeve të ndryshme inxhinjerike dhe arkitektonike të periudhës.
8. Struktura menaxhimi që përfshijnë që nga parkimi, biletaria, zyra etj, në funksion të pikave të lartpërmendura. Në lidhje me sa më sipër, Plani i menaxhimit propozon që nëpërmjet politikave që do të ndjekë struktura menaxhuese të arrihet:
9. Përfshirja e komunitetit profesionist të fushës dhe të specializuar në proceset e restaurimit të vlerave arkitektonike, artistike, të interierit dhe të parkut.
10. Krijimi i qendrës studimore e të restaurimit të elementeve të arredimit të interierit, të specializuar në stilistikën e periudhës së modernizmit të fillim viteve 1900 në shqipëri (mobilje, elemente të tekstilit, elemente të arredimit, ndricues, etj)
11. Krijimi i qendrës së mësimit praktik të menaxhimit biologjik si edhe Landscape të parkut e të gjelbërimit në të.
12. Kthimi i parkut në një ambjent ku mësohet përmes praktikës mbi bimët dekorative, lulet, ngjyrat dhe ritmin biologjik të tyre, si dhe vënien e tyre në funksion të bukurisë së parkut.

13. Krijimi i programeve edukuese- didaktike për fëmijë, në funksion të njohjes së vlerave pejsazhistike të parkut dhe aplikimit në parcela të vogla eksperimentale, nën drejtimin e kopshtarëve të specializuar, dhe më pas aplikimi i njohurive të të fituara në pjesë të tjera të parku
14. Ofrimi i kurseve trajnuese të specializuara me disa nivele në arkitekture parku, ne kopshtari, mbjellje e kujdesje për lulet, në konservim e restaurim mobiljesh.



# 6.0 VIZIONI, QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

## 6.0 VIZIONI, QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Pallati i Brigadave dhe parku përreth tij do të rijetëzohen duke i dhënë funksione të cilat nuk do të cënojnë vlerat historike, arkitektonike e ambientale të monumentit, por do ta kthejnë atë në një pikë atraktive turistike në rajonin e Tiranës. Nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm ai do të arrijë të gjenerojë të ardhura për të siguruar vazhdueshmërinë e ruajtjes konservimit dhe restaurimit të vlerave të tij.

Ai do të kthehet në një destinacion elitar, i denjë për objektivin për të cilën është ndërtuar, që mirëpret miq të shtetit shqiptar dhe dinjitarë të huaj, që iu ofron vizitorëve një përvojë të rrallë dhe unike, e që gjeneron interes publik dhe siguron të ardhura për vazhdimësinë e tij.

Kjo do të arrihet duke realizuar këto objektiva:

1. Të restaurohet Pallati i Brigadave dhe të përgatitet plani për konservim të monumentit
2. Të rijetëzohet AHPB-ja duke ruajtur barazinë/drejtpeshën midis ruajtjes së vlerave të monumentit dhe zhvillimit turistik të pallatit.
3. Të përcaktohet qartë mënyra e manaxhimit të Pallatit të Brigadave për të garantuar ruajtjen dhe zhvillimin e monumentit/sitit.

### Synimet dhe objektivat

Për të ruajtur e përmbushur këtë Vizion mbi Pallatin e Brigadave dhe parkun e tij, Plani i Menaxhimit propozon përmbushjen e qëllimeve e objektivave, sipas kategorive të mëposhtme.

### Pallati, vlera arkitektonike dhe artistike

- **Qëllimi: Konservimi dhe restaurimi i vlerave artistike dhe arkitektonike, duke patur prioritet ruajtjen e vlerave të kësaj pasurie të veçantë të Trashëgimisë Kulturore të Shqipërisë.**
  - Restaurimi i pallatit pas evidentimit dhe eliminimit të problemeve të degradimit dhe arsyeve që i kanë shkaktuar ato.
  - Përcaktimin e ndërhyrjeve të lejuara në përputhje me vlerat e monumentit.
  - Restaurim emergjent
  - Restaurimi e konsolidimi i problemeve të çedimit apo çarjeve strukturale,
  - Eliminimi i problemeve të infiltrimit të ujit
  - Restaurimi i rifiniturave,
  - Restaurimi i elementeve dekorative dhe veprave të artit në interier,
  - Restaurimi i dyerve dhe dritareve origjinale
  - Restaurim i mobilieve, elementëve të arredimit.
  - Konservimi preventiv dhe mirëmbajtja në vazhdueshmëri i elementeve në inetrier: mobilje, ndriçues, artefakte, elemente tekstili, piktura, bazorelieve, dekoracione dhe rifinitura arkitektonike
  - Konservimi i mbulesave dekorative të paisjeve ngrohëse për t’u ripërdorur në sistemin e ri të klimatizimit me paisjet fan-coil.

- **Qëllimi: Katalogimi i të gjithë vlerave artistike të interierit duke krijuar një databaze që do të shërbejë për konservimin e restaurimin në vazhdimësi.**
    - Krijimi i databazes së: Mobilje, ndriçues, artefakte, relieve, skulptura, piktura, elemente tekstile.
    - Menaxhimi i databazave në funksion të publikut dhe informacionit didaktik të specialistëve të fushave parkatëse.

## Parku, vlera peizazhistike dhe artistike

- **Qëllimi: Konservimi dhe restaurimi i vlerave të Parkut të Pallatit të Brigadave duke ruajtur origjinalitetin e tij.**
    - Restaurim i parkut dhe të gjitha aseteve të tij natyrale, artistike, ndërtimore dhe peizazhistike.
    - Aksesibiliteti dhe vendosja në funksion të vizitorëve duke e kthyer në një pikë atraktive të qytetit.
    - Menaxhimi konservativ nepërmjet drejtimit dhe organizimit të flukseve të lëvizjes në park.
- **Qëllimi: Katalogimi i të gjithë vlerave artistike të parkut, Skulptura, shatërvanë, elementë të mobilimit urban, duke krijuar databazën që do të shërbejë për konservimin dhe restaurimin në vazhdimësi. Menaxhimi i databazës në funksion të publikut dhe specialistëve të fushës**
    - Krijohet harta e pallatit me ndarjet sipas ambjenteve të vizitueshme, me shpjeguesin e funksioneve në kohën e ndërtimit. Harta në mënyrë të kuptueshme duhet të drejtojë vizitorin në ambjentet e Pallatit, dhe të shërbejë edhe si një vizitë virtuale në të.
    - Krijohet harta e parkut me pikat e interesit. Në skemën kompozicionale të parkut, shpjegohen konceptet e parimet e huazuara nga arkitektura e parqeve të tipit francez apo të tipit anglez e Italian. Një itinerar i përcaktuar shoqëron vizitorin në hapësirat e tij, duke i dhënë mundësi ta perceptojë atë nga pika të ndryshme shikimi.
    - Krijohet harta e veprave të artit, skulpturave. Nje itinerar i përcaktuar në hartë do të mund të drejtojë vizitorin si në një guidë turistike, përmes hapësirave ku do të gjejë veprat e artit, skulpturat dhe shatërvanët. Në secilën prej tyre do të shpjegohet alegoria artistike që mbart, duke i kthyer si fragmente të një narracioni në natyrë.
    - Krijohen ambjente të përshtatshme për pushim të vizitorëve. Në hapësirat e parkut gjendet mundësia për të ndërtuar përmes strukturave të lehta të mobilimit urban, vënde për shplodhje. Vëndvendosja e tyre duhet të studiohet mirë për të gjetur hapësirën më të përshtatshme për një aktivitet të dyfishtë, qëndrim shplodhje dhe pasurim me informacion.
    - Guida AudioVizuale në shërbim të vizitorëve. Materiale fotografike të arkivave dhe fotografi të kohës së sotme, sigurisht pas restaurimit, do të bëhen pjesë e një guide arkitektonike që duhet të shoqërojë vizitorin gjatë vizitës në pallat dhe gjatë vizitës në park. Plani i menaxhimit rekomandon

      edhe Konceptin e sistemit automatik te guidës audio vizive dhe

krjimin e faqes ëeb të Komleksit arkitektonik.

- Krijimi e riorganizimi i infrastrukturës së aksesimit dhe asaj lëvizjes në brendësi të parkut dhe pajisja me sinjalistikë treguese në shërbim të vizitorëve, duke u kujdesur për menaxhimin e problemeve të lidhura me turizmin.

## Drejtimi dhe menaxhimi

- **Qëllimi: Krijimi i një sistemi efikas vetëfinancimi nëpërmjet krijimit të aktiviteteve dhe funskioneve të reja në pallat.**
  - Krijimi i funksioneve të reja në pallat, do të jenë burim të ardhurash për menaxhimin e pallatit dhe do të ndikojnë në rritjen e të ardhurave që do të sigurojnë konservimin dhe mirëmbajtjen e tij.
  - Vizita të Pallatit, Kishës, strukturave ndihmëse dhe Parkut, me vlerat që ai ka.
  - Evente të rëndësishme shtetërore dhe private në nivel kombëtar e ndërkombëtar.
  - Krijimi i zonës së pritjes për vizitorë dhe infrastrukturës në shërbim të tyre (biletari, shërbim, rekreacion) Godina në hyrje të Ansamblit propozohet të përshtatet për këto funksione
  - Funksion akomodues në katin +2. 6 nukle dhomë+nyje sanitare dhe 2 nukle, tip suitë, do të shërbejnë për akomodim rezervuar për delegacione dhe të ftuar të nivelit të lartë qeveritar.
  - Salla ekspozite të përhershme dhe përkohshme.
  - Sallë konference ipogjee në pallat dhe në park (hapësira rekreative apo ceremoniale). Pallati ka sot ambjente që mund të shfrytëzohen për këtë qëllim
  - Struktura të qëndrueshme rekreative në park.Pjesë e vlefshme për vendodhje të këtyre funksioneve gjendet në anën qendrore dhe perëndimore të parkut në afërsi të serave dhe baseneve ujorë, si dhe në afërsi të stallës dhe shtëpisë së bujkut, duke ofruar kushte pejzazhistike për këto funksione të lidhura me publikun.
  - Qendra rekreative në Park. Strukturë restorative për degustim specialitetesh në pranë baseneve ujorë të parkut. Dizniveli i terrenit favorizon parashikim edhe të ambjenteve ipogjee, të cilat do rrisin sipërfaqe pa impaktuar pejzazhin.
  - Krijohet laboratori i bimëve dekorative. Në hapësirat e parkut, të cilat duhet të jenë të lulëzuara në çdo kohë, mund të krijohet mundësia e eksperimentimit të tipeve të ndryshme të luleve në përshtatje me stinët e vitit, diellëzimin apo hijen, lagështirën apo tokën e thatë. Këto kushte krijojnë mundësinë perfekte të krijimit të një laboratori të bimëve dekorative, në të cilin botanistë e arkitektë të parkut të eksperimentojnë, projektojnë, planifikojnë e aplikojnë bimë nga më të ndryshmet, duke u kthyer si një kopësht botanik dhe një vend eksperience për studentë botanistë apo arkitektë pejzazhistë në formim.
  - Krijohet ndarja e qartë e ambjenteve të Gardës së Republikës nga ato

të parqeve të Pallatit. Sot ambjente dikur të përdorura nga rojet që i shërbenin mbretërisë, përdoren nga Garda e Republikës dhe zyrat e administratës së saj. Me vënien në eficencë turistike të Ansamblit të pallatit mbretëror, rekomandohet riorganizimi i ambjenteve të Gardës, për të mundur që disa prej tyre, të kthehen në zyra administrate dhe dhe të qendrave kërkimore që propozohen.

- Krijohet vendi parkimi për vizitorët. Në pamundësi për të parkuar në hyrje të Ansamblit, gjë që do të prishte perceptimin mbretëror që është qëllim të ruhet për të, do të planifikohet që parkimi i pak mjeteve të mund të bëhet në një zonë verilindore të parkut, duke shfrytëzuar një hyrje tjetër nga ajo ceremoniale. Propozohet hyrja që sot përdoret nga Garda e Republikës. Hapësira mes Godinës në hyrje dhe qendrës së komandos propozohet të kthehet në parkim Plani i menaxhimit propozon Konceptin e monitorimit dhe menaxhimit inteligjent te parkimit.

- **Qëllimi: Krijimi i një sistemi menaxhimi bashkëkohor nëpërmjet një aplikacioni softëare, në të cilin të përfshihen të gjithë elementet e nevojshëm, duke filluar nga shitja e biletave, kontrolli hyrje daljeve, informacioni për turistët dhe stafin, etj.**
- **Qëllimi: Krijimi i një databaze, arkivë dokumentash, që të dokumentojë dhe menaxhojë pasurinë e vlerave arkitektonike, artistike, mjedisore etj të Pallatit dhe Parkut të tij. (Museum Integrated Information Management Systems)**

## Turizmi dhe Infrastruktura

- **Qëllimi: Ofrimi i një eksperience të veçantë e të kënaqshme për vizitorët dhe turistët, një eksperiencë e cila nuk cënon vlertat arkitektonike, artistike dhe pejzazhistike të objektit dhe Parkut të tij.**
  - Krijimi i guidave fizike dhe virtuale, itinerareve të shëtitjes në pallat dhe në park duke trasuar itineraret dhe zonat ku do të kanalizohen flukset e lëvizjeve, dhe duke ndarë fizikisht zonat e ndaluara për publikun.

- **Qëllimi: Krijimi e riorganizimi i infrastrukturës së aksesimit dhe lëvizjes në brendësi të parkut dhe pajisja me sinjalistikë treguese në shërbim të vizitorëve duke u kujdesur për menaxhimin e problemeve të lidhura me turizmin.**
  - Krijimi i zonës së parkimit dhe evidentimi i mënyrës së arritjes në të.
  - Lokalizimi i zonës së Gardës së Republikës duke krijuar një ndarje me rrethim të saj dhe propozimi i një hyrje të vecantë për administratën e automjetet e saj.
  - Krijimi i qendrës së vizitorëve dhe infrasttrukturës në shërbim të tyre (biletari, shërbim, rekreacion)

## Influenca në Komunitet, edukimi dhe trajnimi

- **Qëllimi: Përfshirja e komunitetit profesionist të fushës dhe të specializuar në proceset e restaurimit të vlerave arkitektonike, artistike, të interierit dhe të parkut.**

    - Krijimi i Qendrës Studimore e të restaurimit të elementeve të arredimit të interierit, të specializuar në stilistikën e periudhës së modernizmit të fillim viteve 1900 në shqipëri (mobilje, elemente të tekstilit, elemente të arredimit, ndricues, etj)

- **Qëllimi: Kthimi i parkut në një ambjent ku mësohet përmes praktikës mbi bimët dekorative, lulet, ngjyrat dhe ritmin biologjik të tyre, si dhe vënien e tyre në funksion të bukurisë së parkut.**
    - Krijimi i programeve edukuese për fëmijë, në funksion të njohjes së vlerave peizazhistike të parkut dhe aplikimit në parcela të vogla eksperimentale, nën drejtimin e kopshtarëve të specializuar, dhe më pas aplikimi i njohurive të të fituara në pjesë të tjera të parku

# 7.0 ADMINISTRIMI



# 7.0 ADMINISTRIMI

Në mbi 70 vite jetë, Asambli Historik i Pallatit të Brigadave (AHPB-ja në vazhdim) ka mirëpritur elitën e pushtetit dhe të qeverisjes së vendit dhe miqtë e të ftuarit më të lartë të Shqipërisë. Tashmë ka ardhur koha që ky asambël të hapet për vizitorë shqiptarë dhe të huaj. Pasi të restaurohet dhe të marrë funksione të reja, në harmoni me misionin e ruajtjes së tij, ky asambël duhet të shndërrohet në një destinacion të paevitueshëm të Tiranës. Ky PMI ka për qëllim të ofrojë një mënyrë se si të mundësohet restaurimi dhe rijetëzimi i AHPB-së në këtë destinacion elitar nddërkohë që AHPB-ja ruan funksionet e tij aktuale. Është e nevojshme të sqarohet se termi rijetëzim në këtë kapitull nuk i referohet përdorimit që ka në Ligjin Nr.27, Datë.17.05.2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë", por kuptimit primar që ka në literaturën e trashëgimisë kulturore, "plotësimi i një diçkaje me jetë dhe veprimtari të reja". Në vijim, nëse ky term i referohet Ligjit Nr.27/2018, do të qartësohet me një shënim.

Në mënyrën se si parashtrohen alternativat për ta rijetëzuar AHPB-në, janë marrë në konsideratë këto supozime:

(a) Pallati i Brigadave dhe parku i tij janë shpallur "Ansambël Historik" me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 752, datë 11/11/2004. Ndërkohë Ligji nr. 93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, mundëson kthimin në një destinacion turistik të Ansamblit Historik të Pallatit të Brigadave, në pëputhje me "Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023 dhe të Planit të Veprimit", miratuar me VKM nr. 413, datë 19.6.2019. Janë pikërisht këto arsye që mundësojnë shtimin e funksioneve të reja dhe rijetëzimin e tij.

(b) Të gjitha funksionet e reja që janë sugjeruar të shtohen, nuk duhet asnjëherë të cenojnë kryerjen e funksioneve primare që AHPB-ja ka, funksionet ceremoniale të përcaktuara kështu me ligj dhe akte të tjera ligjore.

(c) Është Objekt i Rëndësisë së Veçantë, ku kryejnë aktivitete Personalitetet e Larta Shtetërore të Vendit dhe delegacionet e huaja dhe që monitorohen dhe ruhen nga Garda e Republikës,

(d) Gjendja e tanishme e AHPB-së, sidomos godinës kryesore të kompleksit që gjerësisht njihet si Pallati i Brigadave, kërkon një ndërhyrje URGJENTE.

(e) Sigurimi i burimeve të nevojshme për ta mundësuar restaurimin dhe rijetëzimin e AHPB-së, duhet të kryhet brenda parashikimeve të Ligjit nr.27, "Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë".

Praktika nga vende të ndryshme të botës janë marrë në konsideratë.

## 1. Administrimi aktual

Tre institucione janë të përfshira në administrimin e AHPB-së:

**A. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare**, person juridik në varësi të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, e cila vepron në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.34 datë 07.01.1999 i ndryshuar. Ajo e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin për ndërmarrjet Nr. 7582 datë 13/07/1992. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare financohet nga të ardhurat e siguruara nga veprimtaria e saj dhe nga buxheti i shtetit.

DSHQ-ja organizon eventet, si dhe të aktivitetet ceremoniale, publike dhe jopublike, sipas kërkesës, duke trajtuar me përparësi nevojat e Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit Shqipërisë. Në organizimin e eventit, institucioni ofron me qira ambientet që ka në administrim, shërbimin e logjistikës si dhe shërbimin ushqimor. Gjithashtu DSHQ-ja mundëson hapjen e AHPB-së për vizita të publikut, shërbime fotografike apo aktivitete të ngjashme.

DSHQ-ja ka të gjithë godinat dhe objektet në inventarin e saj. Personeli që siguron ofrimin e të gjitha shërbimeve është i punësuar nga DSHQ-ja.

**B. Garda e Republikës**

Intitucioni i Gardës funksionon në bazë të Ligjit 33/2021, të Ligjit nr.8869 datë 22.05.2003 dhe të VKM nr.590 datë 05.09.2007 “Për përcaktimin e banesave të personaliteteve të larta shtetërore të vendit, të selive, rezidencave dhe objekteve të tjera shtetërore, që do të ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar. Garda e Republikës ka përgjegjësi dhe kryen këto detyra kryesore:

a) organizon dhe kryen ruajtjen dhe mbrojtjen fizike të personaliteteve.
b) organizon dhe kryen ruajtjen, mbrojtjen e brendshme e të jashtme të objekteve.
Në Objektet e Rendësisë së Veçantë, ku kryejnë aktivitete Personalitetet e Larta Shtetëore të Vendit dhe delegacionet e huaja të cilat monitorohen dhe ruhen nga Garda e Republikës, midis tyre është dhe territori dhe godina e Pallatit të Brigadave

**C. Ministria e Kulturës**

Sipas nenit 13, të Ligjit Nr.27, është në kompetencat e Ministrisë së Kulturës që të kryejë:

- Monitorimin e vlerave të paluajtshme kulturore;
- Metodologjinë dhe përcaktimin e rregullave për ruajtjen e vlerave të paluajtshme kulturore dhe mjedisin e tyre;
- Të bëjë koordinimin për:
  Termat e referencës për planet e projektimit, ruajtjen dhe planet menaxhuese, skemat e ndarjes, planet dhe ndryshimet e tyre, rregullat e normat e tyre specifike dhe projektet e zhvillimit, në respekt me vlerat kulturore të paluajtshme, të vetme dhe të grupit, brenda kufijve të tyre dhe zonat e ruajtura, sipas rasteve të përcaktuara.

Për sa më lart, duke patur parasysh se Ministria e Kulturës është institucioni që garanton ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore të AHPB-së, ajo duhet të jetë dhe insitucioni që nxit procesin e restaurimit e të rijetëzimit, por në një bashkëpunim të ngushtë me DSHQ-në dhe Gardën e Republikës.

Financimi i deritanishëm për mirëmbajtjen e AHPB-së është siguruar nga DSHQ-ja.

## 2. Modele të sukseshme menaxhimi

Një vëzhgim i zgjeruar u krye si pjesë e përgatitjes së këtij plani, për të identifikuar raste të ngjashme të restaurimit dhe rijetëzimit, si dhe raste të menaxhimit të këtij procesi. Raste të ndryshme u identifikuan në pjesë të ndryshme të botës. Raste të shumta u identifikuan për të parë se cilat funksione të reja mund të shtohen si pjesë e rijetëzimit dhe shndërrimit të AHPB-së në një destinacion të vizitueshëm, përfshirë dhe pjesën e gjelbër të AHPB-së. Të tjera raste u identifikuan për të kuptuar mënyrën se si është financuar ky proces. Gjithsesi ishte e vështirë gjetja e një rasti tërësisht të ngashëm me AHPB-në, sepse në asnjë rast nevojat për restaurim dhe rijetëzim nuk kanë qenë kaq urgjente dhe të gjithanshme, duke kërkuar fonde financiare të konsiderueshme.

Disa përgjithësime mund të bëhen pas këtij vëzhgimi në lidhje me financimin e restaurimit dhe janë përzgjedhur raste që tregojnë llojshmëri të mënyrave të gjetjes së fondeve:

(i) Financimi i restaurimit është kryer me fonde tërësisht shtetërore, sikurse rasti i Buckingham Palace, ku Parlamenti i Mbretërisë së Bashkuar vendosi të financojë restaurimin e pallatit, duke rritur financimin për fondin e Mbretëreshës për një periudhë 10 vjecare. Rritja e këtij fondi do të mundësojë restaurimin. Ky vendim është marrë në vitin 2017[1].



Buckingham Palace

(ii) Pallati Ëilanóë në Poloni: i vendosur 10 km në jug të qytetit të Varshavës, Pallati Ëilanóë është një nga perlat më të bukura dhe më të njohura arkitekturore të Polonisë. U themelua në shekullin e 17-të nga Mbreti John III Sobielski dhe përfshihet në listën e siteve të trashëgimisë kombëtare të Polonisë. Projekti pjesor i restaurimit të pallatit dhe tërësor të kopshteve, u financuan në bashkëpunim me European Regional Development Fund[2].

[1] https://www.bbc.com/news/uk-politics-39280770
[2] https://ec.europa.eu/regional_policy/en/projets/poland/restoring-prestige-to-a-polish-palace



Pallati Wilanóë në Poloni

(iii) Pallati Stor, Kabul, Afghanistan: Mbreti afgan Amanullah Khan ndërtoi Pallatin tashmë 100-vjeçar, Stor. Një nga dhomat në pallat u përdor për nënshkrimin e Marrëveshjes së Ravalpindit, me të cilën Afganistani u bë një shtet i pavarur sovran. Financimi i restaurimit u mundësua nga Aga Khan Trust for Culture (AKTC) në bashkëpunim me qeverinë e Afganistanit dhe të Indisë.[3]



Pallati Stor, Kabul

Për sa i përket funksioneve dhe menaxhimit të komplekseve të ngjashme historike, dy raste janë përzgjedhur:
Njëri është Pallati Dolmabahce në Stamboll, i cili është zgjedhur si rast i ngjashëm me AHPB-në, për nga historiku i përdorimit. Pallati Dolmabahçe u urdhërua nga Sulltani i 31-të i Perandorisë, Abdëlmecid I, dhe u ndërtua midis viteve 1843 dhe 1856. Në të ka jetuar Presidenti i parë i Republikës Turke Mustafa Kemal Attaturk. Dolmabahce menaxhohet nga Administrata Shtetërore për Pallatet Kombëtare, dhe përdoret si vend për pritje ceremoniale (kur ato ndodhin në Stamboll dhe jo në Ankara), është një ndër sitet më të vizituara në Stamboll, si dhe është vend për aktivitete kulturore madje dhe

[3] Restoration of the Stor Palace, Kabul | Aga Khan Development Netëork (akdn.org)

ceremoni martesore. Financimi i menaxhimit bëhet nga shteti, por me raste ka dhe financime nga Filantropë turq, të cilët kanë ndërmarrë projekte rijetëzimi, si psh Fondacioni TAÇ i cili financoi riorganizim e Kioskës së Xhamit për t'u përdorur si hapësirë ekspozite.

Një mundësi alternative menaxhimi është një njësi si "Historic Royal Palace" në Britaninë e Madhe. Historic Royal Palaces (Pallatet Historike Mbretërore) u krijuan nga qeveria britanike në 1989 në mënyrë që të kujdeseshin për pesë pallate mbretërore (Toëer of London, Hampton Court Palace, Banqueting House, Kensington Palace and Keë Palace). Më vonë ajo u bë një organizatë e pavarur, me supervizim nga Departamenti i Trashëgimisë Kombëtare, tani i quajtur Departamenti për Kulturë, Media dhe Sport. Historic Royal Palaces ështe krijuar në vazhdën e shumë institucioneve britanike për menaxhimin e trashëgimisë kulturore, si English Heritage, National Trust, që kanë statusin juridik të tillë që i mundëson funksionimin si OJF (edhe pse kryen aktivitete fitimprurëse, ajo mund mund të përfitojë edhe financim shtetëror).

### 3. Alternativa zgjidhjeje dhe ndryshimi të modelit aktual

Çdo alternativë për të siguruar financimin e restaurimit dhe rijetëzimit të AHPB-së, mund të nxitet nga shembujt e dhënë, por mbi të gjitha duhet të jetë në respekt të Ligjit Nr.27/2018 "Për trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" dhe specifikisht neneve 18, 19 dhe 20. Për formën e menaxhimit/administrimit duhet të respektohen nenet 178 dhe 182-186 të këtij ligji. Neni 178 përcakton format e përdorimit të pasurive kulturore dhe nenet 182-186 përcaktojnë elementët e procesit të rijetëzimit (kufizimet, procedura, projekti dhe kontrata e rijetëzimit) e cila është forma e rekomanduar për AHPB. Forma e deritanishme e administrimit e AHPB nga DSHQ, ka qenë formë direkte.

Gjithsesi brenda parashtrimeve të Ligjit Nr.27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë", paraqitet një shtjellim për të gjitha rastet e parashikuara në ligj për administrimin e AHPB-së, një vlerësim sa të mundshme janë ato për t'u zbatuar me avantazhet dhe disavantazhet përkatëse, duke patur parasysh dy kritere, urgjencën për restaurim dhe rijetëzim dhe gjetjen e fondeve.

Shënim: termi administrim zëvendësohet me manaxhim për lehtësi kuptimi duke qenë se janë terma të përafërt.

1. Forma direkte; kjo është forma aktuale e administrimit të AHPB-së. Ligji paraqet që: "Administrimi direkt realizohet nëpërmjet strukturave organizative të specializuara në varësi të institucioneve shtetërore ose subjekteve të tjera publike me autonomi shkencore, organizative, financiare dhe me personel të specializuar tekniko-shkencor. Institucionet publike mund të realizojnë administrimin direkt edhe në bashkëpunim me organe të tjera të administratës publike". Kjo formë aktuale e administrim/menaxhim ka siguruar ruajtjen e asamblit dhe të vlerave të tij. **Nga ana tjetër, kjo formë manaxhimi ofron mundësi të kufizuara për të arritur realizimin e projektit të rijetëzimit meqë një projekt i përmasave të tilla kërkon një institucion të dedikuar, burimet e nevojshme si financiare dhe njerëzore.**

2. Forma indirekte e administrimit, e parashikuar në tre forma të ndryshme:

   a) Fondacioneve të posaçme, të krijuara sipas nenit 172 të këtij ligji;
   b) Fondacioneve të krijuara nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore, sipas këtij ligji;
   c) Personave fizikë apo juridikë, publikë ose privatë, të cilëve pasuria kulturore u jepet në administrim nëpërmjet procedurave publike të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe vendim të KKMPK-së, bazuar në vlerësimin krahasimor të projekteve të paraqitura.

Në variantin 2.a (fondacion i posaçëm), sipas parashtrimit të ligjit, kërkohet që Fondacioni të krijohet në partneritet me një palë të interesuar (personave fizikë ose juridikë privatë, vendas apo të huaj), e cila të ketë përvojë në fushën e manaxhimit të asambleve të tilla, dhe të ngritjes së fondeve për rijetëzimin e AHPB-së. **Mundësia që kjo palë e interesuar të ofrohet bashkë me financimin që kërkon projekti i rijetëzimit, dhe në një kohë të shkurtër (duke patur parasysh nevojat urgjente për ta restauruar AHPB-në), është shumë e vogël.**

Në variantin 2.b, sipas parashtrimit të ligjit, (fondacione të krijuara nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore), krijimi i një fondacioni të tillë, thjesht i delegon përgjegjësinë një institucioni tjetër i cili duke qenë i sapoformuar, nuk do të ketë as përvojën dhe aq më pak burimet e nevojshme për të garantuar realizimin e rijetëzimit.

Në variantin 2.c, sipas parashtrimit të ligjit, ...“Administrimi indirekt kryhet nëpërmjet personave fizikë apo juridikë, publikë ose privatë, të cilëve pasuria kulturore u jepet në administrim nëpërmjet procedurave publike të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave dhe vendim të KKMPK-së, bazuar në vlerësimin krahasimor të projekteve të paraqitura”. Ky variant nuk mundëson gjetjen e burimeve të nevojshme për të nisur dhe kryer investimet e nevojshme në AHPB.

**3.** Një formë e parashikuar nga ligji, neni 182, për përdorimin (jo administrimin) e trashëgimisë kulturore, është dhe **rijetëzimi**. Me një periudhë maksimale të partneritetit të parashikuar në ligj (neni 186, pika 5) prej 20 vitesh, pala e interesuar për partneritet, duhet të ketë financimin e duhur për të mundësuar rijetëzimin. Gjithashtu duhet të ketë përvojën e duhur për manaxhimin e trashëgimisë kulturore, të parashikojë kufizimet e mundshme në nxjerrjen e të ardhurave të cilat mund të mos sjellin fitime për të. Ky skenar mundëson gjetjen e fondeve të nevojshme për të kryer investimet e kërkuara në AHPB dhe administrimin e tij brënda afatit kontraktual të përdorimit. Si rrjedhojë kjo është forma e rekomanduar për të arritur qëllimin e këtij plani manaxhimi. Ligji nr.27/2018 paraqet të gjitha etapat e nevojshme për të arritur përdorimin me rijetëzim.

Në këtë rast, është e rëndësishme të adresohet roli i Gardës së Republikës në ruajtjen e AHPB-së dhe në vazhdimin e përdorimit të godinave/ambjenteve që tashmë okupon.

Një **konsideratë specifike** duhet të ketë për mbikqyrjen e aktiviteteve nga një **Bord profesionistësh të fushës,** i cili kontrollon dhe garanton ruajtjen e vlerave të monumentit si dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara si për ato shtetërore dhe për vizitorët. Ky Bord do të ketë në përbërje të tij specialistë të menaxhimit, juristë, restauratorë të arkitekturës e konstruksionit, konservues të veprave të artit, botanistë e historianë dhe në mënyrë të domosdoshme, një përfaqësues nga Ministria e Kulturës dhe një nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare. **Ky Bord duhet të shërbejë si këshillues** për drejtimet kryesore të menaxhimit, duke marrë përsipër që të sigurojë pacënueshmërinë e AHPB-në, por edhe njëkohësisht të jetë pjesë e vendimmarrjes për ato veprime që janë të lidhura direkt me këtë pacënueshmëri.



# 8.0 PLANI I VEPRIMIT

# 8.0 PLANI I VEPRIMIT

Ky Plan Veprimi parashikon aktivitete afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për menaxhimin, në mbështetje të synimeve dhe objektivave të përcaktuar në seksionin paraardhës , i kategorizuar sipas tematikave të mëposhtme:

- Pallati, vlera arkitektonike dhe artistike
- Parku, vlera pejzazhistike dhe artistike
- Turizmi dhe infrastruktura
- Influenca në komunitet, edukimi e trajnimi
- Drejtimi dhe menaxhimi

Shtrirja kohore tregon vitin e fillimit dhe kohëzgjatjen e secilit prej aktiviteteve për çdo kategori.

Duke iu referuar edhe vetë Planit të Veprimit, vlen të përmenden pikat e mëposhtme:

- Për të gjitha veprimet e specifikuara më poshtë, sipas rastit, është e detyrueshme marrja e lejes, siç parashikohet në ligjet kombëtare (dhe për rrjedhojë aktet e tyre nënligjore)
- Aty ku ka veprime që varen ose mbivendosen me veprime të tjerë, atëherë këto ndërveprime duhet të rishikohen.
- Të gjithë konsulentët dhe këshilltarët e jashtëm, duhet të jenë të licensuar sipas Ligjit Nr. 27/2018 për Trashëgiminë Kulturore.
- Çdo pjesë e planit të veprimit ka të bëjë me rolin e enteve publike dhe nuk do të kërkojë fonde shtesë nga buxheti i shtetit.
- Çdo linjë e planit të veprimit shoqërohet me një vlerësim financiar të fondeve që kërkohen për t'u arritur realizimin këtij plani manaxhimi. Vlerësim është fillestar: buxhetim i detajuar do të kryhen kur pregatiten të gjitha projektet teknikë të nevojshme.
- Çdo ndërhyrje e planifikuar duhet t'i nënshtrohet paraprakisht procesit të VNM-së, duke qenë se janë objekt i ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".
- Mbetjet e krijuara nga veprimtaritë e ndryshme, ku duhet të transpohen në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte'' dhe për asnjë arsye mos të ketë hedhje të tyre pranë burimeve ujore;
- Niveli i zhurmave gjatë proçesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banorëve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët;
- Të mbahen në konsideratë detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".

| Veprimi | Përgjegjëse për zbatimin | Aprovues dhe mbikqyrës | Kohëzgjatja/ frekuenca | Parashikimi financiar (në ALL) |
|---|---|---|---|---|
| **1.0 Pallati, vlera arkitektonike dhe artistike** | | | | |
| **1.1 Qëllimi: Konservimi dhe restaurimi i vlerave artistike dhe arkitektonike, duke patur prioritet ruajtjen e vlerave të kësaj pasurie të veçantë të Trashëgimisë Kulturore të Shqipërisë.** | | | | |
| **1.1.1 Kryerja e vlerësimeve mbi gjendjen e Pallatit. Përpilimi relacionit teknik dhe buxhetit.** Ky është vetëm një vlerësim paraprak | Struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe ekspertë të fushave | Ministria e Kulturës Bordi i profesionistëve të fushës | 3 muaj - Rishikim periodik | 3 700 000 |
| **1.1.2 Kryerja e vlerësimeve mbi gjendjen e mobilieve dhe artefakteve në brendësi të pallatit, përgatitja e relacionit teknik mbi to.** Ky është vetëm një vlerësim paraprak | Struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe ekspertë të fushave | Ministria e Kulturës Bordi i profesionistëve të fushës | 3 muaj - Rishikim periodik | 2 500 000 |
| **1.1.3 Kryerja e vlerësimit mbi gjendjen e Parkut, strukturave arkitektonike dhe artistike në të, përpilimi i relacionit teknik** Ky është vetëm një vlerësim paraprak | Struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe ekspertë të fushave | Ministria e Kulturës Bordi i profesionistëve të fushës | 1 muaj - Rishikim periodik | 3 300 000 |
| **1.1.4 Kryrja e vlerësimit mbi gjendjen e rrethimit dhe sigurisë të zonës në pronësi të Pallatit të Brigadave, përpilimi i relacionit teknik** Ky është vetëm një vlerësim paraprak | Struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe ekspertë të fushave | Ministria e Kulturës Bordi i profesionistëve të fushës | 1 muaj - Rishikim periodik | 2 800 000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| **1.1.5 Paraqitja e propozimeve/përmbledhjeve teknike për konservimin, përzgjedhja e konsulentëve, menaxhimi dhe fillimi i dorëzimit të 'Punimeve më Urgjente'**<br>Bëhet duke përfshirë të tre kategoritë sipas tre pikave të mësipërme, Pallati, Parku, Rrethimi. | Struktura përgjegjëse për menaxhimin me konsulentët e jashtëm | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 3 muaj | 120 000 |
| **Veprimi** | **Përgjegjëse për zbatimin** | **Aprovues dhe mbikqyrës** | **Kohëzgjatja/ frekuenca** | **Parashikimi financiar (në ALL)** |
| **1.1.6 Vendosja e sistemit të ndricimit emergjent dhe të kontrollit me kamera sigurie të parkut dhe ekstremiteteve të territorit.**<br>Ky është një vlerësim paraprak. Buxheti i detajuar do të pregatitet bashkë me projektin teknik. | Struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe ekspertë të fushave | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 1 muaj - Rishikim periodik | 39 000 000 |
| **1.1.7 Përgatitja e projektit të restaurimit arkitektonik të pallatit**<br>- T'i referohet projekteve origjinale e materialeve arkivore<br>-Të parashikohet ndërhyrje për të shmangur pengesat arkitektonike që do te vështirësonin vizitat nga persona me aftësi të kufizuara. | Struktura përgjegjëse për menaxhimin.<br>Ekspertë të nënkontraktuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 3 muaj | 17 500 000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **1.1.8 Përgatitja e projektit të restaurimit dhe konsolidimit të sistemit konstruktiv**<br>- T'i referohet projekteve origjinale e materialeve arkivore | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontraktuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 3 muaj | 5 500 000 |
| **1.1.9 Përgatitja e projektit të restaurimit të sistemit të dyerve dhe dritareve.**<br>- Të studiohet dhe të ruhen meknizmat origjinale, aty ku janë jashtë funksionit, të zëvendësohen me të njejtat forma e mekanizma si origjinalet | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontraktuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 3muaj | 3 800 000 |
| **1.1.10 Përgatitja e projektit të restaurimit të sistemeve elektrike dhe elektronike, duke ruajtur respektktuar kriteret e sigurisë.**<br>Të parashikohet pajisja me sistemet e dedektimit dhe lajmërimit të zjarrit (ËiFi) dhe ndërtimi i një sistemi të vijueshëm të furnizimit me energji. | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontraktuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 3 muaj | 7 500 000 |
| **1.1.11 Përgatitja e projektit të restaurimit të sistemit të instalimeve mekanike dhe hidraulike**<br>- Cetrali termik duhet të nxiret jashte perdorimi dhe të lirojë ambjentin teknik.<br>- Sistemi i tubacioneve duhet të hiqet dhe ti lejë vendit sistemit të ri të tubacioneve.<br>- Pajisjet radiatore (prej gize) duhet të hiqen për t'i lënë | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontratuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 3 muaj | 6 900 000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| vendin pajisjeve të reja ngrohje/ftohje.<br>- Të plotësohet sistemi me ajër të freskët dhe ventilim.<br>- Të riplanifikohet sistemi i furnizimit me ujë të ftohtë dhe të ngrohtë.<br>- Të riplanifikohet sistemi i shkarkimeve të nyjeve sanitare | | | | |
| **1.1.12. Përgatitja e projektit për instalim të sistemeve të sigurisë**<br>- Sistemet Fire Alarm-Extinguishing<br>- Fire vontrol- Evacuation<br>- Intrusion<br>- Videosurvelliance | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontratuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 3 muaj | 2 900 000 |
| **1.1.13 Përgatitja e projektit të restaurimit të mobiljeve, elementeve të arredimit, artefakteve dhe ndricuesve.**<br>- Të ruhen materialet origjinale dhe të diferencohen objektet që nuk kanë qenë pjesë e projektit fillestar<br>**Të bashkëpunohet me Inxh. Elektrik për vënien në funksionim të ndriçuesve origjinalë** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontratuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 3 muaj | 4 500 000 |
| **1.1.14 Përgatitja e projektit të restaurimit të elementeve prej tekstili**<br>- T'i referohet projekteve origjinale e materialeve arkivore | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontratuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 3 muaj | 3 900 000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| **Veprimi** | **Përgjegjëse për zbatimin** | **Aprovues dhe mbikqyrës** | **Kohëzgjatja/ frekuenca** | **Parashikimi financiar (në ALL)** |
| **1.2 Qëllimi: Katalogimi i të gjithë vlerave artistike të interierit duke krijuar databaza që do të shërbejnë për konservimin e restaurimin në vazhdimësi.** | | | | |
| **1.2.1 Katalogimi i mobiljeve, artefakteve, skulpturave, bazorelieveve, ndricuesve.**<br>- Të bëhet klasifikimi sipas tipologjisë dhe skeda teknike e secilit, si pjesë e një databaze të institucionit dhe të IKTK | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontratuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 6 muaj | 2 800 000 |
| **1.2.2 Menaxhimi i databazave në funksion të publikut dhe informacionit didaktik të specialistëve të fushave parkatëse.**<br>- Krijimi i faqes ëeb të Pallatit të Brigadave dhe e Parkut të tij, vendosja e kësaj databaze në faqen ëeb, duke i ndarë sipas kategorive.<br>- Krijimi i tureve virtuale, të vetë-drejtuara, në ambjentet e brendshme të Pallatit, të aksesueshme nga mjete të zakonshme elektronike: PC, Smartphon, etj | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontratuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 6 muaj | 3 900 000 |
| **1.2.3 Konservimi preventiv dhe mirëmbajtja në vazhdueshmëri i elementeve në interier: mobilje, ndriçues, artefakte, elemente tekstili, piktura, bazorelieve, dekoracione dhe rifinitura arkitektonike** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontratuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | I vazhdueshëm e periodik | 1 028 500 000 |

| **Veprimi** | **Përgjegjëse për zbatimin** | **Aprovues dhe mbikqyrës** | **Kohëzgjatja/ frekuenca** | **Parashikimi financiar (në ALL)** |
|---|---|---|---|---|
| **2.0 Pallati, Parku, vlerat peizazhistike dhe artistike** | | | | |
| **2.1 Qëllimi : konservimi dhe restaurimi i vlerave të Parkut të Pallatit të Brigadave, duke ruajtur origjinalitetin e tij.** | | | | |
| **2.1.1 Konsultimi i materialeve arkivore për të kuptuar tendencën projektive të arkitektit të parkut, duke patur predispozitën për të respektuar format origjinale që ka patur në projekt.** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontratuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 3 muaj | 250000 |
| **2.1.2 Restaurimi i serës dhe i shtëpisë së fermerit, reflektimi në të i dizajnit të projektit fillestar të kohës së ndërtimit.** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontratuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 6 muaj | 12 500 000 |
| **2.1.3 Restaurimi dhe vënia ne efektivitet i fushave të tenisit brenda territorit të parkut** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontratuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 6 muaj | 12 450 000 |
| **2.1.4 Evidentimi i problemeve të gjelbërimit, pemë e shkurre, duke i hequr të dëmtuarat dhe zëvendësuar me të njejtat specie të shëndetshme në të njëjtat vënde sipas dizajnit origjinal të parkut** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontratuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 3 muaj | 16 500 000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **2.1.5 Restaurimi i baseneve ujore dhe pasurimi i tyre me elemente të florës e faunës** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontratuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 6 muaj | 7 750 000 |
| **2.1.6 Restaurimi i elementëve të mobilimit urban dhe i shtresave të rrugëve e shtigjeve të parkut** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontratuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 6 muaj | 28 800 000 |
| **2.1.7 Restaurimi i Pallatit dhe krijimi i Muzeut** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontratuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 18 muaj | 2 135 000 000 |
| **a. Krijimi i Databazës së veprave artistike të Parkut: skulptura, shatërvanë, elementë të mobilimit urban, etj** | | | | |
| **2.2.1 Krijimi i databazës së veprave artistike të Parkut** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontratuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 6 muaj | 6 000 000 |
| **2.2.2 Krijimi i itinerareve në park, të destinuara për vizitorët, itinerari i skulpturave dhe shatërvaneve i lidhur me autorët, itinerari i hapësirave tematike, itinerari i veprave të artit i destinuar për profesionistë.** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontraktuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 6 muaj | 9 800 000 |
| **2.2.3 Krijimi i kushteve për aksesibilitetin e personave me aftësi të kufizuara** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontraktuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve | 6 muaj | 6 400 000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | të fushës | | |
| **2.2.4 Krijimi i hapësirave rekreative dhe të shërbimit në funksion të vizitorëve** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontraktuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 2 vjet | 60 500 000 |

| **Veprimi** | **Përgjegjëse për zbatimin** | **Aprovues dhe mbikqyrës** | **Kohëzgjatja/ frekuenca** | **Parashikimi financiar(në ALL)** |
|---|---|---|---|---|
| **3.0 Turizmi dhe infrastruktura** | | | | |
| **3.1 Qëllimi : Ofrimi i një eksperience të veçantë e të kënaqshme për vizitorët dhe turistët, një eksperiencë e cila nuk cënon vlertat arkitektonike, artistike dhe pejzazhistike të AHPB** | | | | |
| **3.1.1 Krijimi i guidave fizike dhe virtuale, itinerareve të shëtitjes në pallat dhe në park duke trasuar itineraret dhe zonat ku do të kanalizohen flukset e lëvizjeve, dhe duke ndarë fizikisht zonat e ndaluara për publikun.** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontraktuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 1 vit | 9 500 000 |
| **3.2.1 Kalimi në administrim të AHPB i dy ndërtesave dhe dy parkimeve të Gardës (sipas Hartës në shtojca), krijimi i zonës së parkimit për vizitorët dhe evidentimi i mënyrës së arritjes në të.** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontraktuar | Garda e Republikës<br>Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 1 vit | 1 300 000 |
| **3.2.2 Lokalizimi i zonës së Gardës së Republikës duke krijuar një ndarje me rrethim të saj dhe propozimi i një hyrje të** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontraktuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve | 1 vit | 4 400 000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **vecantë për administratën e automjetet e saj.** | | të fushës | | |
| **3.2.3 Krijimi i qendrës së vizitorëve dhe infrastrukturës në shërbim të tyre (biletari, shërbim, rekreacion)** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontraktuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 1 vit | 33 000 000 |

| Veprimi | Përgjegjëse për zbatimin | Aprovues dhe mbikqyrës | Kohëzgjatja/ frekuenca | Parashikimi financiar (në ALL) |
|---|---|---|---|---|
| **4.0 Influenca në komunitet, edukimi dhe trajnimi** | | | | |
| **4.1 Qëllimi: Përfshirja e komunitetit profesionist të fushës dhe të specializuar në proceset e restaurimit të vlerave arkitektonike, artistike, të interierit dhe të parkut.** | | | | |
| **4.1.1 Krijimi i qendrës studimore e të restaurimit të elementeve të arredimit të interierit, të specializuar në stilistikën e periudhës së modernizmit të fillim viteve 1900 në shqipëri (mobilje, elemente të tekstilit, elemente të arredimit, ndricues, etj)**<br>**4.1.2 Krijimi i laboratorit të bimëve, në të cilin botanistë e arkitektë të parkut të eksperimentojnë,** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin.<br>Ekspertë të nënkontraktuar<br>Struktura përgjegjëse për menaxhimin.<br>Ekspertë të nënkontraktuar<br>Struktura | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës<br>Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 18 muaj<br>18 muaj<br>1,5 muaj | 36 000 000<br>15 000 000<br>1 900 000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **projektojnë, planifikojnë e aplikojnë bimë nga më të ndryshmet, duke u kthyer si një kopësht botanik dhe një vend eksperience për studentë botanistë apo arkitektë pejzazhistë në formim.**<br><br>**4.1.3 Krijimi i Bordit të profesionistëve të fushës që do të shërbeje si konsultues, këshillues dhe aprovues, për të gjitha proceset e lidhura me restaurimin, konservimin dhe ruajtjen e pasurisë kulturore të AHPB, apo me procese që influencojnë direkt këtë pasuri kulturore.** | përgjegjëse për menaxhimin. | Ministria e Kulturës | | |
| **4.2 Qëllimi: Kthimi i parkut në një ambjent ku mësohet përmes praktikës mbi bimët dekorative, lulet, ngjyrat dhe ritmin biologjik të tyre, si dhe vënien e tyre në funksion të bukurisë së parkut.** | | | | |
| **4.2.1 Krijimi i programeve edukuese për fëmijë, në funksion të njohjes së vlerave pejsazhistike të parkut dhe aplikimit në parcela të vogla eksperimentale, nën drejtimin e kopshtarëve të specializuar, dhe më pas aplikimi i njohurive të të fituara në pjesë të tjera të parkut** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin.<br>Ekspertë të nënkontraktuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 2 vjet | 7 500 000 |

| Veprimi | Përgjegjëse për zbatimin | Aprovues dhe mbikqyrës | Kohëzgjatja/ frekuenca | Parashikimi financiar (në ALL) |
|---|---|---|---|---|
| **5.0 Drejtimi dhe menaxhimi** | | | | |
| **5.1 Qëllimi: Krijimi i një sistemi efikas vetëfinancimi nëpërmjet krijimit të aktiviteteve dhe funskioneve të reja në pallat.** | | | | |
| **5.1.1 Krijimi i funksioneve të reja në pallat, (vizita të oganizuara në grupe, salle ekspozite, salle mbledhje, akomodim hotelerie ekskluzive për personalitete shtetërorë, strukture didaktike në funksion të eksperiencave konservuese dhe restauruese) do të jenë burim të ardhurash për menaxhimin e pallatit dhe do të ndikojnë në rritjen e të ardhurave që do të sigurojnë konservimin dhe mirëmbajtjen e tij.** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontraktuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 3 vjet | 130 000 000 |
| **5.2 Qëllimi : Krijimi i një sistemi menaxhimi bashkëkohor nëpërmjet një aplikacioni softëare, në të cilin të përfshihen të gjithë elementet e nevojshëm, (shitja e biletave, kontrolli hyrje daljeve, informacioni për turistët dhe stafin, etj).** | | | | |
| **5.2.1 Krijimi i pasqyrave të sakta financiare mbi të ardhurat nga vizitorët (sistem financiar)** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontraktuar | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | Periodike çdo 6 muaj | 2 900 000 |
| **5.2.2 Lehtësimi i** | Struktura | Ministria e | 2 vjet, | 15 000 000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **aksesibilitetit në AHPB duke sjellë për rrjedhojë rritjen e numrit të vizitorëve** | përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontraktuar | Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | | |
| **5.3. Qëllimi : Krijimi i një databaze, arkivë dokumentash, që të dokumentojë dhe menaxhojë pasurinë e vlerave arkitektonike, artistike, mjedisore të Pallatit dhe Parkut të tij. (Museum Integrated Information Management Systems)** | | | | |
| **5.3.1 Katalogimi i tipologjive të ndryshme arkitektonike, dhe dekorative** | Struktura përgjegjëse për menaxhimin. Ekspertë të nënkontraktuar | Ministria e Kulturës<br>Bordi i profesionistëve të fushës | 6-12 muaj | 3 800 000 |

**Totali i vlerësimit paraprak për zbatimin e planit të veprimit është 3 683 760 000 ALL ose 30 194 754 Euro (me kursin e këmbimit 1 euro = 122 ALL).**

# 9.0 ZBATIMI dhe MONITORIMI



# 9.0 ZBATIMI dhe MONITORIMI

## Zbatimi

Në tre vitet e para duhet përfunduar procesi i lidhur me konservimin, restaurimin dhe përgatitjen e infrastrukturës së nevojshme në shërbim të turizmit, duke përgatitur AHPB-në për hapje të plotë ndaj vizitorëve sipas rekomandimeve e funksioneve që ky PMI parashtron.

Kjo periudhë 3 vjeçare cilësohet si periudhë tranzitore.

Gjatë kësaj periudhe parashikohen të bëhen veprimet e mëposhtëme:

1. Ndërhyrjet emergjente konservuese dhe restaurimi i plotë i pallatit dhe Parkut
2. Ngritja e sistemeve infrastrukturore në shërbim të mobilitetit të vizitorëve (parkimi, rrugët e lëvizjes, eleminimi i barrierave arkitektonike)
3. Ngritja e sistemeve informuese në shërbim të vizitorëve (brandimi, faqja ëeb, katalogimi, vizitat virtuale, planet e programuar të vizitave, itineraret dhe gjithë materiali informativ)
4. Ngritja e laboratorit të mobiljeve dhe laboratorit të bimëve dekorative, duke shfrytëzuar ambjentet ekzistues, sipas përshkrimeve të paraqitura në shtojcat e këtij PMI.
5. Krijimi i Bordit të profesionistëve të fushës sipas përshkrimit të paraqitur me lart në këtë PMI

Këto veprime do të menaxhohen nga struktura e re që do të përcaktohet si rrjedhojë e procesit të rijetëzimit, do të rregullohen e përcaktohen në marrdhënie kontraktuale dhe do të monitorohen vazhdimisht nga Ministria e Kulturës dhe Bordi i profesionistëve të fushës.

Paralelisht me këto procese të përshkruar më lart, realizohet edhe sa më poshtë vijon:

- Hartimi dhe përgatitja e udhëzuesëve të funksionimit të AHPB-së, të cilët do t'i shërbejnë stafit administrativ dhe punonjësve.
- Marrja në konsideratë e implikimeve për të gjithë stafin ekzistues të AHPB-së dhe mirëqenien e tyre në të ardhmen, si dhe punësimin e personave të rinj, duke përfshirë përshkrime të detajuara të pozicioneve të punës dhe kushteve të shërbimit, si dhe intervistimi dhe fillimi i përzgjedhjes së kandidatëve, siç do të gjykohet e përshtatshme.
- Kualifikimi dhe trajnimi i stafit

## Monitorimi

Ky seksion përcakton në nivel strategjik, veprimet që duhen bërë për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të këtij Plani të Integruar Menaxhimi, si dhe të ndërhyrjeve

konservative dhe të emrgjencës në pallat dhe në park.

Këto veprime reflektohen në tabelën e mëposhtëme, duke u klasifikuar sipas objektivave të listuar e parashtruar nga ky PMI.

| Objektivi | Treguesit kyç | Të dhënat bazë | Të dhënat e monitorimit | Rezultatet e dëshiruara |
|---|---|---|---|---|
| Konservimi dhe restaurimi i vlerave artistike dhe arkitektonike, duke patur prioritet ruajtjen e vlerave të pasurisë të veçantë të AHPB | Gjendja e objekteve arkitektonikë, mobiljeve, artifakteve dhe elementeve dekorative | Vlerësimet e ekspertëve<br>Vrojtime për gjëndjen | Matje dhe ekzaminime periodike nga ekspertë të nënkontratuar. Në përiudhën e parë 3 vjecare, këto matje dhe ekzaminime bëhen cdo 3 muaj, më pas cdo 6 muaj | Konservim dhe restaurim i AHPB dhe i objekteve me vlerë. |
| Katalogimi i të gjithë vlerave artistike të interierit duke krijuar një databaze që do të shërbejë për konservimin e restaurimin në vazhdimësi. | Katalogimi i vlerave artistike dhe artefakteve. | Rilevime dhe fotografime të objekteve sipas tipologjisë | Krijimi i grup kategorive të vlerave të kataloguara , të azhornuara çdo muaj | Përpilimi i databazës në kategori sipas tipologjive<br><br>Hedhja e të dhënave në faqen ëeb për konsultim virtual |
| Konservimi dhe restaurimi i vlerave të Parkut të AHPB duke ruajtur origjinalitetin e tij. | Gjendja e objekteve dekorative, skulptura, elemente të mobilimit urban, rrugëve, bimësisë | Vlerësimet e ekspertëve<br><br>Vrojtime për gjendjen | Matje dhe ekzaminime të çdo 6 muajve nga ekspertë të nënkontraktuar | Konservimi, reduktimi i domosdoshmërisë për ndërhyrje restauruese në park |

| Objektivi | Treguesit kyç | Të dhënat bazë | Të dhënat e monitorimit | Rezultatet dëshiruara |
|---|---|---|---|---|
| Aksesibiliteti dhe vendosja në funksion të vizitorëve duke e kthyer në një pikë atraktive të qytetit. | Rritja e numrit të vizitorëve<br><br>Anketime mbi përshtypje të vizitorëve | Numri i vizitorëve<br><br>Kërkesat për vizita në grup | Të ardhurat nga biletat dhe nga aktivitetet e organizura e sit. | Rritja e numrit të vizitorëve.<br><br>Rritja e kërkesës për të kryer aktivitete në AHPB |
| Menaxhimi konservativ nëpërmjet drejtimit e organizimit të flukseve të lëvizjes në pallat dhe park. | Gjendja e ambjenteve të interierit dhe të parkut. | Numri i vizitorëve në raport me konsumin dhe dëmet e ambjenteve, ritmet e ndërhyrjeve restauruese të ambjenteve | Vlerësimi i përjavshëm i sjelljes së papërshtatshme dhe dëmtuese ndaj ambjenteve të interierit dhe parkut | Përmirësim real i sjelljes ndaj mjedisit, Konservimi dhe Ruajtja e vlerave të AHPB |
| Katalogimi i vlerave artistike dhe artefakteve. | Katalogimi i vlerave artistike dhe artefakteve. | Rilevime dhe fotografime të objekteve sipas tipologjisë | Krijimi i grupkategorive të vlerave të kataloguara, të azhornuara çdo muaj | Përpilimi i databazës në kategori sipas tipologjive<br><br>Hedhja e të dhënave në faqen ëeb për konsultim virtual |
| Menaxhimi i databazës së katalogimit në funksion të pubikut të gjërë, apo të specializuar | Krijimi sektorëve në arkitekturën e faqes ëeb<br><br>Klikimet në këto sektorë | Vlerësim i ekspertëve të Katalogimit dhe i ekspertëve IT | Të dhëna të kontrollit çdo mujor për sasinë e klikimeve, dhe katalogëve të krijuar dhe konsultuar | Rritja e klikimeve në kategoritë e vizitave virtuale.<br><br>Rritja sasisë së guidave virtuale dhe audiovizuale të përdorura nga vizitorët gjate vizitave në sit |

| Objektivi | Treguesit kyç | Të dhënat bazë | Të dhënat e monitorimit | Rezultatet e dëshiruara |
|---|---|---|---|---|
| Krijimi i zonës së parkimit dhe evidentimi i mënyrës së arritjes në të | Rritja e kënaqshmërisë së vizitorëve /përdoruesve. | Anketim dhe opinione të vizitorve. | Rezultatet e anketimit cdo 6 muaj, të vizitoreve dhe stafit | Shtimi i vizitorëve që vijnë me makina<br>Shtimi i vizitorëve nga zona të largëta |
| Krijimi e riorganizimi i infrastrukturës së aksesimit dhe lëvizjes në brendësi të parkut dhe pajisja me sinjalistikë treguese në shërbim të vizitorëve duke u kujdesur për menaxhimin e problemeve të lidhura me turizmin. | Numri i aksidenteve, nivelet e kënaqshmërisë së vizitorëve, | Monitorimet e shpeshta të situatave gjate vizitave sidomos ne grup | Rishikimet vjetore të praktikave të punës, niveleve të kënaqshmërisë së vizitorëve, numrit të aksidenteve të regjistruara dhe të tjera si këto. | Përmirësimi i shërbimeve dhe rregullimeve të aksesit, zero aksidente, vizitorë të kënaqur.<br>Eleminimi i barrierave arkitektonike. |
| Përfshirja e komunitetit profesionist të fushës dhe të specializuar në proceset e restaurimit të vlerave arkitektonike, artistike, të interierit dhe të parkut. | Numri i praktikantëve dhe studiuesve te ardhur ne AHPB<br>Numri i projekteve dhe aktiviteteve kërkimorë të organizuar | Të dhëna të rasteve të ngjashme nga vënde të tjera | Monitorim dhe evidenca të mbajtura çdo 6 muaj | Pjesëmarrje e komunitetit të studiuesve dhe organizimi i ëorkshopeve, seminareve e konsultave në fushat përkatëse të ekspertizës.<br>Krijimi i një funksioni didaktik në AHPB |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Krijimi i laboratorit, qendrës studimore e të restaurimit të elementeve të arredimit të interierit, të specializuar në stilistikën e periudhës së modernizmit të fillim viteve 1900 në Shqipëri (mobilje, elemente të tekstilit, elemente të arredimit, ndriçues, etj) | Krijimi i ambjentit ku bëhen restaurimet e elementëve të pallatit.<br><br>Pjesëmarrës ekspertë të jashtëm | Mobilje, elementë arredimi, tekstili e ndriçues të restauruar. | Krijimi evidencave për elementet e restauruar.<br>Evidenca të mbajtura çdo 6 muaj, mbi pjesëmarrjen në projekte kombëtare ndërkombëtarë.<br>Të ardhurat nga pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare | Krijimi i specialistëve të përhershëm që punojnë në pallat. Afrimi i specialistëve të jashtëm, me pjesëmarrje të përkohshme.<br>Krijimi i të ardhurave nga pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare |
| Krijimi i laboratorit të bimëve, në të cilin botanistë e arkitektë të parkut të eksperimentojnë, projektojnë, planifikojnë e aplikojnë bimë nga më të ndryshmet, duke u kthyer si një kopësht botanik dhe një vend eksperience për studentë botanistë apo arkitektë pejzazhistë në formim. | Krijimi i ambjentit ku vendoset laboratori<br>Pjesëmarrja e ekspertëve të jashtëm | Të dhënat mbi mënyrën e funksionimit të laboratorit | Evidenca të mbajtura çdo 6 muaj, mbi pjesëmarrjen e ekspertëve dhe praktikantëve, pjesëmarrje në ëorkshope apo në projekte kombëtare e ndërkombëtare.<br>Të ardhurat nga pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare | Krijimi i specialistëve të përhershëm që punojnë në pallat. Afrimi i specialistëve të jashtëm, me pjesëmarrje të përkohshme.<br>Krijimi i të ardhurave nga pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare |
| Krijimi i programeve edukuese për fëmijë, në funksion të njohjes së vlerave pejsazhistike të parkut dhe aplikimit në parcela të vogla eksperimentale, nën drejtimin e kopshtarëve të specializuar, dhe më pas aplikimi i | Numri i praktikantëve dhe kurseve te ofruara<br><br>Fillimi i Krijimit të kopshtit botanik | Evidencë e kurseve dhe praktikave.<br>Evidencë çdo mujore | Evidencë ekurseve dhe praktikave.<br>Evidencë çdo mujore | Afrimi i nxënësve me vlerat e trashëgimisë artistike e pejzazhistike<br><br>Krijimi i një funksioni didaktik në AHPB |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| njohurive të fituara në pjesë të tjera të parkut | | | | |

| Objektivi | Treguesit kyç | Të dhënat bazë | Të dhënat e monitorimit | Rezultatet e dëshiruara |
|---|---|---|---|---|
| Krijimi i funksioneve të reja në pallat, (vizita të oganizuara në grupe, salle ekspozite, salle mbledhje, akomodim hotelerie ekskluzive, strukture didaktike në funksion të eksperiencave konservuese dhe restauruese) | Numri i vizitave,<br>Numri i aktiviteteve. | Informacion mbi statistika të rasteve të ngjashëm | Evidenca cdo 3 mujore, | Rritja e të ardhurave,<br>Frekuentimi sa më i madh i AHPB |
| Krijimi i një sistemi menaxhimi bashkëkohor nëpërmjet një aplikacioni softëare, në të cilin të përfshihen të gjithë elementet e nevojshëm, duke filluar nga shitja e biletave, kontrolli hyrje daljeve, informacioni për turistët dhe stafin | Krijimi i aplikacionit | Të dhëna nga eksperienca të ngjashme | Vlerësim cdo javor deri në përfundim të prodhimit të aplikacionit | Lehtësimi i planifikimit dhe menaxhimit të vizitorëve<br>Rritja e numrit të vizitorëve |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Krijimi i një databaze, arkivë dokumentash, që të dokumentojë dhe menaxhojë pasurinë e vlerave arkitektonike, artistike, mjedisore etj, të Pallatit dhe Parkut të tij. (Museum Integrated Information Management Systems) | Krijimi i databazës, dhe lehtësia e menaxhimit. | Anketim i punonjësve të administratës | Vlerësimet vjetore. | Rritja e performancës në menaxhim dhe ruajtja e fondit të pasurisë së luajtshme të pallatit dhe parkut |



# 10. SHTOJCAT

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

- Krijimi i zonës së pritjes për vizitorë dhe infrastrukturës në shërbim të tyre (biletari, shërbim, rekreacion)

Godina në hyrje të AHPB propozohet të përshtatet për këto funksione








**Vendodhja e funksioneve të shtuara në AHPB**

- **Funksione të reja**

Qendra rekreative ne Park. **Strukturë ristorative për degustim specialitetesh** pranë baseneve ujorë të parkut.

Dizniveli i terrenit favorizon parashikim edhe të **ambjenteve ipogjee**, të cilat do rrisin sipërfaqe pa impaktuar pejzazhin.






- **Funksione të reja**

**Salla ekspozite** të përhershme dhe përkohshme.

**Sallë konference ipogjee** në pallat dhe në park (hapësira rekreative apo ceremoniale).

Pallati ka sot ambjente që mund të shfrytëzohen për këtë qëllim







## ➢ Funksione të reja

**Struktura të qëndrueshme rekreative** në park.

Pjesë e vlefshme për vendodhje të këtyre funksioneve gjendet në anen qendrore dhe perëndimore të parkut në afërsi të serave dhe baseneve ujorë, si dhe në **afërsi të stallës** dhe **shtëpisë së bujkut,** duke ofruar **kushte pejzazhistike** për këto funksione të lidhura me publikun.








- **Funksione të reja**

Krijohet **laboratori i bimëve dekorative**. Në hapësirat e parkut, të cilat duhet të jenë të lulëzuara në çdo kohë, mund të krijohet mundësia e **eksperimentimit** të tipeve të ndryshme të luleve në përshtatje me stinët e vitit, diellëzimin apo hijen, lagështirën apo tokën e thatë.



Këto kushte krijojnë mundësinë perfekte të krijimit të një laboratori të bimëve dekorative, në të cilin botanistë e arkitektë të parkut të eksperimentojnë, projektojnë, planifikojnë e aplikojnë bimë nga më të ndryshmet, **duke u kthyer** si një **kopësht botanik** dhe një vend **eksperience për studentë botanistë apo arkitektë pejzazhistë në formim.**



## Funksione të reja

Krijohet **laboratori i restaurimit të mobiljeve historike**. Pallati i Brigadave ruan akoma mobiljet e paisjet e interierit të projektuara nga ark. Gherardo Bosio, të cilat tashmë thuajse 80 vjeçare, kanë nevojë të restaurohen.



Ky sfond i pasur objektesh arti duhet të bëhet **i pari laborator** i restaurimit të mobiljeve historike **në Shqipëri,** i cili mund të përdoret si një **qendër kerkimore e didaktike** për restauratorët e fushës.

Ambjentet tek **ish centralit termik**, (200 m2) duke qenë jo larg nga pallati, parashikohen të kthehen në hapësira restaurimi të mobiljeve





- **Funksione të reja**

Krijohet ndarja e qartë e ambjenteve të **Gardës së Republikës** nga ato të parqeve të Pallatit.




Sot ambjente dikur të përdorura nga rojet që i shërbenin mbretërisë, përdoren nga Garda e Republikës dhe zyrat e administratës së saj. Me vënien në eficencë turistike të kompleksit të pallatit mbretëror, rekomandohet **riorganizimi i ambjenteve të Gardës,** për të mundur që disa prej tyre, të kthehen në zyra administrate dhe dhe të qendrave kërkimore që propozohen.





- **Funksione të reja**

Funksion **akomodues** në katin +2.

6 nukle dhomë+nyje sanitare dhe 2 nukle, tip suitë,
Do të shërbejnë për akomodim rezervuar për delegacione
dhe  të ftuar të nivelit të lartë qeveritar.








## ➢ Funksione të reja

Krijohet vendi **parkimi për vizitorët.** Në pamundësi për të parkuar në hyrje të kompleksit, gjë që **do të prishte perceptimin mbretëror që është qëllim të ruhet,** për të do të planifikohet që parkimi i mjeteve të mund **të bëhet në një zonë verilindore** të parkut, duke shfrytëzuar një hyrje tjetër nga ajo ceremoniale. Propozohet hyrja që sot përdoret nga Garda e Republikës.

Hapësira mes **Godinës në hyrje** dhe **qendrës së komandos** propozohet të kthehet në parkim
Plani i menaxhimit propozon **Konceptin e monitorimit** dhe **menaxhimit inteligjent te parkimit.**









➢ Krijohet **harta e pallatit** me ndarjet sipas ambjenteve të vizitueshme, me shpjeguesin e funksioneve në kohën e ndërtimit.

Harta në **mënyrë të kuptueshme** duhet të drejtojë vizitorin në ambjentet e Pallatit, dhe të shërbejë edhe si një **vizitë virtuale** në të.

Shembull Reggia di Caserta, Itali



- Krijohet **harta e parkut** me pikat e interesit. Në skemën kompozicionale të parkut, shpjegohen konceptet e parimet e huazuara nga arkitektura e parqeve të tipit francez apo të tipit anglez e Italian.

Një **itinerar** i përcaktuar shoqëron vizitorin në hapësirat e tij, duke i dhënë mundësi ta perceptojë atë nga pika të ndryshme shikimi.

Shembull Reggia di Caserta, Itali



- Krijohet **harta e veprave të artit**, skulpturave.

Nje **itenerar** i përcaktuar në hartë do të mund të drejtojë vizitorin si në një **guidë turistike,** përmes hapësirave ku do të gjejë veprat e artit, skulpturat dhe shatërvanët.

Në secilën prej tyre do të shpjegohet alegoria artistike që mbart, duke i kthyer si fragmente të një **narracioni në natyrë.**

Shembull kopshtet Bobboli, Itali



- Krijohen **ambjente të përshtatshme për pushim të vizitorëve**.

Në hapësirat e parkut gjendet mundësia për të ndërtuar përmes **strukturave të lehta** të mobilimit urban, vënde për shplodhje.

**Vëndvendosja** e tyre duhet **të studiohet** mirë për të gjetur hapësirën më të përshtatshme për një aktivitet të dyfishtë, **qëndrim shplodhje** dhe **pasurim me informacion**.







- **Guida AudioVizuale** në shërbim të vizitorëve. **Materiale fotografike** të arkivave dhe fotografi të kohës së sotme, sigurisht pas restaurimit, do të bëhen **pjesë e një guide** arkitektonike që duhet të shoqërojë vizitorin gjatë vizitës në pallat dhe gjatë vizitës në park.



Plani i menaxhimit rekomandon edhe Konceptin e sistemit automatik te guidës audio vizive dhe krjimin e **faqes web** të Komleksit arkitektonik.





➢ Krijimi e riorganizimi i **infrastrukturës së aksesimit** dhe asaj **lëvizjes në brendësi** të parkut dhe pajisja me sinjalistikë treguese në shërbim të vizitorëve, duke u kujdesur për menaxhimin e problemeve të lidhura me flukset e levizjeve dhe barrierat arkitektonike.



# KATI "PODRUM"

**GJËNDJA EKZISTUESE**

**PLANI I KATIT – PODRUM - NDARJA E AMBJENTEVE**



| Ambjenti D-01 (Garderoba) | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |    |

**Përshkrim i shkurtër:** Garderoba ne katin e podrumit.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale:** Muret e lyer me hidromat. Ka rënie suvaje pjesërisht (Suva e dëmtuar në masën 5 %)

Dysheme e shtruar me mermer 58x58 cm (ngjyrë vishnje dhegri) – ka thyerje dhe plasaritje të pllakave në masën 30 %

Dyert h=215 cm (materiali i drurit në pjesët fundore është i dëmtuar, hapen dhe mbyllen me vështirësi) – duhet të restaurohen

Muret e ambjentit janë të veshur me dru deri në lartësinë 210 cm – veshja është e dëmtuar pjesërisht në pjesën fundore të saj.

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti D-02/1, D-02/2, D-07 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  | D-02/1    D-02/2    D-07    D-31 |

 

**Përshkrim i shkurtër:** Hyrja ne objekt ne katin e podrumit dhe korridori.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale : (D-02/1)** Muret janë lyer me hidromat (ka prezencë lagështie në bazament)
Dysheme mozaik bezhë 40x40 cm, puseta kontrolli (metalike +dru)
Derë 4 kanata, 2 të palëvizshme (dru+xham), h= 215 cm
Ka tubacione hidraulike të dukshme

**(D-02/2)** Muret + tavani të lyera me hidromat (suva e dëmtuar – e plasaritur, në pjesën fundore në masën 30 % - duhet kruajtur)
Qoshet e mureve të veshura me element druri të harkuar (të dëmtuara pjesërisht)
Dysheme e shtruar me mozaik bezhe 40x40 cm (të dëmtuara në masën 40 % me thyerje dhe plasaritje)
Dysheme mermer bezhe 80x60cm
Ka puseta kontrolli në dysheme (me kapak metalik)
Lloj tjetër pllakash në mes të korridorit – pllaka travertine (ngjyrë gri me bezhë) 80x60 cm – 12 pllaka →4 pllaka të dëmtuara të thyera, 2 dyer që lidhin këtë ambjent me D-03 (kabina elektrike) 205x76 cm (në gjendje relativisht të mirë)
Dera që ndan D-02 dhe D-31 – 240x217 cm, Dera që ndan D-07 dhe D-02 – 240x217 cm

**D-07** Muret + tavani të lyera me hidromat (Dëmtime të suvatimit në masë të konsiderueshme)
Dysheme e shtruar me pllaka mermeri (ngjyrë të bardhë dhe gri) 40x40 cm
Dy dyer kryesore
Derë druri me 4 kanata me xham në mes (e lyer me ngjyrë të bardhë) – kasa e dëmtuar
Derë druri masiv (215x170 cm) – komunikon me ambjentin e jashtëm direkt – (shumë e dëmtuar nga jashtë, ka nevojë për restaurim, shkalla e dëmtimit mbi 50 %)

**D-31** Muri+ tavani – lyerje me hidromat (katubacionehidraulike)
Kaprezencëlagështienëbazamenttëmureve(20 % suva e dëmtuar)
Në ambjent ka puseta kontrolli + kaseta elektrike
Dysheme mermer mozaik bezhë 40x40 cm
Lartësia e dyerve në korridor → 215 cm (qoshet e harkuara me elemente druri)

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti D-03 (Kabina Elektrike) | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |     |

**Përshkrim i shkurtër:** Kabina elektrike ne katin e podrumit.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale :** Muret janë të veshur me teserina boje qiellih=200 cm
Pjesa tjetër+ tavani të lyera me hidromat
Dysheme e shtruar me linoleum

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti DS-02, DS-03 (Shkalla) | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  | DS-02<br>  <br>DS-03<br>   |

**Përshkrim i shkurtër:** Ambienti i shkalles nodhet ne pjesen perendimore te podrumit.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale : DS-2** Shkallët që të ngjisin në katin përdhe veshje pllakë mermeri bezhë.
Prezencë lagështie në pjesën fundore në fillim të saj që vjen nga bodrumi.
Lyerje me hidromat,suva e dëmtuar në masën 10 %.

**DS-3** Muret + tavani në gjendje të mirë (ka nevojë për lyerje)
Dysheme e shtruar me pllaka mermer të bardhë
Dera druri në gjendje të mirë (vetëm të lyhet)

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti D-04 (Magazina) | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |     |

**Përshkrim i shkurtër:** Magazina e katit te prodrumit pozicionohet prane shkalles DS-02.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale :** Muret kanë veshjeteserina boje qielli  - h=220 cm
Pjesa tjeter e mureve + Tavani → lyerje plastiko (ka shkeputje shtresa e bojes, duhet kruar e gjitha)
Dysheme mermer bezhë  40x40 cm
Dritare druri 150x160 cm (1 Dritare) ... shih skicën...
Kasetë për grilë brenda 30x25 cm (material metalik)
Grila nga jashtë
Derë e thjeshtë druri 1 kanat 95x220 cm – lyer me boje plastike
Gjerësi kase 15 cm
Dera që lidh dy ambjentet D-04 mungon.
Nuk ka prezence lageshtie.

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti DS-04 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |   |

**Përshkrim i shkurtër:** Shkalla e ambientit D-34.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale :** Muret + tavani të veshura me teserina bojë qielli (i dëmtuar në masën 10 %)
Shpatullat e hyrjes në shkallë dhe shkeljet e shkallëve të veshura me mermer bezhë
Ka derë të thjeshtë druri me një kanat për hyrjen në shkallë

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

Ambjenti D-05 (Dhoma)

| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
| --- | --- | --- |
|  |  |    |

**Përshkrim i shkurtër:** Dhoma prane shkalles.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale :** Muret + tavani → lyerje plastiko (prezencë lagështie në muret që kanë faqe jashtë – tavani 30%)
Shkëputje e suvasë 30 % - kruajtje e bojës
Dysheme e shtruar me mermer bezhë 40x40 cm
3 Dritare druri kasë binari, dru masiv (shpatulla me suva, tek xham) 136x127 cm... shih skicën...
Kasetë grile nga brenda (dru)
Grila nga jashtë (në gjendje të mirë)
Dera kasë druri (dru + xham) 1 kanatë 125x95 cm... shih skicën...
Qoshet e dyerve / dritareve vishen me elemente të harkuar druri (qoshe të harkuara)

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

Ambjenti D-06 (Dhoma)

| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
| --- | --- | --- |
|  |  |       |

**Përshkrim i shkurtër:** Dhoma prane shkalles.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale :** Prezencë e lartë lagështie (muret + tavani)
Dyshemeja pa pllaka e shtruar me linoleum të dëmtuar
Muret të lyer me plastiko dhe rrjetë (përbërje si litar, thes, telajo) e dëmtuar në masën 80%.
Ka kalorifer
Dritaret dru 130x127 cm + kaseta e grilës 17 cm. Nuk funksionojnë por materiali i padëmtuar.
Grilat në gjendje jofunksionale... shih skicën...
Dera dru+xham e dëmtuar mosfunksionim me kasë të dëmtuar.Xhama dekorativë – ka mundësi restaurimi.

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti D-08, D-09 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |    |

**Përshkrim i shkurtër:** Korridor.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale :** Muret + tavani të lyera me hidromat (Suvatim i dëmtuar në masën 70-80%)
Ka kabinë elektrike
Faqe muri në formë harku. Harku material kompesatë i lyer me hidromat
Dysheme e shtruarme pllaka mermer mozaik bezhë 40x40 cm
Dyer druri të dëmtuara në pjesën fundore

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

<table>
<tr><td colspan="3">Ambjenti D-19, D-20</td></tr>
<tr><td>Pozicioni</td><td>Planimetria</td><td>Fotografi</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="3">Përshkrim i shkurtër: Dhomat e personelit.<br><br>Ndërhyrjet e konservimit:<br><br>Gjendja aktuale : Suvatim komplet / Lagështi e theksuar<br>Dysheme e shtruar me pllaka mermer mozaik bezhë 40x40 cm<br>Dollapët e murit mungojnë ose janë shumë të dëmtuar<br>3 nga dyert mungojnë , 3 nga kasat të dëmtuara 100 %<br>Dyert e tjera duhen restauruar, mungojnë dorezat<br>Dritaret janë dopio (grila të dëmtuara komplet në masën 80-100%)<br>Dritarja fundore të ruhet por të restaurohet, poshtë – kompesata e ngrohjes 100% e dëmtuar.<br>Pragjet e dhomave material druri nga brenda (i dëmtuar) dhe beton nga jashtë.<br><br>Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI<br>-</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kategoria 1– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="3">Ambjenti D-15, D-21, D-22</td></tr>
<tr><td>Pozicioni</td><td>Planimetria</td><td>Fotografi</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td>D-15<br><br>D-21, D-22<br></td></tr>
</table>

**Përshkrim i shkurtër:** Tualetet.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale : D-15** Ky ambjent ka vaskë dhe ambjent dushi
Grilat e dëmtuara komplet
Dyshemeja e veshur me teserina bojëqielli

**D21, D-22** Muret deri në h=180 cm + dyshemeja të veshura me teserina (ngjyrë bizele dhe lejla) – i dëmtuar në masën 50 %
Dritare druri të dëmtuara në masën 30 %
Dyer dru kompesatë të dëmtuara kryesisht në pjesët fundore në masën 50 %
Hidrosanitare, grupet e rubinetave, dushi - të dëmtuara

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

-

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti D-24, D-26 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |  |

**Përshkrim i shkurtër:**

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale :** Dysheme pjesërisht mermer, pjesërisht llustër çimento, pjesërisht kanale elektrikë mbuluar me pllaka betoni. (instalime tension i lartë)
Suva degraduar komplet
Dritare

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

-

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti D-25 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |     |
| **Përshkrim i shkurtër:** Kaldaja<br><br>**Ndërhyrjet e konservimit:**<br><br>**Gjendja aktuale :** Dysheme pjesërisht mermer, pjesërisht llustër çimento, pjesërisht kanale elektrikë mbuluar me pllaka betoni. (instalime tension i lartë)<br>Suva degraduar komplet<br>Dritare<br><br>**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**<br>- | | |
| **Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme | | |

| Ambjenti D-27/1, D-27/2, D-28 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  | D-27/1<br>  <br>D-27/2<br>    <br>D-28<br>    |

**Përshkrim i shkurtër:** Ambientet e magazines ne katin e podrmit.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale : AmbjentiD-27/1** Dysheme mermeri mozaik bezhë 40x40 cm
Muret + tavani lyer me hidromat e dëmtuar komplet (suva 20 %)
Derë druri me 2 kanata – bazamenti i dëmtuar nga lagështia
Derë druri me një kanatë

**AmbjentiD-27/2** Instalime Elektrike (tip central)
Tension i lartë
Derë metalike
Derë druri me një kanatë

**Ambjenti D-28 (Magazinë)** Dysheme mermer mozaik bezhë 40x40 cm
Muret + Tavani janë të lyera me bojë vaji (duhet kruajtur)
Në njërën qoshe ka lavaman (në këtë pjesë në mur ka veshje me teserina bojë qielli 185x185 cm)
Faqja e murit përballë derës së hyrjes ka prezencë lagështie – pjesa tjetër e thatë
Derë druri me 2 kanata 136x216 cm – dy dritare me rrjetë teli 40x20 cm (e dëmtuar doreza, kasa, rrjeta)... shih skicën...
Derë druri me 2 kanata (dru + xham + rrjetë teli) 145x220 cm...
Derë komunikuese me pastiçerinë D-29 një kanatë dru+ xham

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

-

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti D-29/1, D-29/2, D-29 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  | D-29/1  D-29/2  D-29  |

**Përshkrim i shkurtër:** Ambientet e pasticerise ne katin e podrumit dhe sottoscala.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale : D-29/1** Muret me veshjeme teserina bojë qielli h=220 cm (30 % e dëmtuar)– pjesatjetër + tavanilyerje me hidromat
Kakabinë elektrike
Dysheme e shtruar me teserinablu
Kalavamanë + tubacione hidraulike dhe boljer
3 dyer - h=217 cm
Derëdrurikasëbinari e thjeshtë me 1 kanatë
Derëdruri 2 kanata (njëra e ndarënë 2 pjesë në lartësi)
Derëdruri + xham me 2 kanata
Kasat e drurit janë të dëmtuara nga lagështia në bazament
**D-29/2** Në mure (faqja ballore) ka veshje me pllaka majolike të bardha h=165 cm (pjesërisht të thyera)
Presencë e theksuar lagështie – shkëputje e suvasë 50 %
Dysheme pllaka granili 40x40 cm
Dritaredruri – 3 kanata (doppio dritare)...
**Ambjenti D-29 (Sottoscala)** Muri I lyer me gëlqere (prezencë e theksuar lagështie-suva komplet)
Dysheme mermer mozaik bezhë 40x40 cm
Derëdruri e thjeshtë (mungon dera)

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti D-32 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |  |

**Përshkrim i shkurtër:** Ambientet e frigoriferit.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale : Ambjenti D-32 (Frigoriferi)**
Muret veshje me teserina gri me të bardhë– Tavani plastiko
Dysheme mermer mozaik bezhë 40x40 cm
2 dyer druri masiv me njëkanatë
1 derë me dy kanata me dritare me rrjetë teli

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

Ambjenti D-33 (DIS)

| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
| --- | --- | --- |
|  |  |  |

**Përshkrim i shkurtër:**

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :

**Ambjenti D-33(DIS)**
Muret + tavanitëlyera me hidromat(suvatimi 5-10 % idëmtuar)
Dysheme me pllakagranili 40x40 cm (si D-29/2)

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti D-34 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |     |
| **Përshkrim i shkurtër:** Ambjent zyre.<br><br>**Ndërhyrjet e konservimit:**<br><br>**Gjendja aktuale** :<br><br>**Ambjenti D-34 (Zyra)**<br>Muret të veshur me teserina bojë qielli (h=230 cm)<br>Pjesa tjetër e mureve+ Tavani të lyer me hidromat<br>Dysheme e veshurme teserina blu<br>Përballë hyrjes – Dritare druri + xham+ kasetë grilash h=30 cm (dritare me mekanizëm 202x163 cm me pajisje aspirimi)<br>Ambjenti ka dy ashensorë shërbimi (jo-funksionalë)<br>Ka lavamanë dhe një pjesë muri të veshur me pllaka majolike të bardha<br><br>**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI** | | |
| **Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme | | |

| Ambjenti D-35 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |       |

**Përshkrim i shkurtër:** Magazina.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :

**Ambjenti D-35 (Magazina**)

Muri+ tavani→lyerje plastiko– 20 % shtresa e bojës + suva e degraduar(dy faqe anësore me tulla xhami)

Dysheme mermeri mozaik bezhë 40x40 cm

Derë druri e thjeshtë (mungon dera)

Derë me sopraluçe me një kanatë (dru +xham+rrjetë teli)

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti D-36/1, D-36/2, D-37, D-38 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |   <br>D-36/1<br><br>D-36/2<br><br>  |

**Përshkrim i shkurtër:** Magazina.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :
**D-36/1**
Muret + Tavani lyer me plastiko
Dysheme mermeri mozaik bezhë40x40 cm
Dyer druri kasë binari me një kanatë, me sopraluçe rrjetë teli

**D-36/2**
Nuk ka informacion.

**Ambjenti D-37**
Mure të lyera me hidromat, Suvatimi degraduar në masën 50%
Dysheme me mermer mozaik bezhë 40x40 cm
Dyer druri relative isht në gjendje të mire
Dritare druri (pjesa e interkapetit) – kanë nevojë për restaurim

**Ambjenti D-38**
Mure të lyera me hidromat, Suvatimi degraduar në masën 50%
Dysheme me mermer mozaik bezhë 40x40 cm
Dyer druri relativisht në gjendje të mire
Dritare druri (pjesa e interkapetit) – kanë nevojë për restaurim

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti D-39, D-46 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |    D-39    D-46   |

**Përshkrim i shkurtër:** Korridoret per ne lavanteri.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :

**Ambjenti D-39 (Korridori për në lavanteri)**

Mure të lyera me hidromat, ka 3 nike në mur(Suva e dëmtuar në pjesën fundore të mureve n ëmasën 60 % -shtresat e sipërme nga lagështia)

Dera, kasa që lidh korridorin dhe të shpie në lavanteri eshtë shumë e dëmtuarnë pjesën fundore, duhet zëvendësuar (85x217 cm)

Dysheme e shtruar me pllaka mermeri mozaik bezhë 40x40 cm.

Prezencë tubacioni në tavan dhe kabinë elektrike.

**Ambjenti D-46 (Korridori I dytë)**

Mure të lyer me hidromat (Suvaja e dëmtuar në pjesën në masën 50 %)

Njëra faqe e veshur me tulla xhami dhe paret druri në nivelin 50 cm.

Dysheme e shtruar me pllaka travertine 40x40 cm (prezencë ujrash në dysheme)

Prezencë tubacioni dhe kabine elektrike

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti D-40 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |      |

**Përshkrim i shkurtër:** Kuzhina e ambjentit D-04.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :
Muret kanë veshje me teserina bojëqielli - h=220 cm (30% i dëmtuar)
Pjesa tjeter e mureve + Tavani → lyerje plastiko (ka shkëputje suvaja – 50% suva e dëmtuar)
Ka prezencë lagështie
Ka 3 lavamanë (instalime hidraulike)
Dysheme e shtruar me mermer mozaik 40x40 cm
3 dritare druri me mekanizëm 95x166 cm (njëra ka prag mermeri) ... shih skicën...
Kasetë grile metalike nga brenda
Grila nga jashtë
Ka tuba të dukshëm në tavan
Dera me dy kanata dru dhe xham 135x220 cm (degradim në pjesën e drurit) ... shih skicën...

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

<table>
<tr><td colspan="3">Ambjenti D-41, D-45</td></tr>
<tr><td>Pozicioni</td><td>Planimetria</td><td>Fotografi</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td>       </td></tr>
<tr><td colspan="3">Përshkrim i shkurtër: Kantina.<br><br>Ndërhyrjet e konservimit:<br><br>Gjendja aktuale :<br>Muret (me tulla) + tavani – lyerje gëlqere (Prezencë lagështie – suva e dëmtuar)<br>Dysheme mermer mozaik bezhë 40x40 cm<br>4 dyer (dyert mungojnë) – ka vetëm kasa të dëmtuara<br>Rafte muri (druri) – pa kanata (materiali i drurit i degraduar)... shih skicën...<br><br><br>Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kategoria 1– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="3">Ambjenti D-47</td></tr>
<tr><td>Pozicioni</td><td>Planimetria</td><td>Fotografi</td></tr>
<tr><td></td><td>
</td><td>  </td></tr>
<tr><td colspan="3">Përshkrim i shkurtër: Cisterna e ujit.<br><br>Ndërhyrjet e konservimit:<br><br>Gjendja aktuale :<br>Rrjedhje ujrash, suva e dëmtuar komplet<br>Dysheme me pllaka travertine 40x40 cm<br>Dera e dëmtuar<br><br><br>Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kategoria 1– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="3">Ambjenti D-48, D-49</td></tr>
<tr><td>Pozicioni</td><td>Planimetria</td><td>Fotografi</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="3">Përshkrim i shkurtër: Dhoma e tharjes.<br><br>Ndërhyrjet e konservimit:<br><br>Gjendja aktuale :<br>Mure të veshur me teserina bojëqielli/ blu deri në h=220 cm (në gjendje relativisht të mirë – dëmtime të vogla). Pjesa tjetër + tavani e lyer me bojë vaji (suvaja e dëmtuar në masën 20 %, duhet patinuar e gjitha)<br>Dysheme e veshur me mermer mozaik bezhë 40x40 cm<br>2 dritare druri 100x280 cm (xhama dekorativë të bombarduar të dëmtuar, dritare pjesërisht të dëmtuara – kanë nevojë për restaurim në masën 50 %)<br>Një nga pragjet e dritareve është  i dëmtuar<br>Dera hyrëse dru+xham i bombarduar (pjesërisht e dëmtuar në pjesën fundore, doreza të dëmtuara,)<br>2 dyert që të shpien në lavanteri h=240 me sopraluçe 40 cm. (pjesët fundore të dëmtuara)<br><br><br>Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kategoria 1– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme</td></tr>
</table>

Ambjenti D-50

| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|---|---|---|
|  |  |       |

**Përshkrim i shkurtër:** Lavanteria.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :
Mure të veshur me teserina blu h=220 cm (i dëmtuar në masën 10 %), pjesa tjetër +tavani e lyer me bojë vaji (e dëmtuar në masën 30% - duhet kruajtur e gjitha dhe patinuar e lyer sërish)
Dysheme me pllaka mermer mozaik bezhë 40x40 cm
Prezencë tubacionesh dhe 4 aparatura larëse, tharëse, boljer, kaldajë të kohës së ndërtimit fillestar
Dy vaska larje të veshura me granil të bardhë me cërka gri
2 dritare druri 100x280 cm (shumë të dëmtuara)

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

<table>
<tr><td colspan="3">Ambjenti D-51</td></tr>
<tr><td>Pozicioni</td><td>Planimetria</td><td>Fotografi</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="3">Përshkrim i shkurtër: Ambient per mekanizmin e ashensorit.<br><br>Ndërhyrjet e konservimit:<br><br>Gjendja aktuale :<br>Mure të lyer me hidromat – (shtresa e bojës e degraduar pjesërisht)<br>Dysheme druri<br>Ambjent për mekanizmin e ashensorit<br><br><br>Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI</td></tr>
<tr><td colspan="3">Kategoria 1– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme</td></tr>
</table>

| Ambjenti D-52 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |     |

**Përshkrim i shkurtër:** Korridori i harkuar qe del nga D-05, D-06.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :
Prezencë lagështie (ngjitje kapilare në masën 50 %) dëmtimi i suvasë. Lyerje plastiko e dëmtuar.
Dysheme mermeri mozaik bezhë 40x40 cm në gjendje të mirë.
Dera druri me një kanatë 95x215 cm relativisht në gjendje të mirë por mungesë doreza dhe materiali i drurit i dëmtuar në pjesën fundore të kasës.

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti D-53, D-54 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  | D-53  D-54  |

| |
|---|
| **Përshkrim i shkurtër:** Ambjent oborri i i rrethuar me fasadë dhe i pa mbuluar.<br><br>**Ndërhyrjet e konservimit:**<br><br>**Gjendja aktuale** :<br>**D**-53<br>Suvatim i degraduar në masën 50 %<br>Dyer dritare – mungojnë<br>**D-54**<br>Prezencë lagështie (nga soleta – nevojë për hidroizolim)<br>Suvatimi i jashtëm i degraduar (suvatim, lyerje)<br>Dritare druri (materiali i drurit i degraduar)<br>Për ambjentin e brendshëm nuk ka informacion<br><br><br>**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI** |
| **Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme |

**GJENDJA DHE NDERHYRJET E PARASHIKUARA**

***KATI PERDHE***

**PLANI I KATIT PERDHE - NDARJA E AMBJENTEVE**



| Ambjenti A-01, A-01/1 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |  |

**Përshkrim i shkurtër:** Ambjent I hyrjes.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :

SHKALLET dhe sheshpushimi janë ndërtuar prej mermeri ngjyrë bezhe. Ballore e sheshpushimit kanë pësuar devijime prandaj duhet çmontim dhe rivendosje e pllakave . Duhet te zëvedësohen 5 pllaka (127x60x14 cm),me kornize ne ane . Pllakat,ne dysheme me përmasa 40x40 janë për tu zëvendësuar ne masën 4m2. Balloret kanë përmasa 65x55x7 cm. mermer ngjyre bezhe.
PORTA hyrëse e ndërtuar prej dru masiv, kornize bronzi dhe tëmtha bronzi dekorative. Ka nevojë për trajtim me solucion anti ksilofag dhe freskim i lyerjes . Dyshemeja është e shtruar me pllaka mermeri bezhe me ujera lineare. Përmasat 83x73 cm. te dëmtuara me plasaritje ne masën 1.5m2.
Ne tavanin e hyrjes ndodhet sipas informacionit një pikture murale e mbuluar qe ka nevojë për evidentim.

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti A-02 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |  |

**Përshkrim i shkurtër:** Ambjenti I hollit kryesor.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :
Holli kryesor kërkon trajtim për te gjitha dyert qe te lidhin me sallat dhe ambientet e shërbimit .. Domosdoshmëri lyerja e tavanit dhe faqeve të muraturës.

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti A-04, A-05 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |   |

**Përshkrim i shkurtër:**

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :
**A-04**
Dyert ne hyrje duan trajtim sepse kane shenja dëmtimi nga brejtës. Dritare korniza prej druri me mekanizëm metalik për hapje-mbyllje. Parapeti dhe kabina e kaloriferit te dëmtuar . Dritarja ka nevoje për restaurim, davanciali duhet te zëvendësohet . Dyshemeja ,parket druri e dëmtuar ne masën 30 %(12m2) kurse muret kane veshje druri deri ne lartësinë 210 cm, e dëmtuar ne masën 25% .(11m2)
**A-05**
Veshja e muraturës dhe dyshemeja si ne ambientin A04, dëmtimi rreth 50% e veshjes(5 m2) dritarja ne gjendje te mire. Kërkohet kujdes te siguria e kuadrit te instalimeve elektrike.

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti A-06 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |   |

**Përshkrim i shkurtër:**

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :

Dyshemeja me pllaka mermeri ne gjendje te mire,dritare me mekanizëm metalik manual qe kërkon ndërhyrje për funksionim. Tavani i dekoruar me nevratura vija paralele qe kërkon lyerje te re.

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjentet A-07, A-07/1, A-08, A-08/1, A-09, A-10 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |  A-07,08, 09,10<br>A08/1<br>  |

**Përshkrim i shkurtër:** Ambientet e tualeteve.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :

**A-07/1**

Dera hapet me vështirësi, kërkon riparim. Faqet e murit te veshura me tesera (2x2cm) prej brumi qelqi,ngjyre gri dhe te kaltër,i dëmtuar 20%( 2.5 m2). Dyshemeja e shtruar me mozaik, ngjyre blu me disa nuance te saj, e dëmtuar rreth 15 %(1.2 m2) e sipërfaqes.

**A-07, A-08, A-09, A-10**

Janë pothuajse ne gjendje te mire . Kërkojnë trajtim dritaret dhe dyert. Ambientet e banjave janë te veshura me mermer ndërsa ambientet e para banjave me suva dekorative me nevratura vertikale. E domosdoshme lyerja e këtyre ambienteve.

**A-08/1 (WC)**

Dera kërkon trajtim dhe lyerje , veshja e mureve si A 07/1 e dëmtuar ne masën 20% (1.8 m2). Dritarja kërkon trajtim ne kornizën e saj, davanciali është mermer i bardhe ne gjendje te mire . Kërkohet meremetim suvaje ne masën 5%.(3m2)

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

Ambjentet A-16

| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
| --- | --- | --- |
|  |  |   |

**Përshkrim i shkurtër:**

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :

Veshja e muraturës deri në afërsi te tavanit me dru, kompesatë në ngjyre kafe mat, është ne gjendje te mire ,ndërhyrje restauruese te pjesshme. Tavani me dekor kuadratik ne reliev kërkon stukime dhe lyerje. Dyshemeja pas rashinimit duhet te lyhet me te njëjtën ngjyre dhe shtrese verniku transparent . Dritarja me kornize dhe kanate druri ne gjendje te mire, kurse mekanizmi metalik kërkon riparim .

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjentet A-17, A-17/1 (a,b,c,d) | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  | A-  17  |

**Përshkrim i shkurtër:**

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :

**A-17/1 (a,b,c,d)**

Në këto ambiente spikat veshja e muraturës me material tekstil ne sip ( a ) me dëmtime të pjesshme me pjesët fundore . Lyerja vetëm për tavanet

**A-17**

Ambienti është ne gjendje te mire ka një aneks me sip 4m2, i cili i ka muret veshura me dru deri ne lartësinë 2.2 m ka nevoje për rinovimin te lyerjes se tavaneve dhe mureve

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti A-20 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |   |

**Përshkrim i shkurtër:**

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :
Veshja dhe dyshemeja janë prej druri ngjyre kafe e erret me shkëlqim, dyert drejt verandës janë 2 , me 3 ndarje, 2 kanate druri dhe 1 alumin, kërkojnë ndërhyrje të pjesshme. Dyshemeja e dëmtuar ne afërsi te dritareve ne masën rreth 5 % te sipërfaqes 3m2 . Tavani si A 16 duhet stukim dhe lyerje.

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

Ambjenti A-21

| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|---|---|---|
|  |  |  |

**Përshkrim i shkurtër:**

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :
Tavan me dekoracion rombi te dale ne reliev. Dritare-dere e dubluar dru e alumin. Tre dyer druri kërkojnë trajtim . Dyshemeja me parket druri është e dëmtuar ne 7% te Sipërfaqes.(1.8 m2).

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti A-22 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |   |

**Përshkrim i shkurtër:**

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :
Dyshemeja, mermer me ujera, ne gjendje te mire. Dy dritare me kanate e korniza druri kërkojnë trajtim  e restaurim, kurse mekanizmat metalik duan riparime dhe vajosje. Gjithashtu davancialet e dritareve janë te dëmtuara dhe duhen zëvendësuar  Tre dritare ballkoni ne gjendje te mire ,riparim duhet për grilat e drunjta.Tavani dekorativ ka nevojë për stokarisje dhe lyerje.

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti A-24 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |    |

**Përshkrim i shkurtër:**

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :
Dyshemeja ,mozaik ngjyre blu me kombinim te disa nuancave te saj, 30 % (10m2) e dëmtuar. Gjithashtu dyshemeja ka çeduar ne rreth 4 m2 ku duken edhe plasaritje gjë qe duhet riparuar. Faqet e mureve me mozaik te çelet deri ne lartësinë e derës se A 25 , 10 %(12 m2) e dëmtuar . Tavani i sheshte me kornize anësore, kërkon stukime dhe lyerje . Ne qoshen JP suvatimi i dëmtuar nga lagështia e jashtme dhe patinim I ri rreth 8 m2. Duhet riparim i ashensorëve te transportit te ushqimit.

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

Ambjenti A-25

| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|---|---|---|
|  |  |   |

**Përshkrim i shkurtër:**

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :
Dysheme parket druri , evidentohen ndërhyrje restauruese te mëparshme, nevojitet ndërhyrje tjetër ne 80% te sipërfaqes (30 m2) Tavani dekoracion me dalje ne reliev imitim trarësh. Faqet e mureve dhe tavani patjetër stukime dhe lyerje.

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

Ambjenti A-26

| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
| --- | --- | --- |
|  |  |   |

**Përshkrim i shkurtër:**

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :
Parketi ne gjendje te mire. Faqet e mureve dhe tavani patjetër stukime dhe lyerje.

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

Ambjenti A-27

| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
| --- | --- | --- |
|  |  |     |

**Përshkrim i shkurtër:**

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :
(Holli i Skenderbeut) Parketi i dyshemesë i dëmtuar 30%( 40 m2), ne anën L dhe J, qoshja VL riparim suvatimi . Dyer-dritare ne drejtim te shkalleve ne L te dëmtuara plotësisht. Prezence lagështie ne tavan ne anën L . Kërkohet riparim I grilave te drunjta.

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti A-28 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |       |
| **Përshkrim i shkurtër:**<br><br>**Ndërhyrjet e konservimit:**<br><br>**Gjendja aktuale** :<br>Parketi i dyshemesë i dëmtuar 50% te sip (75 m2). sidomos ne afërsi te dritareve. Te dëmtuara davancialet e dritareve (material drusor), sipër kaloriferëve ,si dhe restaurim i dritareve, riparim i grilave dhe mekanizmave te tyre.<br>**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI** | | |
| **Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme | | |

| Ambjenti A-29 | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria | Fotografi |
|  |  |   |

| |
|---|
| **Përshkrim i shkurtër:**<br><br>**Ndërhyrjet e konservimit:**<br><br>**Gjendja aktuale** :<br><br>Trajtim dhe restaurim i dritareve, Parketi i dyshemesë i dëmtuar 15% te sipërfaqes.(16.5 m2)<br><br>**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI** |
| **Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme |

**PËRSHKRIMI I GJËNDJES EKZISTUESE DHE EVIDENTIMI I PROBLEMATIKAVE NË AMBIENTE.**

***PLANI I KATIT TE PARE, KUOTA +5.60***



| Ambjenti B-01 (Atrium) | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria e katit | Plani i ambientit |
|  |  |  |

**Përshkrim i shkurtër:**
SIP: 158 m2
Lartësi dysheme – tavan: H 3.88 m
Dysheme: PLLAKA MERMERI 50X50cm

Ambient kryesor I katit të I, me të cilin prezantohemi kur vijmë nga shkallët qëndrore të Katit Përdhe dhe nëpërmjet të cilit krijohet komunikimi me ambientet e tjera që janë të përbëjnë këtë kat.

**Problematika:** Gjendja në përgjithësi është e mire, përvec dyshemesë e cila është e përbërë nga pllaka mermeri të thyera dhe të ciflosura në masën 60 %.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :
DYSHEMEJA: Veshur me pllaka mermeri 50x51 cm.Mermer I roz/ me damarë të kuq.
MURET ANËSORE: Të suatuara dhe të lyera me bojë me ngjyrë ( evidentimi I kodit në vend). Sipërfaqet anësore, në pjesët e dyerve dhe hapësirave që lidhin me shkallën qëndrore dhe ballkonin (që shikon në hallin e katit të parë), janë të dekoruara me korniza allcie, me disnivele. Kornizat e allcisë janë të dëmtuara në kënde, nga thyerje nga pakujdesia, etj.

DYERT:
B01 - BALLKON ; B01 – B15 ; Material druri dhe me xham. Elementët e drurit janë të lyer me llak. Në përgjithësi duken në gjëndje të mirë, por pjesë të tyre janë prekur nga mola në masë të konsiderueshme evidente në sipërfaqe.
B01 – B05, B20 Dyert janë të kornizuara me kornizë mermeri 19 -20 cm I gjërë, përvec kornizës së drurit. Dëmtimi nga mola është I pranishëm dhe këtu.
B01 - B22, B01 – B19, janë dyer me kornizë me detajin standart të përdorur në kat, gjerësi 19 cm. Dëmtuar nga mola.
Edhe elementët e drurit, kornizat apo kapakët që mbulojnë radiatorët e pozicionuar në muret anësore, janë të prekua nga mola.

TAVANI: Dekoruar me korniza prej gipsi (allcie) perimetrale, e cila shërben edhe për vendosjen e ndricimit të fshehtë, në spesorin apo hapësirën që krijon me tavanin dhe murin vertikal. Deri në fillimin e shkallëve, që të cojnë në katin e 2-të, korniza kryesore shoqërohet me element dekori horizontal ( krahu më I shkurtër), vendosur në hap 90cm nga njëra – tjetra.

POZICIONIMI I RADIATORIT: Pozicionohet I fshehur në disa xhepa të krijuar në sipërfaqet e mureve kryesore të hallit. Evidentimi dhe pozicionimi I saktë I tyre në planin e rilevimit. Në sip. E

brëndshme e nikjes, suvaja është dëmtuar dhe petëzuar.
SHKALLA: E veshur e tëra me mermer dhe në gjëndje të mirë deri në shesh pushimin që lidh me katin e 2 – të. Ka nevojë për pastrim të lehtë të elementëve të saj, për të vlerësuar dekoret dhe materialin. Në murin anësor, ka fryrje në reliev të bëra me allci, e cila ka nevojë për lyerje. Kjo mbushje është 3 cm e dalë dhe 84 cm e lartë nga këmbët e shkallës.

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

Ambjentet B-02, BS-03 (Shkalle & Ashensor)

| Pozicioni | Planimetria e katit | Plani i ambientit |
|---|---|---|
|  |  |   |

**Përshkrim i shkurtër:**
SIP: 15.2m2
Lartësi dysheme – tavan: H: 2.34 m
Dysheme: PLLAKA MERMERI
Ambient lidhës i të tre kateve të objektit, e cila përbëhet edhe nga kafazi I ashensorit.

**Problematika:** Gjëndja në përgjithësi është e mirë, përvec murit të shkallës në perimetrin në kontakt me ambientin e jashtëm, i cili ka dëmtime serioze të suvasë dhe rënie të saj nga lagështia. Dëmtim në të gjithë lartësinë e murit deri në shkeljen e bazamakëve të shkallëve.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :
DYSHEMEJA: Veshja e sheshpushimeve ndërlidhëse është me pllaka mermeri. Në gjëndje të mirë.
MURET ANËSORE: Të veshura me suva dhe të lyera më bojë me ngjyrë ( evidentimi I kodit në vend). Sipërfaqet anësore të mureve paraqiten në gjëndje të mirë, ato që lidhin me ambientet e brëndshme. Muri I jashtëm I shkallës, sidomos në ngjitje për në katin e dytë, ka dëmtim të konsiderueshëm nga lagështia, rënie suvaje jo vetëm sipërfaqësore.
DYERT: B02 – B01 DHE B02 me ashensorin, janë prej druri, lyer në llak dhe në gjendje të mirë. Dëmtimi nga mola është në masën 20%.
TAVANI: I thjeshtë, pa dekore, por me disnivele përshkak të rakordimit të rampës së shkallës me sheshpushimet. Suvatuar, lyer me bojë hidromat (evidentimi i kodit në vend).
POZICIONIMI I RADIATORIT: Pozicionohet në një nikje (18 cm) të krijuar në një nga muret anësore të ambientit.
SHKALLA: Elementi I shkallës është I veshur me pllaka mermeri, në gjendje të mirë. Parmaku deri në lartësinë 65.5 cm, është mur I suvatuar dhe I lyer. Veshur me rifiniturë druri, në nivelin e korimanos, me kornizë 10 cm; në gjendje të mirë. H totale = 75.5 cm

| |
|---|
| **Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI** |
| **Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme |

| Ambjenti B-03 (Ambient sherbimi) | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria e katit | Plani i ambientit |
|  |  |  |

**Përshkrim i shkurtër:**
SIP: 8.4 m2
Lartësi dysheme – tavan:Hmax: 3. 24  m dhe Hmin: 1.75  m
Dysheme: e paveshur me pllaka.
Ambient shërbimi I pozicionuar poshtë shkallëve BS05.

**Problematika:** Nuk ka demtime. Dyshemja këtu, nuk është e veshur me pllaka mermeri, ndaj dhe ndodhet në kuotë 10 cm poshtë dyshemesë, së hollit kryesor.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** :
DYSHEMEJA: Pa veshje. -10cm nga niveli I dyshemesë së B01.
MURET ANËSORE: Të veshura me suva dhe të lyera më bojë me ngjyrë ( evidentimi I kodit në vend).
DYERT: B01 – B03; Material druri dhe në gjendje të mirë. Kanë nevojë për mirëmbajtje  Lyer me bojë vaji në të dy krahët. Kornizë më e hollë se korniza standart e përdorur në kat. Dëmtimi nga mola është evident.
TAVANI: Suvatim I thjeshtë dhe disnivele në kuota, përshkak të përshtatjes me disnivelin e rampës së shkallës dhe evidentimin e trarëve.
POZICIONIMI I RADIATORIT: Nuk u evidentua radiator në ambient.

**Rekomandimet/Veprimet: Referoju deokumentit të PMI**

**Kategoria 1**– e qëndrueshme dhe e mirëmbajtshme

| Ambjenti B-04 (Ambient Studio) | | |
|---|---|---|
| Pozicioni | Planimetria e katit | Plani i ambientit |

| | | |
|---|---|---|
|  |  |  |

**Përshkrim i shkurtër:**
SIP:  24.6 m2
Lartësi dysheme – tavan:  H: 3. 85 m
Dysheme: Parket
Ky ambient shërben si studio, në përbërje të tij ka 2 anekse të vogëla; njeri shërben si kasafortë dhe tjetra shërben si “magazinë” materialesh ( libra dokumenta etj

**Problematika:** Në krahun verior të saj, ose muret perimetrale që lidhin me ambientin e jashtëm, vihen re plasaritje dhe plasaritje të patinimit, në tavan dhe muret vertikale, përshkak të lagështisë.

**Ndërhyrjet e konservimit:**

**Gjendja aktuale** : DYSHEMEJA: Parket, por e veshur me moket. Parketi është në gjëndje të mirë, pa motive dhe jo I lyer me llak.
MURET ANËSORE: Suvatuar dhe të lyer me bojë (evidentimi I kodit të ngjyrës në vend). Dëmtim I suvasë në tavanë në masën 30 % dhe në muret anësorë të ambientit kryesisht në murin perimetral të jashtëm, për shkak të lagështisë.
DRITARET: Kasat e dritareve janë prej druri. Elementët e hapjes së kanatëve të dritares, detajet e inkasimit të grilave dhe cdo detaj tjetër i nevojshëm për funskionimin e tyre është I gdhendur në dru dhe përbërë me element metalikë. Gjëndja paraqitet e amortizuar dhe ka nevojë për mirëmbajtje për mirëfunskionim të tyre. Disa element, mund të kenë nevojë edhe për zëvendësim total. Në këtë ambient dritarja është e lyer me bojë vaji me ngjyrë ( kodi të përcaktohet në vend), e cila në parmak është shkëputur peta peta në masën 90 %.  Pjesa e poshtme e Dritares, përdoret për inkasimin e radiatorëve, të cilët janë të fshehur në dukje nga kapak druri me motive dhe rrjetë metalike.
Korniza e dritares, ka të inkasuar edhe detajin e kapjes së shinave të perdes.
DYERT:  Dyert janë prej druri, të lyer me bojë vaji. Korniza është standart I përdorur me të njëjtin detaj në të gjithë katin. Paraqiten në gjëndje të mire, por të amortizuara.
TAVANI: Dekoruar me korniza prej gipsi (allcie) perimetrale, e shkëputur nga tavani dhe formon detajin për të realizuar ndricimin e fshehtë.   Vënde vendë vihen re fryrje të suvasë, por ende shkëputje të saj. Nevojë për ndërhyrje.
